

**NDIKIMI I STRUKTURËS EKONOMIKE NË RRITJEN E
QËNDRUESHME DHE TREGUN SHQIPTAR TË PUNËS
GJATË PERIUDHËS SË TRANZICIONIT (1991 – 2019).
PERSPEKTIVAT E ARDHSHME**

Oriola Musa

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, Biznesi dhe Zhvillimi, me profil Ekonomi dhe Zhvillim i
Qëndrueshëm, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Adrian Civici

Numri i fjalëve: 60 738

Tiranë, Tetor 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, e nënshkruara Oriola Musa deklaroj që studimi është punë origjinale e imja, sipas fjalëve dhe mendimeve të mia, dhe të gjitha burimet e përdorura gjatë shkrimit të tij janë burime origjinale dhe të njohura si të tilla, si dhe të gjitha citimet janë lehtësisht të identifikueshme. Disertacioni nuk ka pjesë, paragrafë apo kapituj që i përkasin punës së dikujt tjetër dhe të cilat të jenë përdorur për qëllime të tjera përveçse të kërkojnë të shtojnë dijen për çështjet e trajtuara dhe të bëjnë sa më shumë zbulime të reja dhe sa më interesante për fushën time të studimit. Unë i kuptoj nënkuptimet etike të studimit tim dhe që ky studim i plotëson të gjitha kërkesat e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Biznesit dhe Zhvillimit pranë Universitetit European të Tiranës dhe standardeve të tij të etikës akademike.

Nënshkroi me respekt,

Oriola Musa

ABSTRAKTI

Teza kryesore e disertacionit është sesi një rritje ekonomike e qëndrueshme ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në diversifikimin e tregut të punës në Shqipëri dhe shfaqjen e profesioneve të reja. Me anë të metodave të ndryshme kërkimore, cilësore dhe sasore, studimi spjegon dhe analizon modelet e ndryshme të zhvillimit ekonomik të zbatuara në Shqipëri ndër vite. Gjithashtu, disertacioni studion dhe ndikimin që këto modele kanë pasur në strukturën ekonomike të vendit. Struktura ekonomike konceptohet si aftësitë teknologjike që një vend zotëron dhe si një burim i rëndësishëm për hapjen e vendeve të reja të punës dhe diversifikimin e profesioneve. Posaçërisht studimi është fokusuar në diversifikimin e tregut të punës dhe në krijimin e profesioneve të reja dhe në cilësinë e aftësive për punë të individëve që dalin nga sistemi arsimor shqiptar. Studimi përmban dhe një analizë të detajuar sesi do të mund të ndikojë një rritje ekonomike e qëndrueshme tregun shqiptar të punës. Analiza është bazuar në studimin e dy marrëdhënieve të rëndësishme të cilat ndër vite kanë përcaktuar dhe strukturën e sotshme të ekonomisë shqiptare. Së pari, marrëdhënia e parë është marrëdhënia midis modeleve ekonomike të zbatuara në Shqipëri dhe strukturës ekonomike së sotshme. Ndërsa marrëdhënia e dytë studion ndikimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme në diversifikimin e tregut të punës. Ndryshe nga studimi i marrëdhëniës së parë, e cila është bazuar në situatën aktuale, marrëdhënia e dytë bën një projektim futuristik të ekonomisë shqiptare dhe zhvillimin afatgjatë të saj. Metodologjia është e bazuar në burime parësore dhe dytësore, të tilla si materiale konkrete të mbledhura nga firma, ndërmarrje, kompani dhe korporata që operojnë në tregun shqiptar të punës si dhe raporte të organizatave ndërkombëtare të tilla si Banka Botërore, FMN, OECD, ILO etj. Kjo do të thotë që janë mbledhur burime të cilat janë analizuar duke përdorur teknika dhe metoda të huazuara nga ekonometria të tilla si regresioni linear dhe që bazohen gjithashtu dhe në studimin e rasteve konkrete empirike.. Të dhënat e marra nga 2 kompani private dhe një kompani publike janë analizuar më pas me programin SPSS duke nxjerrë dy rezultate kryesore: Së pari, sistemi arsimor luan një rol në nivelin e të ardhurave të individëve në tregun e punës shqiptar, por nuk është një marrëdhënie e fortë apo e rëndësishme. Dhe së dyti, ekzistojnë diferenca të mëdha ndërmjet pagave të individëve të punësuar në të njëjtat pozicione.

Fjalë kyçe: Rritja ekonomike, zhvillimi ekonomik, kapitali njerëzor, tregu i punës, Shqipëria.

DEDIKIMI

Familjes time për gjithë mbështetjen morale që më ka dhënë dhe që bën të bukur çdo ditë të ekzistencës time.

xxxx Ori

FALENDERIME

Ky studim është mbështetur në një periudhë relativisht të gjatë kërkimesh dhe vëzhgimesh të cilat kanë përfshirë shumë individë, institucione, biznese të cilat nuk mund ti lë pa falenderuar dhe shprehur mirënjohjen për ndihmesën e tyre në avancimin e këtij studimi.

Në radhë të parë dua të falenderoj Universitetin Evropian të Tiranës (UET) si një institucion i mirëfilltë kërkimi dhe në të cilin po finalizoj studimet e mija disa vjeçare. Po aq i rëndësishëm ka qenë dhe ndikimi në drejtimet e mija kërkimore të Prof. Adrian Civicit, i cili pati durimin të lexonte çdo faqe të këtij studimi dhe të jepte sugjerime shumë të vlefshme për ecurinë e mëtejshme të tij.

Studimi u mbështet në mbledhjen e të dhënave empirike në dy biznese private dhe një korporatë publike, emrat e të cilëve për arsye të etikës dhe privatësisë nuk mund ti bëj publike, por dua të shpreh mirënjohjen time për gjithë mbështetjen që gjeta dhe materialet që më vunë në dispozicion.

Së fundi, dëshiroj të shpreh vlerësimin për të gjithë punonjësit e ekonomisë shqiptare, dhe sidomos ata të përfshirë në këtë studim, që japin kontributin e tyre çdo ditë me punën dhe afësitë e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.

Me respekt,

Oriola

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE.....	16
1.1. Qëllimet dhe objektivat e studimit	17
1.2. Pyetjet kërkimore dhe Teza	20
1.3. Ndikimi i zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike te punësimi	20
<i>Zhvillimi ekonomik</i>	21
<i>Struktura ekonomike</i>	23
<i>Rritja ekonomike e qëndrueshme</i>	24
<i>Tregu i punës</i>	26
1.4. Delimitimi kohor i studimit	27
1.5. Metodatat e kërkimit shkurtimisht.....	27
1.6. Paraqitje e shkurtër e kapitujve	29
KAPITULLI II: KORNIZA TEORIKE DHE ANALITIKE E MODELEVE TË NDRYSHME TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE RITJES EKONOMIKE	32
2.1. Modelet teorike të rritjes ekonomike	34
<i>Modeli i zhvillimi ekonomik tradicional ose neoklasik</i>	35
<i>Ndryshimi midis ekonomisë politike dhe zhvillimit ekonomik</i>	36
<i>Modeli bashkëkohor i zhvillimit ekonomik</i>	37
<i>Zhvillimi ekonomik dhe lumturia</i>	38
<i>Zhvillimi ekonomik dhe përfaqësimi i grupeve të marginalizuara</i>	38
<i>Kritikat ndaj modeleve të zhvillimit ekonomik</i>	39
2.2. Struktura ekonomike sipas përfaqësimit institucionaliste	39
2.3. Lidhja që ekziston midis strukturës ekonomike dhe tregut të punës.....	42
2.4. Ekonomia e dijes	45
2.5. Ndikimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme në tregun e punës	49
KAPITULLI III: TRANZICIONI EKONOMIK SHQIPTAR.....	52
3.1. Transformimi i strukturës ekonomike	55
3.2. Burimet e transformimit ekonomik ose Terapia e Shock-ut.....	62
<i>Rasti i Albpetrol</i>	66

3.3. Roli i Bankës Botërore	70
3.4. Roli i FMN-së.....	73
3.5. Roli i BE-së	76
3.6. Zhvillimi rajonal dhe ndikimi i tij në strukturën ekonomike shqiptare.....	80
3.7. Përmbledhja e kapitullit.....	83
KAPITULLI IV: ZHVILLIMI EKONOMIK DHE RITJA EKONOMIKE SHQIPTARE .	84
4.1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.....	85
4.2. Aderimi i Shqipërisë në konventat ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm	89
4.3. Rritja ekonomike shqiptare sipas shifrave zyrtare.....	94
4.4. Dritëhijet e zhvillimit ekonomik	99
4.5. Ndikimi i ekonomisë informale dhe korrupsionit	104
4.6. PPP-të dhe investimet e huaja.....	108
4.7. Mundësimi i një rritje ekonomike të qëndrueshme sipas praktikës shqiptare	109
4.8. Përmbledhja e kapitullit.....	114
KAPITULLI V: ZHVILLIMI I KAPITALIT NJERËZOR DHE PUNËSIMI	115
5.1. Arsimimi dhe kapitali njerëzor.....	115
5.2. Rritja ekonomike, të ardhurat dhe ngjitja e shkallëve të karrierës	119
KAPITULLI VI: METODOLOGJIA.....	126
6.1. Mbledhja e të dhënave	126
6.2. Regresioni Linear – si metoda e analizimit të të dhënave	127
6.3. Statistikat me anë të programit statistikor SPSS	128
6.4. Kampionimi	130
6.5. Konsiderata etike	132
KAPITULLI VII: ANALIZIMI DHE KRAHASIMI I REZULTATEVE	137
7.1. Rezultatet e të dhënave të kompanisë X – Edukimi dhe Paga	137
7.2. Rezultatet e të dhënave të një banke të nivelit të dytë – koduar si ‘Banka Y’ –	143
7.2.1. Rezultatet e të dhënave të ‘Bankës Y’ – Pozicioni dhe Paga.....	149
7.3. Rezultatet e të dhënave të ‘Kompanisë Z’ – Edukimi dhe Paga.....	155
7.4. Përmbledhja e kapitullit.....	160
KAPITULLI VIII: TREGU SHQIPTAR I PUNËS DHE RITJA EKONOMIKE E QËNDRUESHME.....	162

8.1. Aftësitë për punë dhe punësimi.....	164
8.2. Politikat kombëtare të punësimit.....	168
8.3. Punësimi i të rinjve	171
8.4. Mbrojtja dhe përfshirja sociale	173
8.5. Punët e ardhshme dhe e ardhmja e punësimit në Shqipëri.....	174
KAPITULLI IX: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	176
SHTOJCA.....	180
Shtojca 1: Kompania X (kompani interneti) – te dhenat e hedhura ne SPSS të viteve të edukimit dhe të pagës bruto	180
Shtojca 2: Banka Y (bankë e nivelit të dytë) – te dhenat e hedhura ne SPSS të viteve të edukimit, të pagës bruto dhe pozicionit të punësimit brenda kompanisë.....	183
Shtojca 3: Kompania Z – Të dhënat e hedhura në SPSS të viteve të edukimit, të pagës bruto dhe pozicionit të punësimit brenda kompanisë	186
LISTA E REFERENCAVE	198

LISTA E ILUSTRIMEVE

Figura 1: Qëllimet kryesore të studimit.....	19
Figura 2: Parimet kryesore të zhvillimit ekonomik sipas teorive postmoderniste.....	33
Figura 3: Përbërësit institucionalë të strukturës ekonomike.....	41
Figura 4: Ndikimi i teknologjisë dhe inovacionit te Tregu i Punës	43
Figura 5: Ndikimi i strukturës ekonomike në shpërndarjen e të ardhurave	44
Figure 6: Ndryshimet qe solli rritja ekonomike e qëndrueshme në vendet e zhvilluara (Kuznets, 1989).....	46
Figura 7: Tre përbërësit kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm në teori.....	91
Figura 8: Tre përbërësit kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm në praktikën e sotshme.....	91
Figura 9: Ndryshimi që duhet bërë në komponentët e zhvillimit të qëndrueshëm.....	92
Figura 10: Faktorët që përcaktojnë rritjen ekonomike (Acemoglu, 2009).....	96
Figura 11: Tiparet kryesore të punësimit në Shqipëri (ILO & SHKP, 2014)	117
Figura 12: Procesi i ndikimit të sistemit arsimor te struktura ekonomike e një vendi	120
Figura 13: Model i ‘pikave të jashtme’ gjatë analizimit të rezultateve në programin statistikor SPSS	129
Figura 14: Shembuj modelesh 'homoskedaciteti' në programin statistikor SPSS.....	129
Figura 15: Organograma e Kompanisë X.....	130
Figura 16: Hedhja e të dhënave të variablave në programin SPSS	135
Figura 17: Të dhënat e kompanisë X të hedhura në programin SPSS	135
Figura 18: Vendosja e variablave të regresionit linear në SPSS.....	137
Figura 19: Paraqitja e vlerave të variablit të pozicioneve në Bankën Y sipas programit SPSS	150

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabela 1: Treguesit makro-ekonomikë 1991 - 1998 (Burimi INSTAT)	69
Tabela 2: Rritja e PBB-s në përqindje (Burimi: INSTAT)	99
Tabela 3: Treguesit makro-ekonomikë 2018 (AIDA)	108
Tabela 4: Përqindja e të punësuarve në sektorin bujqësor përgjatë viteve 1990, 1997 dhe 2017	116
Tabela 5: Statistika përshkruese e regresionit linear të edukimit dhe të ardhurave të kompanisë	138
Tabela 6: Korrelacioni midis variablave edukim dhe të ardhura në kompaninë X	138
Tabela 7: Përmbledhja e modelit me SPSS të kompanisë X për variablat edukim dhe të ardhura	138

Tabela 8: Regresioni linear në tabelën ANOVA për variablat e edukimit dhe pagës në Kompaninë X.....	139
Tabela 9: Statistika përshkruese për Bankën Y.....	144
Tabela 10: Korrelacionet për variablat e edukimit dhe pagës në Bankën Y.....	145
Tabela 11: Përmbledhja e modelit për Bankën Y.....	145
Tabela 12: Paraqitja e tabelës ANOVA për Bankën Y në variablat e edukimit dhe të pagës.....	146
Tabela 13: Tabela e koeficientëve në Bankën Y për edukimin dhe pagën.....	146
Tabela 14: Statistika përshkruese e Bankës Y përsa i përket pozicionit dhe pagës.....	151
Tabela 15: Korrelacionet e variablit të pozicionit dhe të pagës në Bankën Y.....	151
Tabela 16: Përmbledhja e modelit për variablat e pozicionit dhe të pagës në Bankën Y.....	151
Tabela 17: Parametrat ANOVA për variablat e pozicionit dhe të pagës në Bankën Y.....	152
Tabela 18: Koeficientët e variablave të pozicionit dhe të edukimit për Bankën Y.....	152
Tabela 19: Përmbledhja e modelit për variablat e edukimit dhe të pagës në Kompaninë publike Z.....	156
Tabela 20: Tabela ANOVA për Kompaninë Z.....	157
Tabela 21: Të punësuar sipas burimeve administrative dhe sektori bujqësor, 2016-2019.....	168
Tabela 22: Numri i të diplomuarve sipas viteve (INSTAT, 2019).....	169
Tabela 23: Të punësuar në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve, 2014-2018.....	170
Tabela 24: Balanci i forcave të punës 2014 - 2018 (në mijë).....	173

LISTA E GRAFIKËVE

Grafik 1: Rritja reale e PPB-së sipas përqindjeve vjetore (burimi FMN).....	99
Grafik 2: Histogrami me SPSS i kompanise X për variablat edukim dhe të ardhura.....	140
Grafik 3: Projektioni i vijës së regresionit linear për arsimimin dhe të ardhurat në Kompaninë X.....	141
Grafik 4: Vlera e parashikuar dhe e standartizuar e regresionit.....	142
Grafik 5: Histogrami i Bankës Y për variablat e edukimit dhe të pagës.....	147
Grafik 6: Drejtëza e regresionit linear për Bankën Y për variablat e edukimit dhe të pagës.....	147
Grafik 7: Diagrama e skaterit e Bankës Y për variablat e edukimit dhe të pagës.....	148
Grafik 8: Histogrami i variablave të pozicionit dhe të pagës në Bankën Y.....	153
Grafik 9: Drejtëza e regresionit linear dhe rezultatet e variablave të poziconit dhe pagës në Bankën Y.....	154
Grafik 10: Diagrama e skaterit për variablat e pozicionit dhe të pagës në Bankën Y.....	154
Grafik 11: Histogrami i variablave të edukimit dhe të pagës në Kompaninë Z.....	158
Grafik 12: Drejtëza e regresionit linear dhe rezultatet e variablave të edukimit dhe pagës në Kompaninë Z.....	159
Grafik 13: Diagrama e skaterit për variablat e edukimit dhe të pagës në Kompaninë Z.....	160
Grafik 14: Shkalla e papunësisë në Shqipëri sipas grupmoshave (2015-2019).....	166

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AIDA	Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BS	Bashkimi Sovjetik
BSH	Banka e Shqipërisë
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
KE	Komisioni Evropian
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PISA	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Studentëve
PPB	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto
PRE	Programet e Reformës Ekonomike
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

...një aspekt i forcës motivuese të rritjes ekonomike – është tendenca për të vlerësuar më shumë të renë sesa të vjetrën, dhe për të trajtuar atë që tashmë është krijuar si një domosdoshmëri me kosto të ulët.

Simon Kuznets

KAPITULLI I: HYRJE

Individët e zakonshëm çuditen me luhatjet e mëdha të rritjes ekonomike që ekzistojnë midis vendeve të ndryshme. ‘Si mundet që një vend të jetë 30 herë më i pasur se një vend tjetër?’ pyet Daron Acemoglu në librin e tij të famshëm ‘Hyrje në Rritjen Ekonomike Moderne’. Përgjigjia sipas tij gjendet në ndryshimet që ekzistojnë midis rritjeve ekonomike. ‘Marrim dy vende, A dhe B, të cilët kanë të njëjtin nivel të ardhurash në një kohë të caktuar. Le të imagjinojmë që vendi A e ka 0% rritjen për frymë, dhe në këtë mënyrë e ardhura tij mbetet konstante, ndërsa vendi B rritet çdo vit me 2% për frymë. Përgjatë një kohe prej 200 vitesh vendi B do të jetë 52 herë më i pasur sesa vendi A’ (Acemoglu, 2009: 9). Sipas Acemoglu ‘kjo lloj llogaritje tregon që Shtetet e Bashkuara do të jenë më të pasura sesa Nigeria sepse janë rritur në mënyrë graduale për një periudhë të gjatë kohore, ndërsa Nigeria nuk e ka bërë këtë. Kjo llogaritje e thjeshtë mban në vetvete shumë të vërteta që tregojnë që pas Luftës së Dytë Botërore ka pasur diferenca të mëdha në shkallët e rritjes ekonomike në vende të ndryshme nëpër botë (Acemoglu, 2009: 9). Shumë studiues, ekonomistë dhe fitues të Çmimit Nobel në ekonomi janë përpjekur që ti përgjigjen pyetjeve kërkimore në lidhje me rritjen ekonomike. Ajo konsiderohet si një nga faktorët kryesorë që ndikon në mirëqenien dhe prosperitetin e miliarda njerëzve. Megjithatë industrializimi dhe zhvillimet teknologjike kanë krijuar një hendek midis vendeve të zhvilluara dhe atyre më të varfra (Boldeanu & Constantinescu, 2015: 329). Shpjegimet teorike që janë dhënë në literaturë kanë qenë të ndryshme, sidomos që pas Luftës së Dytë Botërore, ku dhe hendeku midis zhvillimit ekonomik ndërmjet shteteve filloi që të largohej gjithmonë e më shumë. Disa u përqendruan në shpjegimet e treguesve ekonomikë dhe atyre demografikë sidomos me rritjen e madhe të popullsisë gjatë viteve 1960-të. Solow në vitin 1956 tentoi që të përgjigjej duke theksuar diferencat në akumulimin e kapitalit dhe në ndryshimet teknologjike, megjithëse dhe kjo përgjigje nuk ishte ezauruese (Constantine, 2017: 1). Disa theksuan faktin që vendet që kishin të ardhura më të ulta nuk gjeneronin kursime të brendshme në mënyrë të mjaftueshme (dhe investime) në mënyrë që të bënin transformime në ekonomi. Por megjithëse shumë investime të huaja vërshuan në këto vende, sërish nuk u pa ndonjë ndryshim në nivelin e tyre të jetesës (Ghosh & Siddique, 2015: 3). Për këtë arsye studime të tjera filluan që të përqendroheshin te faktorët jo-

ekonomikë dhe kulturorë të tilla si kapitali human dhe kultura lokale. Shumë vende filluan që të investonin në arsimim dhe në inovacion. Disa ekonomistë institucionalistë të tillë si North (1990), Acemoglu dhe Robinson (2013) pretendojnë që diferencat në institucione mund të shpjegojnë dhe diferencat në performancën ekonomike përgjatë kohës dhe hapësirës (Constantine, 2017:1).

Shqipëria, mund të quhet si një vend ideal apo laborator studimi përse i përket teorive dhe praktikave të zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike. Ajo ka qenë një ndër vendet që ka përjetuar si zhvillimin socialist dhe atë kapitalist, mbetur në klasifikimin e vendeve në tranzicion për një kohë të gjatë, dhe nën menaxhimin efektiv të organizatave ndërkombëtare të tilla si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB) dhe së fundi Bashkimi Evropian (BE). Shqipëria në pamje të parë duket sikur i ka mbijetuar rrebesheve dhe krizave të mundshme financiare që e kanë çuar atë në limitet e dështimit të shtetit dhe dështimeve të mëdha ekonomike. Por sidoqoftë, për të gjitha arsyt që do të analizohen në këtë studim, ajo duket se nuk ka pasur një hov të mjaftueshëm ekonomik për të kapërcyer më lart në klasifikimin e vendeve më të varfra dhe të pazhvilluara ekonomikisht, drejt atyre me rritje ekonomike të qëndrueshme.

1.1. Qëllimet dhe objektivat e studimit

‘Zhvillimi’ si një teori, praktikë, koncept, projekt, institucion apo tekst i shkruar ka qenë shumë i diskutuar dhe i analizuar gjatë dekadave të fundit. Që pas prezantimit të tij pas Luftës së Dytë Botërore, ndikimi i tij në ekonomitë dhe kulturat lokale të vendeve të ndryshme ka qenë shumë i madh. Duke iu referuar Arturo Escobar dhe librit të tij mbi eksperiencat e vendeve në zhvillim ‘zhvillimi është kthyer në një gjë të mirëqenë në përfytyrimin social’ (Escobar, 1995: 5) dhe ishte për këtë arsye që ai dëshironte ta dekonstruktonte si koncept. Megjithatë, zhvillimi ekonomik, është analizuar shumë si nga ana akademike ashtu dhe nga organizatat ndërkombëtare, sërish nuk ka akoma sot një përkufizim të saktë dhe individët bëhen konfuzë kur i referohen praktikave dhe politikave të zhvillimit. Kjo gjë është akoma më e dukshme në vendet të cilat i janë nënshtruar më shumë se një praktike, programi, strategjie apo plani zhvillimi të tilla si vendet e Evropës Lindore. Këto vende kanë zbatuar lloje të ndryshme zhvillimi, duke filluar me zhvillimin

socialist (i cili ishte po ashtu u zbatua në mënyrë shumë specifike), dhe pas rënies së komunizmit këto vende u përballën me programe dhe strategji të ndryshme zhvillimi që kishin të bënin me ekonominë e tregut, por që nuk ishin sërish të gjitha të njëjta. Rezultatet e tyre në vende të ndryshme ishin të ndryshme dhe u referoheshin organizatave të ndryshme ndërkombëtare të tilla si Banka Botërore, FMN, PNUD, BE etj.


Ky studim është i fokusuar në zhvillimin ekonomik post-komunist në Shqipëri apo siç njihet ndryshe periudha e tranzicionit ekonomik dhe që përfshin një periudhë kohore prej më shumë se 25 vitesh. Sidoqoftë, qëllimi i studimit nuk është që ti studiojë periudhat kohore si të ndara, por edhe si të mbivendosura. Ideja kryesore e studimit është që ka një mbivendosje midis programeve, planeve dhe strategjive të ndryshme të zhvillimit dhe madje ka një vazhdimësi implicite edhe midis zhvillimit ekonomik socialist dhe atij kapitalist apo siç njihet gjerësisht, periudhës së ekonomisë së tregut. Kjo sepse sistemi socialist dhe ekonomia e planit kanë prodhuar mekanizma dhe praktika që riprodhohen edhe gjatë periudhës së vendosjes së sistemit demokratik. Pavarësisht ndryshimit të terminologjisë ‘zhvillim ekonomik’ apo ‘ekonomi e planifikuar’ qëllimi i tyre ishte i njëjtë, për të prodhuar prosperitet ekonomik për vendin dhe konkretisht, Shqipërinë.

Nga ana tjetër ‘studimi i zhvillimit ekonomik është një nga fushat më të reja dhe më entuziaste të studimit të disiplinës së ekonomiksit dhe ekonomisë politike’ (Todaro, 2015: 9) dhe zakonisht përmendet nga studiuesit që është krijuar dhe zhvilluar këto gjashtë dekadat e fundit. Sigurisht që studimi i zhvillimit ekonomik ka evoluar shumë si pjesë e ekonomiksit dhe gjatë dekadave të ndryshme ka pasur zhvillime të ndryshme. Ky studim do të jetë i fokusuar më shumë në teoritë dhe modelet më të fundit të zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe ndikimet reciproke të tyre mbi strukturën ekonomike shqiptare dhe tregun e punës.

Pra, studimi do të ketë qëllime të shumëfishta dhe do të kërkojë të studiojë marrëdhënien relacionale midis temave dhe çështjeve të ndryshme, dhe sidomos: modelet e rritjes ekonomike në raport me strukturën ekonomike aktuale të Shqipërisë dhe ndikimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme në raport me tregun e punës. Pavarësisht se ka studiues apo teori që mbrojnë dhe faktin që teoria e zhvillimit ekonomik ka filluar që të zhvillohet edhe më herët, që nga koha e Adam Smithit dhe botimit të librit të tij për *Pasurinë e Kombeve*,

publikuar në vitin 1776 dhe i cili studiohet si traktati i parë i zhvillimit ekonomik, dhe si një studim sistematik i problemeve dhe proceseve ekonomike të zhvillimit të Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine (Todaro, 2015: 9). Sidoqoftë studimi i zhvillimit ekonomik gjatë dekadave të fundit ka një përjasje të ndryshme nga ajo e para tre shekujve duke përfshirë analiza dhe metodologji të reja, të cilat do të trajtohen më gjerësisht në vijim, ashtu siç tregohet dhe në figurën ilustruese.

Figura 1: Qëllimet kryesore të studimit



Objektivat e studimit:

- 1) Të studiojë modelet e rritjes ekonomike në Shqipëri duke filluar që nga viti 1990-të ndikimin e këtyre modeleve në strukturën ekonomike të vendit.
- 2) Të analizojë nëse politikat e rritjes ekonomike e kanë transformuar dhe modernizuar nga ana teknologjike strukturën ekonomike të vendit dhe nëse kanë krijuar inovacion dhe si pasojë dhe vende të reja pune;
- 3) Të shpjegojë efektet e rritjes ekonomike të qëndrueshme në tregun shqiptar të punës.
- 4) Të analizojë politikat dhe praktikën e zhvillimit të ndërmarra nga qeveritë shqiptare në kohë dhe ndikimin e tyre në tregun shqiptar të punës.
- 5) Njëpërmjet rasteve konkrete të vëzhguara brenda kompanive publike dhe private të studiojë ecurinë e reformave qeverisëse përsa i përket nivelit arsimor të të punësuarve dhe të ardhurave të tyre mujore në formën e pagës.

- 6) Të bëjë parashikime dhe të japë rekomandime duke u bazuar nga konkluzionet e rasteve studimore të marra në shqyrtim në këtë dizertacion.

1.2. Pyetjet kërkimore dhe Teza

Qëllimi kryesor i studimit është që të shpjegojë dhe të analizojë ndikimin që modelet e ndryshme të rritjes ekonomike të zbatuara në Shqipëri kanë pasur në strukturën ekonomike të vendit, dhe sesi një rritje ekonomike e qëndrueshme do të mund ta transformonte tregun shqiptar të punës. Marrëdhënia e parë, e cila studion marrëdhënien e modeleve ekonomike në strukturën ekonomike të Shqipërisë, kërkon që të bëjë një analizë teorike dhe empirike të situatës aktuale, ndërsa marrëdhënia që shpjegon ndikimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme në tregun shqiptar të punës është një përjasje futuriste e problemit dhe do të tentojë të analizojë ndikimin afatgjatë të zhvillimit ekonomik në vend. Për të shpjeguar dhe analizuar tezën kryesore të disertacionit, jam bazuar në pyetjet kërkimore të mëposhtme:

- Cila është struktura ekonomike prezente e ekonomisë shqiptare?
- Cilët janë përcaktuesit kryesorë të rritjes ekonomike në Shqipëri?
- A mundëson struktura prezente e ekonomisë shqiptare një rritje ekonomike të qëndrueshme?
- Si e ndikon struktura prezente e ekonomisë shqiptare tregun e punës? (*situata aktuale*)
- Cili do të ishte efekti i drejtpërdrejtë i rritjes ekonomike të qëndrueshme në tregun shqiptar të punës? (*një situatë e mundshme*)

Teza Kryesore:

Një rritje ekonomike e qëndrueshme ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në diversifikimin e tregut të punës në Shqipëri dhe shfaqjen e profesioneve të reja.

1.3. Ndikimi i zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike të punësimit

Lidhja midis zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe faktorëve të tregut të punës jo gjithmonë është një marrëdhënie shkakësore dhe jo gjithmonë zhvillimi ekonomik sjell punësim. ‘Struktura e ekonomisë shqiptare është e mbizotëruar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që përveçse kanë një kontribut thelbësor si në termat e rritjes ekonomike

ashtu dhe të punësimit, kanë një potencial të kufizuar përse i përket krijimit të punëve të reja' (UNDP, Albania). Gjithashtu duke iu referuar përsëri raportit të UNDP-së, duke qenë se Shqipëria ka një bazë prodhimi dhe eksporti të kufizuar, dhe kapacitete inovatore të pakëta, ka sjellë që konkurrenca në ekonominë shqiptare të jetë e dobët. 'Të dhënat nga tregu i punës tregojnë që rritja ekonomike e dy dekadave të fundit nuk ka sjellë përmirësime domethënëse të tregut të punës. Gjatë vitit 2017 pjesëmarrja e forcës punonjëse në tregun e punës ka qenë më e ulët se mesatarja evropiane, ku shkalla e pjesëmarrjes së grave ka qenë më e ulët se e burrave. Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve ka qenë akoma më e ulët sesa mesatarja evropiane dhe të dhënat tregojnë që nga viti 2007 rinia shqiptare është përballur me vështirësi në rritje përse i përket përfshirjes në tregun e punës në krahasim me grup-moshat e tjera' (UNDP, Albania). Tek Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Aftësive 2014 – 2020 theksi vendoset te trajnimi profesional i të rinjve dhe pajisja e tyre me njohuritë, dijet, aftësitë për një kalim të suksesshëm në tregun e punës. Kjo sepse forca punëtore shpesh kritikohet që nuk ka aftësitë e duhura profesionale, i mungojnë aftësitë dhe nuk është e kualifikuar për tregun e punës. Prandaj drejt zhvillimit të këtyre aftësive dhe arsimit profesional është fokusuar dhe strategjia më e fundit e qeverisjes (Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Aftësive 2014 – 2020). Në këtë pjesë të studimit do të paraqiten shkurtimisht përkufizimet për konceptet dhe termat kryesore që do të përdoren në mënyrë që të bëhet dhe më i lehtë klasifikimi, studimi dhe analizimi i tyre në pjesët në vazhdim.

Zhvillimi ekonomik

Termi i 'zhvillimit ekonomik' ka kuptime të ndryshme për studiues të ndryshëm, dhe është për këtë arsye që është e rëndësishme që ta përkufizojmë më mirë konceptin që do të përdoret në këtë studim që në fillim të tij. Pa një perspektivë të tillë dhe pa rënë dakort për disa kriteret matëse të konceptit nuk do të ishim në gjendje që të përcaktonim se cili mund të quhet vend i zhvilluar dhe se cili jo (Todaro, 2015:16). Studimet aktuale kanë treguar që nuk ka një konsensus mbi atë se çfarë do të thotë zhvillim ose çfarë procesesh nënkupton ai, megjithëse përpjekjet për ta përkufizuar kanë qenë të shumta duke filluar nga vitet 1940-të (Sklias & Chatzimichailidou, 2016: 147). Që nga viti 1969, dhe me përkufizimin e Dudley Seers filluan dhe përpjekjet për ta zgjeruar konceptin e zhvillimit dhe për të mos e

përkufizuar atë vetëm në lidhje me rritjen ekonomike. Sipas tij ‘të gjithë duhet të jemi të ndërgjegjshëm që zhvillimi është diçka më e gjerë sesa rritja ekonomike’ (Seers, 1969:1). Qëllimi i zhvillimit sipas Seers ishte që të reduktonte varfërinë, pabarazinë dhe papunësisë, dhe nëse të tre këta elementë ishin në nivele të larta atëherë vendi po kalonte një periudhë zhvillimi ndërsa ‘nëse njëri ose dy elementë ishin përkeqësuar, sidomos nëse të tre ishin përkeqësuar, atëherë do të ishte e çuditshme që ta quaje se këto zhvillime kishin ndodhur si pasojë e zhvillimit megjithëse të ardhurat për frymë mund të ishin dyfishuar (Seers, 1969:5).

Akoma dhe sot studiuesit vazhdojnë që të bien dakort që zhvillimi ekonomik është i ndryshëm nga rritja ekonomike. Kështu për shembull ata japin modelin kur një ekonomi mund të zgjerohet duke marrë hua shuma të mëdha parash ose duke eksportuar vetëm një produkt, kontrolli i të cilit vjen si pasojë e një oligarkie financiare. Ndërkohë që sektorë të tjerë të ekonomisë mund të jenë në krizë të thellë, dhe për shembull në nivelin social varfëria mund të jetë rritur, mund të ketë mungesa të ushqimeve, degradim të mjedisit natyror, konflikte të tjera etnike ose çështje të shkollimit dhe të analfabetizmit (Sotiropoulos et al. 2005, 28). Ideja kryesore në literaturë është fakti që zhvillimi ekonomik shpesh është parë si një model i vetëm zhvillimi, kryesisht modeli perëndimor, dhe si i tillë është zbatuar dhe në vende të tjera dhe rezultatet e tij nuk kanë qenë të njëjta. Ndërkohë që modelet e zhvillimit janë të shumta dhe të ndryshme dhe vetë koncepti nënkupton një sërë procedurash dhe aktorësh të ndryshëm si dhe variabla të ndryshme për matjen e tij.

Në këtë studim do të tentohet që të largohet vëmendja nga modeli perëndimor i zhvillimit dhe studimi do të jetë i përqendruar në teori të ndryshme dhe do të bëhet një analizë e zbatimit të këtij koncepti në Shqipëri. Duhet theksuar që Shqipëria ka zbatuar modele të ndryshme zhvillimi e sidomos dy prej tyre janë lehtësisht të identifikueshme: modeli i zhvillimit socialist dhe modeli i zhvillimit kapitalist. Të dy këto modele kanë nënklasifikime të ndryshme midis tyre dhe tentojnë edhe të mbivendosen mbi njëri – tjetrin në periudha të caktuara kohore.

Gjithashtu modeli i zhvillimit ekonomik në këtë disertacion nuk do të studiohet vetëm në raport me rritjen ekonomike, por edhe me parametra të tjerë socialë, politikë dhe kulturorë.

Por rritja ekonomike, sidoqoftë do të trajtohet gjerësisht si pjesë përbërëse e zhvillimit ekonomik të një vendi dhe do të analizohet si e tillë dhe në rastin e Shqipërisë. Që nga vitet 2000, përqasja ndaj modeleve të zhvillimit ekonomik ka ndryshuar kryekëput duke theksuar që ‘nuk ka një rrugë më të mirë apo të vetme të zhvillimit’ (Goulet, 2002:19). Kështu për shembull në vitin 2011 ‘O’Brien dhe Williams e perceptonin zhvillimin edhe si një ‘proces’ ashtu dhe si një ‘gjendje’. Kështu sipas tyre termi zhvillim i referohej një procesi shumë dimensional dhe përfshinte tranzicionin nga një gjendje më pak e dëshirueshme drejt një gjendje shoqërore më të dëshirueshme (Sklias & Chatzimichailidou, 2016: 147). Duke iu referuar Todaro & Smith (2015), zhvillimi është një gjendje mendore dhe fizike e një shoqërie të caktuar me anë të kombinimit të proceseve sociale, ekonomike dhe institucionale, dhe siguron një jetesë më të mirë për individët. Pavarësisht komponentëve specifike për një jetë më të mirë, ‘zhvillimi’ në të gjitha shoqëritë duhet të ketë së paku tre objektiva kryesore:

1. Për të rritur mundësitë për shpërndarjen e të mirave bazike jetësore të tilla si ushqim, strehim, shëndet dhe mbrojtje dhe për ti zgjeruar ato;
2. Për të rritur nivelin e jetesës, duke përfshirë përveç të ardhurave më të larta dhe sigurimin e punësimit, një arsimim më të mirë si dhe një vëmendje më të madhe ndaj vlerave kulturore dhe humane, të cilat do të shërbejnë jo vetëm për të rritur mirëqenien materiale por gjithashtu për të gjeneruar një vetë-vlerësim më të madh individual dhe kombëtar;
3. Që të zgjerojë mundësitë e zgjedhjeve ekonomike dhe sociale për individët dhe kombet duke i çliruar ato nga robëria dhe varësia, jo vetëm në marrëdhëniet me popujt dhe shtet-kombet e tjera por gjithashtu nga dhe forcat e padijes dhe mjerimit human (Todaro & Smith, 2015: 24).

Struktura ekonomike

Një përcaktues i rëndësishëm në literaturë për zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike të një vendi është korniza institucionale shtetërore. ‘Roli i institucioneve filloi që të njihej me punën e studiuesve të tillë si Lewis (1955), Ayres (1962) dhe me studimet e kryera pas viteve 1990-të të Mauro (1995), Rodrik (1999), Acemoglu et al. (2002). Rodrik (2000)

pohonte që pesë modele institucionale mund të kenë një rezultat të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe përcaktuesit e rritjes ekonomike dhe këto ishin: 1) të drejtat e pronësisë, 2) institucionet rregullatore, 3) institucionet e stabilitetit makroekonomik, 4) institucionet e sigurimeve sociale dhe 5) institucionet e menaxhimit të konfliktit. Murphy et al. (1993) dhe Mauro (1995) theksonin që korrupsioni tentonte që të kishte një ndikim negativ te rritja ekonomike duke ndikuar inovacionin dhe bizneset e reja dhe mund të reduktonin dhe prodhueshmërinë. Në rastin e inovacionit, korrupsioni mund të kufizonte hyrjen në treg të sipërmarrësve të rinj. Ndërmarrjet që duhet të paguajnë shuma të mëdha parash për mitmarrje tentojnë që të reduktojnë prodhimin dhe të shtrembërojnë gjithashtu statistikatat e tyre (Boldeanu & Constantinescu, 2015: 334). Cilësia e institucioneve njihet gjerësisht si një nga burimet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike. Gjatë viteve të fundit, një theks i madh i është dhënë krijimit dhe zhvillimit të institucioneve të mira si një kusht i nevojshëm për rritjen ekonomike. Megjithatë, ndryshimet në Prodhimin e Përgjithshëm Bruto (PPB) midis vendeve nuk duket se mund të shpjegohen dhe vetëm ekskluzivisht sipas përjasjes institucionaliste. ‘Literatura ekonomike njeh tre burime të rëndësishme të zhvillimit ekonomik: gjeografinë, institucionet dhe tregun e integruar’ (Presbitero, 2006: 351).

Ky studim është i bazuar në të gjitha kriteret institucionale të përmendura më sipër. Struktura ekonomike e Shqipërisë do të analizohet duke u bazuar te raportet kryesore të organizatave të mëdha ndërkombëtare që kanë monitoruar progresin institucional të vendit si dhe te strategjitë aktuale dhe të ardhshme qeveritare. Kjo gjë, sëbashku me faktorët gjeografikë dhe aktorët e tjerë të jashtëm si dhe me problemin endemik të korrupsionit do të japin një pamje më të qartë të situatës aktuale dhe zhvillimeve ekonomike të ardhshme përse i përket punësimit, karakteristikave të tregut të punës dhe rolit që luan kapitali human në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme.

Rritja ekonomike e qëndrueshme

Ishte Denison, në vitin 1962, ai që afirmoi që rritja ekonomike ishte rritja reale e PPB-së ose PPB-së për frymë, një rritje e prodhimit kombëtar e matur me çmime konstante. Rritja ekonomike ndikohet nga faktorë të drejtpërdrejtë të tillë si për shembull burimet njerëzore

(rritje e popullsisë aktive, investime në kapitalin njerëzor), burimet natyrore (toka, burimet e nëndheshme), rritje e kapitalit të investuar ose avancimet teknologjike. Rritja ekonomike ndikohet gjithashtu nga faktorë jo të drejtpërdrejtë të tilla si (institucionet financiare, administratat private etj), madhësia e kërkesës së agreguar, shkalla e kursimeve dhe shkalla e investimeve, efikasiteti i sistemit financiar, politikat buxhetore dhe fiskale, migrimi i punës dhe i kapitalit dhe efienca qeveritare.

Ekzistojnë katër përcaktues kryesorë të rritjes ekonomike:

- Kapitali njerëzor;
- Burimet natyrore;
- Krijimi i kapitalit; dhe
- Teknologjia,

Por rëndësia që i jepet çdo përcaktuesi është gjithmonë e ndryshme (Boldeanu & Constantinescu, 2015: 330).

Po ashtu, për vite me rradhë studimet u përqendruan më shumë te rritjet e ndryshme ekonomike midis vendeve sesa te faktorët që ndikonin te një rritje ekonomike e qëndrueshme brenda një vendi. Studiues të rritjes ekonomike në nivel global kërkonin që të zbulonin origjinën e ndryshimeve të mëdha ekonomike midis vendeve apo periudhën kohore ku diferenca apo hendeku ekonomik midis vendeve u bë akoma dhe më i madh. Disa theksuan që pabarazitë midis shteteve nisën rreth vitit 1820 ose më herët duke kundërshtuar ato studiues që theksonin periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Sipas disa përlllogaritjeve të rritjeve ekonomike përgjatë shteteve ka rezultuar që diferenat midis shteteve kanë ndryshuar shumë pak duke filluar nga viti 1960 e deri në vitet 2000 (Acemoglu, 2009: 11). Sipas Acemoglu megjithëse ka diferenca të mëdha në rritjen ekonomike midis vendeve pas Luftës së Dytë Botërore, dhe megjithëse ka studime që theksojnë që rritja në Evropën Perëndimore filloi që nga vitet 1000 të Mesjetës, këto të dhëna nuk janë të mbështetura nga historianët e ekonomisë të cilët vlerësojnë që rritja e të ardhurave për frymë ishte e vogël përpara viteve 1500 ose para viteve 1800. Megjithatë kjo lloj metodologjie për Acemoglu tregon që ka pasur një rritje ekonomike të qëndrueshme për vendet e Evropës Perëndimore dhe që kanë ndryshuar në mënyrë dramatike këto 200

vitet e fundit ose më përpara (Acemoglu, 2009:13). Sidoqoftë, ky disertacion do të jetë i fokusuar më shumë në teoritë e rritjes ekonomike të qëndrueshme brenda një shteti dhe cilët janë faktorët që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë te rritja ekonomike e qëndrueshme. Por, përpara se të arrijmë në këtë rezultat, tema do të shtjellojë rritjen ekonomike të Shqipërisë ndër vite dhe të analizojë tendencat përkatëse të saj, duke u mbështetur dhe në literaturën e ekonomistëve të njohur.

Tregu i punës

Shumë studiues theksojnë që ‘faktori më i rëndësishëm që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zvogëlimin dhe rrudhjen e punësimit është rritja ekonomike e dobët. Rritja ekonomike e lartë ndikon në një rritje të vazhdueshme të kërkesës për punë duke sjellë rritje në punësim në një periudhë afatgjatë. Sidoqoftë, studiuesit vërejnë që marrëdhënia midis rritjes ekonomike dhe punësimit nuk është e njëjtë në vende të ndryshme dhe disa lloje të rritjes ekonomike ndikojnë në një krijim punësimi më të shpejtë sesa disa rritje ekonomike të tjera’ (Sen & Kirkpatrick, 2011: 135). Koncepti i ‘tregut të punës’ nuk është i lidhur vetëm me konceptin e ‘punësimit’ por edhe me konceptin e ‘kapitalit njerëzor’. ‘Kapitali njerëzor’ përkufizohet si një investim produktiv te individët, duke përfshirë dhe aftësitë dhe shëndetin e tyre, që janë rezultat i arsimimit, kujdesit shëndetësor dhe trajnimit për punë (Todaro, 2015).

Marrëdhënia midis teorisë së kapitalit njerëzor dhe zhvillimit të burimeve njerëzore rrjedh nga fakti që të dyja në kuptimin e gjerë të tyre janë të përqendruara në forcën e punës dhe në procesin e produktivitetit ekonomik (Zidan, 2001: 437). Teoria e kapitalit njerëzor është një teori ekonomike që merret me makroekonominë e prodhimit dhe zhvillimin ekonomik. Kjo teori i shikon aftësitë njerëzore të tilla si dijen, aftësitë, shëndetin dhe përpjekjet – si një pjesë integrale e kapitalit të një vendi, sëbashku me burimet financiare dhe njerëzore. Premisa kryesore e kësaj teorie është që investimet e bëra për arsimimin e forcës punëtore dhe zhvillimin e aftësive të tyre (ndërmjet shërbimeve të tjera të tilla si ushqyerja dhe mirëmbajtja e shëndetit të tyre) do ti sillnin përfitime vendit në përpjekjen e tij për tu zhvilluar dhe mund të kontribuojnë për rritjen e prodhimit për çdo njësi fillestare. Përqasja kryesore e atyre që merren me studimin e kapitalit njerëzor është studimi i individëve si

burime të cilat duhen trajnuar, dhe zhvilluar brenda sistemit të një organizate me qëllimin për të rritur produktivitetin e organizatës nëpërmjet ekspertizës së forcës së saj të punës. Kjo lloj përjasje teorike i studion punonjësit si një burim i cili duhet trajnuar në mënyrë që të ruajë avantazhin konkurrues të korporatës, ndërmarrjes ose firmës në të cilën bëjnë pjesë dhe në mënyrë që të rrisin vlerën e saj në treg (Zidan, 2001: 437).

1.4. Delimitimi kohor i studimit

Ashtu siç e theksova dhe në paragrafët hyrës, disertacioni është i fokusuar në periudhën e tranzicionit ekonomik të Shqipëri, viti i fillimit i të cilit mendohet se është viti 1991 e deri në ditët tona. Kjo është një periudhë shumë dinamike e historisë ekonomike të Shqipërisë ku zhvillimi ekonomik u ri-përkufizua dhe u ri-zbatua me anë të mekanizmave dhe institucioneve të reja që i përkisnin ekonomisë së tregut. Megjithëse shumica e studiuesve bien dakort për kufijtë kohore të periudhës së tranzicionit, sërish ka shumë debate për datën e tij të nisjes si dhe nëse mund të quhet një periudhë e përfunduar. Ky disertacion më shumë së tranzicionit politik do ti referohet tranzicionit ekonomik, gjurmët e të cilit janë lehtësisht të identifikueshme në strukturën ekonomike të Shqipërisë dhe në institucionet e reja që vazhdojnë që të krijohen dhe të ri-formatohen sipas ligjeve të ekonomisë së tregut. Është zgjedhur kjo periudhë kohore për shkak të rëndësisë së saj, por sërish brenda kësaj periudhe mund të identifikohen ndarje dhe nënndarje të tjera specifike që i referohen zhvillimeve ekonomike brenda Shqipërisë.

1.5. Metodat e kërkimit shkurtimisht

Metodat e kërkimit janë përcaktuar duke u bazuar në dy kritere kryesore: 1) përzgjedhja dhe zbatimi i analizës së të dhënave dhe 2) rezultatet e pritshme. Përsa i përket kriterit të parë, përzgjedhja e të dhënave është bërë duke iu referuar studimeve të ndryshme akademike individuale apo edhe botime të raporteve vjetore të organizatave të njohura ndërkombëtare. Po ashtu edhe strategjitë dhe raportet e ndryshme të institucioneve shqiptare kanë shërbyer si burime parësore të të dhënave. Përjasja kryesore ka qenë që ‘zhvillimi ekonomik’ të studiohet sipas teorive të njohura të tilla si ajo konstruktiviste, që e sheh ‘zhvillimin’ si diçka të konstruktuar dhe jo si diçka të dhënë objektivisht në realitet por si diçka subjektive. Po ashtu është marrë parasysh paradigma e tranzicionit ekonomik

dhe nëndarjet e saj teorike. Në bazë të këtyre dy teorive kryesore janë analizuar dhe të dhënat e mbledhura nga burime parësore dhe dytësore.

Rezultatet e supozuara në fillim të studimit kanë ndikuar dhe në përzgjedhjen e metodave të kërkimit. Ajo që unë kërkoja të studioja ishte marrëdhënia që ekzistonte midis zhvillimit ekonomik dhe strukturës ekonomike të Shqipërisë, dhe ndikimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme në diversifikimin e tregut të punës. Rezultatet e pritshme, të konfirmuara nga studime të ndryshme të njohura botërisht, përshkruanin një zgjerim të tregut të punës, diversifikim të profesioneve, hapjen e pozicioneve të reja dhe një punësim sa më fluid dhe shtimin e dijeve dhe njohurive të përgjithshme të punonjësve. Në bazë të këtyre rezultateve të pritshme, u mblodhën të dhëna zyrtare dhe jo zyrtare për punësimin në Shqipëri dhe u bënë analiza për tendencat e ndryshme të tij ndër vite dhe pritshmëritë në të ardhmen.

Të dhënat konkrete në kapitujt në vazhdim do të përqendrohen në tre raste studimore, një kompani private, një bankë e nivelit të dytë dhe një kompani publike, dhe do të studiohet marrëdhënia midis arsimimit të punonjësve dhe të ardhurave të tyre mujore. Kjo gjë do të bëhet duke analizuar me anë të metodave të ekonometrisë dhe posaçërisht të analizës së regresionit të thjeshtë linear marrëdhënien midis variablit të pavarur të ‘edukimit’ dhe variablilit të varur të të ‘ardhurave’. Në një moment të dytë do të studiohet dhe marrëdhënia regresionale midis variablilit të pavarur të ‘edukimit’ dhe variablilit të ‘pozicionit të punës’. Të dhënat janë marrë nga materialet e brendshme të kompanive, por duke ruajtur privatësinë dhe etikën e studimit.

Përveç rasteve studimore do të trajtohen dhe tipare apo karakteristika të tjera të tregut të punës në marrëdhënien e tij me zhvillimin dhe rritjen ekonomike të tilla si: diversifikimit të profesioneve, zgjerimit të tregut të punësimit, fluiditetit të tij, hapjes ndaj tregut global të punës, e gjitha kjo mbështetur në kontekstin shqiptar. Të dhënat e kontekstit shqiptar do të bazohen në statistikat e institucioneve zyrtare shqiptare të tilla si INSTAT, por do të verifikohen edhe nga të dhënat e raporteve ndërkombëtare të tilla si ILO, studime të ndryshme akademike etj.

Analizimi i të dhënave do të bëhet me anë të programit statistikor SPSS. ‘Në fushën e ekonomikut, korrelacionet janë të zakonshme. Por është e vështirë që të identifikohet nëse ka korrelacion midis dy ose më shumë variablave dhe kjo marrëdhënie është shkakësore’ (Ramcharan, 2018). Zakonisht ekonomistët e përdorin metodën e regresionit linear për t’iu përgjigjur pyetjeve të tilla si: nëse individët më të arsimuar kanë të ardhura më të larta por kjo jo gjithmonë do të thotë që arsimimi sjell të ardhura më të larta. Njohja e përgjigjeve të sakta për këto çështje është e rëndësishme. Nëse çdo vit shkollim më shumë shkakton të ardhura më të larta, atëherë politikëbërësit duhet që të reduktojnë varfërinë duke financuar më shumë programe arsimimi. ‘Regresioni ndihmon për të kualifikuar apo përcaktuar sesa e afërt është marrëdhënia midis variablave’ (Ramcharan, 2018). Rezultatet dhe analiza e regresionit do të paraqitet në kapitujt në vijim dhe do të përfshijë analizimin e të dhënave të marra nga rastet studimore.

1.6. Paraqitje e shkurtër e kapitujve

Në kapitullin e parë u bë një paraqitje e përgjithshme e objektivave të studimit si dhe qëllimeve, pyetjeve kërkimore dhe tezës. Disa nga konceptet kryesore të cilat do të përdoren në studim u përkufizuan duke u limituar në delimitimet kohore dhe vendore të çështjes së marrë në studim. U përcaktuan qëllimet dhe objektivat e studimit si dhe teza dhe pyetjet kërkimore. Po ashtu u analizua sesi zhvillimi dhe rritja ekonomike ndikon te punësimi i individëve, duke u fokusuar në delimitimin e koncepteve të zhvillimit ekonomik, strukturës ekonomike, rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe tregut të punës. Në këtë kapitull u trajtuan dhe metodat e kërkimit shkurtimisht, duke u fokusuar te burimet parësore dhe dytësore dhe rastet studimore të kompanive publike dhe private.

Kapitulli i dytë do të përmbajë kornizën teorike dhe analitike të modeleve të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike. Do të shpjegojë në fillim modelin ekonomik tradicional dhe neoklasik si dhe ndryshimin midis ekonomisë politike dhe zhvillimit ekonomik. Por mbi të gjitha kapitulli i dytë do të mbështetet te modeli bashkëkohor i zhvillimit ekonomik dhe sidomos te konceptet e përfaqësimit të grupeve të marginalizuara dhe ai i lumturisë. Po ashtu, kapitulli i dytë do të trajtojë dhe kritikën ndaj modeleve të zhvillimit ekonomik si dhe do të trajtojë dhe strukturën ekonomike sipas përfaqësjes

institucionaliste. Në këtë kapitull do të ketë dhe një shpjegim për lidhjen që ekziston midis strukturës ekonomike dhe tregut të punës duke u bazuar te përbërësit institucionalë të strukturës ekonomike të tilla si: subvencionet qeveritare, ulja e taksave, sundimi i ligjit dhe të drejtat e pronësisë. Gjithashtu, në fund të kapitullit do të trajtohet dhe ekonomia e dijes dhe ndikimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme në tregun e punës.

Kapitulli i tretë përmban një analizë të tranzicionit ekonomik shqiptar duke iu referuar problematikës së tregut të punës dhe transformimeve që pësoi ai pas rënies së sistemit socialist apo ekonomisë së planit. Ky kapitull do të trajtojë burimet e transformimit ekonomik ose Terapinë e Shock-ut dhe pasojat më të rëndësishme të saj, deri në rastet më të fundit të privatizimeve si ai i Albpetrolit dhe ndikimet e tyre në tregun e punës dhe punësimin. Po ashtu do të ketë një analizë të detajuar të qëndrimeve zyrtare të Bankës Botërore, FMN-së dhe ndikimit të vazhdueshëm të BE-së. Në fund të kapitullit një seksion do ti dedikohet zhvillimit rajonal dhe rolit që ai luan aktualisht në strukturën ekonomike shqiptare dhe në mënyrë të tërthortë te punësimi dhe tregu i punës.

Kapitulli i katërt do të trajtojë zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike shqiptare sipas shifrave zyrtare si dhe dritëhijet e këtij zhvillimi. Këtu do të flitet për disa nga problemet që shqetësojnë ekonominë shqiptare në lidhje me tregun e punës të tilla si informaliteti dhe korrupsioni, PPP-të dhe investimet e huaja dhe sesi mund të mundësohet një rritje ekonomike e qëndrueshme në kushte të tilla e cila të nxisë dhe krijojë vende të reja pune.

Kapitulli i pestë bën një analizë të detajuar shkakësore midis zhvillimit të kapitalit njerëzor si pjesë e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe punësimin. Kjo gjë bëhet duke bërë një panoramë të shifrave zyrtare të INSTAT dhe strukturës së ekonomisë shqiptare e cila vazhdon që të mbetet shumë e centralizuar dhe ku vendin kryesor e zë punësimi në sektorin e shërbimeve dhe në bujqësi. Në këtë kapitull argumentohet që kjo mungesë e diversitetit dhe karakterit të teknologjisë së ulët të shportës së eksportit kontribuojnë në zgjerimin e defiçitit të jashtëm, duke e lënë ekonominë të ekspozuar ndaj krizave specifike të këtyre industrive. Defiçiti i tanishëm mbulohet nga volumi i gjerë i remitancave nga shqiptarët që jetojnë jashtë – duke arritur 8.6% të PPB-së në vitin 2017. Gjithashtu ekonominë e

ndihmon dhe industria e turizmit, e cila ka qenë në rritje me një mesatare prej 7.8% në vit për tre vitet e ardhshëm (OECD, 2019).

Kapitujt e gjashtë dhe shtatë përmbajnë dhe rastet studimore të disertacionit dhe konkretisht të dhënat dhe rezultatet e një kompanie private, një banke të nivelit të dytë si dhe të një kompanie shtetërore. Variablat e studiuara janë ato të edukimit dhe të ardhurave mujore në formën e pagës si dhe të pozicionit të punës. Në këto kapituj ka një përshkrim të detajuar të metodologjisë dhe rrugës që është ndjekur për analizimin e të dhënave, që është ajo e regresionit linear si dhe mënyra e nxjerrjes së tyre me anë të programit statistikor SPSS. Po ashtu përmban dhe metodën e përzgjedhjes së kampionimit dhe konsideratat etike gjatë zhvillimit të studimit.

Kapitulli i tetë analizon tregun shqiptar të punës dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme duke u bazuar në pesë indikatorë kryesorë: 1) Aftësitë për punë dhe punësimi; 2) Politikat kombëtare të punësimit; 3) Punësimi i të rinjve; 4) Mbrojtja dhe përfshirja sociale; 5) Punët e ardhshme dhe e ardhmja e punësimit në Shqipëri.

Në kapitullin e fundit jepen rekomandime dhe konkluzione në lidhje me gjendjen e tregut të punës në Shqipëri dhe zhvillimin dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme. Kjo gjë bëhet duke iu referuar jo vetëm statistikave kombëtare, raporteve të organizatave të njohura ndërkombëtare por edhe rasteve konkrete empirike dhe rezultateve të nxjerra nga ato.


KAPITULLI II: KORNIZA TEORIKE DHE ANALITIKE E MODELEVE TË NDRYSHME TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE RITJES EKONOMIKE

Në ditët tona ekzistojnë teori dhe modele të ndryshme analitike për zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike si pjesë e rëndësishme përbërëse e tij. ‘Teoritë dhe modelet e rritjes ekonomike theksojnë mënyrat e ndryshme në të cilat aktiviteti ekonomik i së tashmes mund të ketë një ndikim në zhvillimet ekonomike të së ardhmes dhe gjithashtu këto teori shërbejnë edhe për të identifikuar edhe burimet që mund të sjellin një rritje ekonomike të qëndrueshme’ (Boldeanu & Constantinescu, 2015: 329). Studiuesit dhe ekonomistët përsërisin vazhdimisht që rritja ekonomike është shumë e nevojshme për mirëqenien e qenieve njerëzore. Teoritë mbi rritjen ekonomike kanë evoluar duke u bazuar në kohëra dhe periudha të ndryshme në varësi të dinamikave të ekonomisë. Një rol të rëndësishëm në formulimin e koncepteve të reja kanë patur dhe progresi dhe zhvillimet e reja në fushën matematikore dhe statistikore (Boldeanu & Constantinescu, 2015: 329).

Pavarësisht debateve të ndryshme në teoritë e zhvillimit ekonomik që pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë viteve të fundit studiuesit kanë rënë dakort në disa parime kryesore që kanë të bëjnë kryesisht me faktin që: nuk ka një rrugë të vetme, strategji, program apo një model të vetëm ndaj një zhvillimi ekonomik të suksesshëm. Për më tepër, zhvillimi ekonomik nuk është i njëjtë me rritjen ekonomike. Rritja ekonomike matet më së shpeshti nga shkalla e rritjes e PPB-së, dhe është vetëm njëri aspekt i zhvillimit ekonomik. Ashtu siç kanë theksuar dhe Todaro dhe Smith (2009), zhvillimi ekonomik është një proces shumë dimensional i cili përfshin ndryshimin e strukturave sociale, qëndrimeve popullore, dhe institucioneve kombëtare, si dhe një përshpejtim të rritjes ekonomike, reduktimin e pabarazive, dhe zhdukjen e varfërisë. Kur krijohen politika, direktiva dhe programe zhvillimi për ekonomitë në tranzicion, duhen marrë parasysh çdo aspekt social, politik, teknologjik, historik dhe çdo aspekt tjetër i rëndësishëm për shtetin apo për shoqërinë. Këto janë disa nga postulatet kryesore të ekonomiksit të zhvillimit (Ateljeviç & Triviç, 2016: 2). Ajo që vlen të theksohet është që teoritë dhe modelet analitike në fushën e zhvillimit

ekonomik kanë marrë një hov të ri pas viteve 2000, vite të cilat shërbyen dhe si një moment reflektimi për vendet në tranzicion që nuk arritën dot të kapnin ritmin e zhvillimit të vendeve perëndimore.

Figura 2: Parimet kryesore të zhvillimit ekonomik sipas teorive postmoderniste



Gjatë këtyre viteve pati dhe një progres të konsiderueshëm në fushën e shkencave sociale duke iu përshtatur dhe ndryshimeve në nivel global, në mënyrë që të studioheshin rrjetet ndërkombëtare të prodhimit, humbja e rëndësisë së kufijve shtetërorë dhe territorialitetit si pasojë e zhvillimeve teknologjike në fushën e internetit dhe virtualitetit. ‘Ky lloj zhvillimi teorik tregoi që prodhimi dhe konsumi jo në mënyrë të domosdoshme janë të lidhura me një territor të caktuar dhe që duhen role të diferencuara të kushteve strukturore dhe

institucionale në shkallë të ndryshme gjeografike dhe përgjigje të ndryshme të organizimeve dhe strategjive të firmave dhe institucioneve shtetërore që formësojnë ekonominë globale përgjatë kohës dhe hapësirës. Teoria e rrjetit global të prodhimit pohon që natyra e trajektoreve të zhvillimit ekonomik në ekonomi të caktuara është shumë e varur nga proceset dinamike me të cilat përballen firmat në nivel lokal apo ndërkombëtar duke udhëhequr rrjetet globale të prodhimit (Coe et al.: 2015, 34). Duke qenë se zhvillimi ekonomik është dhe një process shumë dinamik dhe shumë dimensional ai nënkupton faktorë dhe kritere të ndryshme përcaktuese në kohë dhe hapësira territoriale të ndryshme. Sidoqoftë më poshtë do të përmend shkurtimisht disa nga modelet kryesore të rritjes ekonomike.

2.1. Modelet teorike të rritjes ekonomike

Për shumë kohë, zhvillimi ekonomik u studiua në terma të ngushtë ekonomikë, duke u matur me të ardhurat për frymë të cilat sipas teorisë tradicionale të zhvillimit do të mundësonte që një vend të zgjeronte prodhimin e tij në një shkallë më të madhe sesa hapi i rritjes së tij të popullsisë. Domethënë matja e zhvillimit ekonomik në teorinë tradicionale të zhvillimit bëhej duke matur shkallën e rritjes së të ardhurave për frymë reale dhe duke hequr shkallën e inflacionit, kjo llogaritje shërbente për të matur mirëqenien e përgjithshme të popullsisë – dhe sesa nga këto të mira dhe shërbime përdoreshin nga qytetari mesatar për konsum dhe për investime.

Në të shkuarën zhvillimi ekonomik është studiuar gjithashtu sipas termave të alternimit të planifikuar midis strukturës së prodhimit dhe punësimit, ku prodhimi dhe punësimi në bujqësi duhej të ulej dhe të shtohet prodhimi dhe shërbimet industriale (Todaro & Smith, 2015:16). Kështu që bazuar në këto parime teoritë e zhvillimit u përqendruan më shumë në industrializimin e shpejtë dhe që më së shumti kufizonte zhvillimin bujqësor apo zhvillimin rural. Me përjashtime të pakta, një politikë e këtillë zhvillimi që qarkullonte nga vitet 1970-të dhe deri gjatë viteve të fundit, është parë gjithmonë si një fenomen ekonomik, i cili do të nxiste punësimin dhe mundësitë e tjera të nevojshme për një mirëqenie ekonomike dhe sociale. Problemet që shkaktonte ky lloj zhvillimi të tilla si varfëria, diskriminimi, papunësia, dhe shpërndarja e të ardhurave ishin të një rëndësie dytësore përpara qëllimit të

realizimit të një rritje ekonomike të lartë. Sepse në të vërtetë theksi vendosej në rritjen e prodhimit, i cili matej duke vlerësuar Prodhimin e Përgjithshëm Bruto (PPB) (Todaro & Smith, 2015:17).

Modeli i zhvillimi ekonomik tradicional ose neoklasik

Ekonomiksi tradicional ka të bëjë kryesisht me shpërndarjen efikase, me kosto më të ulët të burimeve të pakta prodhuese dhe me rritjen optimale të këtyre burimeve me kalimin e kohës, në mënyrë që të prodhojë një gamë sa më të gjerë të mallrave dhe shërbimeve. Ekonomiksi tradicional neoklasik përfytyron një botë të avancuar kapitaliste dhe që është e përbërë nga një situatë perfekte e tregut; konsumatorët janë të pavarur në zgjedhjet e tyre, çmimet rregullohet në mënyrë automatike si pasojë e konkurrencës në tregun ‘perfekt’, vendimet merren në bazë të përlllogaritjeve utilitare dhe të udhëhequra nga përfitimi privat; dhe arritja e ekuilibrit në të gjitha prodhimet dhe burimet e tregjeve. Ekonomiksi neoklasik nënkupton një lloj ‘racionaliteti’ ekonomik dhe një orientim të pastër materialist, individualist dhe të vetë-përqendruar drejt vendimmarrjes ekonomike (Todaro & Smith, 2015: 17).

Shpesh në literaturën për ekonomiksin neoklasik përmenden dhe faktorët demografikë, si një nga pengesat, që nuk iu mundësuan vendeve më të ardhura të ulta, që të kishin zhvillim të shpejtë. ‘Një rritje prej 3 përqind e të ardhurave për frymë në vit në një vend të caktuar do të kërkonte një rritje vjetore të popullsisë gjithashtu prej 3 përqind. Në këtë mënyrë, është arsyetuar që këto vende duhet që të kishin një rritje të kontrolluar të popullsisë. Por në vend të kontrollit të numrit të popullsisë, vendet me rritje ekonomike të ulët patën një hov në rritjen e numrit të popullsisë, jo dhe aq për shkak të numrit të lartë të lindjeve, por për shkak të rënies së numrit të vdekjeve në periudhën post-koloniale të viteve 1950 -1960. Megjithatë, në teorinë e përgjithshme të tranzicionit demografik pohohet që zhvillimi ekonomik në vetvete, në fazën e tij fillestare, shkakton një rritje të numrit të popullsisë dhe shkalla e vdekshmërisë tenton që të ulët- ndërkohë që procesi i zhvillimit kalon nga faza fillestare në atë përfundimtare. Megjithëse kontrolli numrit të popullsisë është një kërkesë thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm, është tashmë e njohur që kjo politikë në

vetvete, sado efikase që të jetë, nuk do të ishte një kusht i mjaftueshëm për rritje ekonomike (Ghosh & Siddique, 2015: 4).

Ndërkohë që ekonomia politike shkon përtej studimit të ekonomiksit tradicional, dhe studion dhe proceset sociale dhe institucionale nëpërmjet të cilave disa grupe të elitave ekonomike dhe politike ndikojnë në shpërndarjen e burimeve të pakta në kohën e tanishme dhe në të ardhmen, vetëm për përfitimet e tyre personale apo dhe për përfitimet e popullsisë. Në këtë mënyrë, ekonomia politike është e interesuar për studimin e marrëdhënies midis politikës dhe ekonomiksit, me një theks të vecantë në rolin e pushtetit në vendimmarrjen ekonomike. Ndërkohë që sipas Todaro & Smith (2015) ekonomiksi i zhvillimit ka një qëllim akoma dhe më të madh. ‘Në vend që të jetë i interesuar me shpërndarjen efikase të burimeve prodhuese të pakta ose të pamjaftueshme dhe me rritjen e tyre të qëndrueshme me kalimin e kohës, ekonomiksi i zhvillimit merret edhe me mekanizmat ekonomike, sociale, politikë dhe institucionale, si për sektorin publik dhe atë privat, i nevojshëm për të sjellë përmirësime të shpejta dhe të përhapura gjerësisht në nivelin e jetesës të njerëzve që jetojnë në Afrikë, Azi, Amerikën Latine dhe në vendet ish socialiste në tranzicion (Todaro & Smith, 2015: 10).

Ndryshimi midis ekonomisë politike dhe zhvillimit ekonomik

Në krahasim me vendet e zhvilluara, në vendet më pak të zhvilluara, tregjet e mallrave dhe të burimeve natyrore janë në mënyrë tipike jo perfekte, konsumatorët dhe prodhuesit kanë informacion të kufizuar, ndryshime të mëdha strukturore po zhvillohen si në shoqëri ashtu dhe në ekonomi, dhe potencialisht ekzistojnë disa ekuilibra dhe jo vetëm një, dhe si pasojë e këtyre ekuilibrave të shumëfishta mbizotërojnë situata c’ekuilibrimi (çmimet nuk i përgjigjen ofertës dhe kërkesës). Në shumë raste, përlllogaritjet ekonomike janë shumë të ndikuara nga prioritetet politike dhe sociale të tilla si unifikimi i vendit, zëvendësimi i këshilltarëve të huaj me vendimmarrës lokalë, zgjidhjen e konflikteve ndërmjet etnive apo fiseve të ndryshme, ose konsideratat fisnore mbizotërojnë mbi interesat private, përfitimin personal ose përlllogaritjet mbi maksimizimin e përfitimit. Kështu, ekonomiksi i zhvillimit, më shumë sesa ekonomiksi tradicional neoklasik ose madje dhe akoma më shumë se ekonomia politike është i interesuar për kërkesat ekonomike, kulturore dhe politike për

transformimin e shpejtë strukturor dhe institucional të shoqërive në tërësi si një mënyrë që do të sillte frytet e progresit ekonomik segmenteve më të gjera të popullsisë së tyre. Para së gjithash i duhet që të gjejë mekanizmat që i mbajnë familjet, rajonet dhe madje kombe apo shtete të tëra në varfëri, në të cilat varfëria e së kaluarës shkakton varfërinë e së ardhmes, dhe strategjitë më efektive për tu çliruar nga këto pengesa. Në këtë mënyrë, një rol më i madh dhe i zgjeruar i qeverisë dhe një shkallë e madhe e koordinimit të vendimmarrjes ekonomike drejt transformimit të ekonomisë shihen si komponentët më të rëndësishëm të ekonomiksit të zhvillimit. Dhe kjo gjë duhet arritur duke pasur parasysh që si qeveritë ashtu dhe tregjet funksionojnë në mënyrë më pak efikase në vendet në zhvillim. Gjatë viteve të fundit, aktivitetet e organizatave joqeveritare, si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel ndërkombëtar, janë rritur në mënyrë të shpejtë dhe është rritur edhe vëmendja ndaj tyre. Për shkak të heterogjenitetit të botës në zhvillim dhe kompleksitetit të procesit të zhvillimit, ekonomiksi i zhvillimit duhet të jetë eklektik, që do të thotë të përpiqet që të kombinojë konceptet përkatëse me teoritë nga analiza e ekonomiksit tradicional me modelet e reja dhe përjasjes shumë disiplinore që rrjedhin nga studimi i zhvillimit historik dhe bashkëkohor i eksperiencave në Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine. Ekonomiksi i zhvillimit është një fushë e re në majën e një dallge të fuqishme, me teori dhe të dhëna të reja që zhvillohet pa pushim. Këto teori dhe statistika disa herë konfirmojë dhe disa herë sfidojnë mënyrat tradicionale të të shikuarit të botës. Qëllimi përfundimtar i ekonomiksit të zhvillimit, sidoqoftë për Todaro & Smith (2015) mbetet i pandryshuar: për të na ndihmuar që të kuptojmë ekonominë në zhvillim në mënyrë që të përmirësojmë jetën materiale të shumicës së popullsisë globale (Todaro & Smith, 2015: 10).

Modeli bashkëkohor i zhvillimit ekonomik

Megjithatë tendencat më të fundit në teoritë dhe modelet analitike të zhvillimit tentojnë të kapërcejnë vlerat materiale dhe të integrojnë dhe vlerat shpirtërore të individëve të tilla si shkalla e zgjedhjeve dhe lirive individuale dhe shkalla e lumturisë. Sipas Amartia Sen zhvillim do të thotë të reduktohen mangësitë apo të zgjerohen mundësitë. Mangësitë përfshijnë një element shumë dimensional të varfërisë që përfshin urinë, analfabetizmin, sëmundjet dhe shëndetin e dobët, mungesën e fuqisë, të mos paturit një zë në

vendimmarrje, pasigurinë, turpërimin, dhe mungesën e aksesit në infrastrukturën kryesore. Për më tepër Sen sugjeron që zhvillimi është procesi i zgjerimit të lirive të vërteta që gëzojnë individët. Zhvillimi është procesi i përmirësimit të cilësisë së të gjithë jetëve njerëzore dhe aftësive të tyre duke ngritur nivelin e tyre të jetesës dhe vetë-vlerësimin. Pantelis Sklias dhe Giota Chatzimichailidou (2016) argumentojnë që zhvillimi ekonomik është edhe një ‘proces’ por edhe një ‘gjendje’. Është një proces sepse ai përfshin mjetet me anë të të cilave një shoqëri mund të transformohet drejt një përmirësimi të jetëve njerëzore dhe një gjendje në të cilën njerëzit ndihen më të kënaqur, më të sigurtë dhe kanë mundësi të barabarta për të punuar dhe për të pasur akses te infrastruktura kryesore apo bazike (Sklias & Chatzimichailidou, 2016: 148).

Zhvillimi ekonomik dhe lumturia

Teoritë më të fundit mbi zhvillimin ekonomik tentojnë ta studiojnë atë të lidhur me mirëqenien shpirtërore dhe me një lumturi më të madhe për njerëzimin. Për shembull gjatë viteve të fundit janë bërë studime sesi ndikojnë të ardhurat në gjendjen e kënaqësisë dhe lumturisë së individëve (Todaro & Smith, 2015: 22). Kjo na kthen dhe njëherë të analiza se cilat janë vlerat kryesore që përbëjnë zhvillimin. Shumica prej ekonomistëve bien dakort që tre vlerat kryesore të zhvillimit janë: niveli bazik i jetesës, vetë-vlerësimi dhe liria- dhe këto vlera paraqesin qëllimet që kërkohen nga të gjithë individët dhe shoqëritë kudo nëpër botë (Ibid).

Zhvillimi ekonomik dhe përfaqësimi i grupeve të marginalizuara

Gjatë dekadave të fundit programet dhe strategjitë e zhvillimit kanë qenë të lidhura gjithnjë e më shumë me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara të tilla si gratë apo pakicat etnike. Akademikë të ndryshëm kanë parë te përfaqësimi dhe pjesëmarrja e këtyre grupeve faktin që ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. ‘Ndërkombëtarisht, gratë kanë tendencë që të jenë më të varfra sesa meshkujt. Ato janë gjithashtu më të penguara përsa i përket aksesit ndaj kujdesit shëndetësor dhe arsimimit si dhe lirive të formave të ndryshme. Për më tepër gratë, janë përgjegjëset kryesore për rritjen e fëmijëve dhe mënyra sesi ato e zhvillojnë këtë detyrë përcakton edhe nëse trashëgimi i varfërisë brez pas brezi do të ndërpritet’ (Todaro & Smith, 2015:24).

Kritikat ndaj modeleve të zhvillimit ekonomik

‘Zhvillimi’ nuk ka qenë vetëm një proces i diskutuar por gjithashtu dhe shumë i kritikuar nga akademikë dhe studiues të ndryshëm. Këto kritika kanë përcaktuar dhe modelet e reja teorike që kanë tentuar të bëjnë ndryshimet përkatëse. Në radhë të parë ‘zhvillimi’ është kritikuar si një përjasje nga lartë – poshtë, etnocentrike si dhe teknokratike, e cila i trajtonte popujt dhe kulturat si koncepte abstrakte, si të dhëna statistikore të cilat duhet të ngriheshin dhe të uleshin në shkallët drejt ‘progresit’(Escobar, 1995: 44).

2.2. Struktura ekonomike sipas përjasjes institucionaliste

Në literaturë, ‘strukturat ekonomike’ nuk janë trajtuar asnjëherë nga ana teorike si të veçuara, por janë studiuar sëbashku me narrativat gjeografike dhe institucionale. Me gjeografinë zakonisht janë nënkuptuar faktorët natyrorë të tillë si klima, relievi dhe temperatura, të cilat kanë ndikim në rezultatet ekonomike, dhe institucionet i janë referuar detyrimeve njerëzore që strukturojnë ndërveprimin politik, ekonomik dhe social. Ndërkohë që strukturat ekonomike janë përkufizuar si një agregat i përfaqësimit të kapaciteteve/ aftësive teknologjike të një vendi të caktuar (Constantine, 2017). Historikisht, gjeografia apo pozita gjeografike ka qenë përcaktuesi më i hershëm i mbarëvajtjes së prodhimit. Disa vende ishin më shumë të zhvilluara për shkak të mundësive të ndryshme të prodhimit dhe aksesit ndaj brigrjeve detare. Por me zhvillimin e teknologjive moderne, faktorët gjeografikë filluan që të bëhen gjithnjë e më pak të rëndësishëm.


Nga ana tjetër dhe përjasja institucionale filloi që të studiohej si një faktor i rëndësishëm dhe që ndikonte fuqimisht në strukturën ekonomike të një vendi të dhënë. Në këtë mënyrë, ‘në fillim të viteve 1990-të kishte një konsensus midis ekonomistëve dhe studiuesve të shkencave politike që dështimet në zhvillimin ekonomik në shumë vende afrikane dhe ato aziatike mund të shpjegoheshin në mënyrë tjetër. Në vitin 1992, Banka Botërore (BB) botoi raportin e saj për Qeverisjen dhe Zhvillimin, i cili ishte i përqendruar te fakti që qeverisja ishte një kusht i domosdoshëm për zhvillim. Në këtë raport BB analizonte termin e qeverisjes dhe rëndësinë e tij për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm’ (Ghosh & Siddique, 2015: 4). Sipas këtij raporti ‘edhe në shoqëritë që ishin ekstremisht të drejtuara nga tregu, vetëm qeveritë mund të siguronin dy të mira publike: rregullat që tregjet të

funksiononin në mënyrë efektive dhe ndërhyrjet korrektuese atëherë kur tregu dështonte. Pa respektimin e ligjeve, pa institucione mbështetëse dhe pa kornizën ligjore shtetërore për të krijuar dhe zbatuar rregullat, sundimin e ligjit dhe të rendit, për të siguruar të drejtat e pronësisë, prodhimi dhe investimet do të zvogëloheshin dhe zhvillimi do të ngadalësohej. Kjo sepse kostot e transaksioneve do të ishin shumë të larta (kostot e krijimit, monitorimit dhe zbatimit të kontratave). Kompensimi për dështimin e tregjeve është akoma më problematik (Banka Botërore, 1992: 6). Raporti e vinte theksin mbi ‘karakteristikat institucionale’ të shoqërive, dhe që ekonomistët institucionalistë në mënyrë që të kuptonin më mirë se se karakteristikat ishin të ndryshme në shoqëri të ndryshme duhet që të njihnin më mirë ndërveprimi midis kulturës dhe rregullave dhe institucioneve formale (Banka Botërore, 1992: 8). Raporti i BB-së konkludonte që në mënyrë që të arrihej një zhvillim i qëndrueshëm, duhej të kishte një kornizë ligjore dhe institucionale transparente dhe të parashikueshme për zhvillimin e biznesit publik dhe privat [...] dhe kjo administratë qeverisëse nuk duhej që të ishte e korruptuar (Ghosh & Siddique, 2015: 4).

Nga ana tjetër, termi i ‘strukturës ekonomike’ është një term paksa pexhorativ në vendet si Shqipëria, të cilat kanë pasur një të kaluar komuniste. Por megjithëse e përmendur shpeshherë në ideologjinë marksiste dhe në fjalime të gjata dhe monotone të periudhës para viteve 1990-të, struktura ekonomike prodhuese e një vendi nuk është gjë tjetër veçse një rezultat i përgjithshëm i aftësive të tij teknologjike. E shpjeguar thjeshtë nga Collin Constantine (2017) ‘disa të mira të tilla si produktet e prodhuara me teknologji të lartë janë të afta që ti rrisin të ardhurat, ndërkohë që ‘të mira’ të tjera si për shembull bananet janë të njohura për të ulur fitimet me kalimin e kohës. Një vend i caktuar ka një strukturë prodhuese në rritje nëse prodhon të mira materiale që janë të sofistikuar nga ana teknike dhe e kundërta – ka një strukturë ekonomike në rënie nëse prodhon të mira që janë të thjeshta nga ana teknologjike (Constantine, 2017: 2). Studiues të ndryshëm sugjerojnë që një vend mund t’i rrisë fitimet në strukturën e tij ekonomike nëse bën ndryshime strukturale si për shembull në ‘institucionet e prodhimit’ zbatohen në mënyrë adekuate nga shteti. ‘Institucionet e prodhimit’ përfshijnë politikat industriale të tilla si tarifatat, subvencionet etj ndërsa ‘institucionet e shkëmbimit’ përfshijnë të drejtat e pronës, sundimin e ligjit etj. Është

e qartë se pa një sundim minimal të ligjit dhe pa një legjislacion të mirë për të drejtat e pronësisë, prodhimi vështirë që të realizohet. Sidoqoftë, institucionet e shkëmbimit të tilla si e drejta e pronës dhe sundimi i ligjit nuk garantojnë prodhimin apo prodhimin e të mirave dhe fitimet që rrjedhin prej tyre. Ato janë kushte të domosdoshme, por të vetme janë kushte të pamjaftueshme për të nxitur prodhimin e të mirave materiale. Zbatimi në mënyrën e duhur të subvencioneve qeveritare dhe uljeve të taksave mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në nivelet e prodhimit dhe të incentivojë prodhimin e disa të mirave materiale në krahasim me disa të tjera (Constantine, 2017: 2).

Figura 3: Përbërësit institucionalë të strukturës ekonomike



Ndërkohë që duke iu referuar North (1990) institucionet janë rregullat dhe rregulloret që strukturojnë ndërveprimin politik, ekonomik dhe social (North, 1990: 3). Sipas tij, institucionet përbëhen si nga rregullat formale (kushtetutat, ligjet, të drejtat e pronës) dhe nga detyrimet informale (sanksionet, tabutë, zakonet, traditat dhe kodet e sjelljes). Qëllimi kryesor i tyre është që të përcaktojnë rregullat e lojës, të monitorojnë proceset dhe zbatueshmërinë e tyre. ‘Institucionet e papërshtatshme janë shpeshshërë pengesa kryesore me të cilat përballen sipërmarrësit në ekonomitë në tranzicion. Në fakt njëra nga gabimet kryesore të të gjitha ekonomitë në tranzicion është besimi i verbër te tregu’ (Ateljevic & Trivic, 2016:2). Ndërkohë që ‘zhvillimi’ konceptohet si një proces shumë

dimensional që përfshin ndryshime kryesore në strukturën sociale, qëndrimet publike, dhe institucionet shtetërore, si dhe rritje ekonomike, reduktim të pabarazive, dhe zhdukje të varfërisë. Në thelbin e tij, zhvillimi, duhet të përfaqësojë të gjithë gamën e ndryshimit të sistemit social në tërësinë e tij, duke zhvilluar jo vetëm nevojat bazë por duke transformuar dhe aspiratat e individëve dhe grupeve sociale brenda atij sistemi, dhe duke lëvizur nga një situatë e cila përshkruhet si e pakënaqshme drejt një shtate ku kushtet e jetesës konsiderohen si më të mira si nga ana shpirtërore ashtu dhe nga ajo shpirtërore (Todaro & Smith, 2015: 1).

Acemoglu & Robinson (2013) bëjnë dallimin midis institucioneve ‘ekstraktuese’ dhe atyre ‘përfshirëse’. Institucionet ekstraktuese i referohen institucioneve politike jo-demokratike, sundimit të dobët të ligjit dhe mungesës së të drejtave të pronës private. Institucionet përfshirëse sipas tyre janë rrjeti i institucioneve demokratike, sundimi i fortë i ligjit dhe mbrojtja e pronës private. Ato argumentojnë që janë institucionet demokratike ato që nxisin rritjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik ndërkohë që Collin Constantine thekson që vendet që kërkojnë të zhvillohen nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm duke kopjuar institucionet e shkëmbimit (sundimin e ligjit dhe të drejtat e pronësisë) nga vendet e zhvilluara. Meqenëse atyre iu mungojnë teknologjitë prodhuese kanë nevojë për subvencione të fuqishme financiare si dhe amnisti fiskale në mënyrë që të nxitet prodhimi i të mirave materiale (Constantine, 2017: 3). Për më tepër sëbashku me Tarron Khemraj argumentojnë që shpërndarja e burimeve natyrore nuk është e pavarur nga strukturat ekonomike prodhuese. Kështu që ata rekomandojnë më shumë politika industriale sesa refoma institucionale si mjete për të ndryshuar strukturat ekonomike (Constantine & Khemraj, 2019: 11).

2.3. Lidhja që ekziston midis strukturës ekonomike dhe tregut të punës

Ashtu siç argumentova dhe në pjesët më sipër, struktura ekonomike është shumë e lidhur me avancimin teknologjik të një vendi. Nga ana tjetër, vetë teknologjia është diskutuar shumë në lidhjet e saj me tregun e punës, nëse hap vende të reja pune apo nëse i shkurton ato dhe nxit më tepër papunësinë. ‘Gjatë viteve 1990-të papunësia masive u kthye në një problem madhor në vendet e industrializuara, veçanërisht për Evropën, ku kjo çështje u

shoqërua dhe me tensione të mëdha sociale. Një nga arsyet kryesore ishte situata e pakënaqshme e punësimit e nxitur nga mjedisi ekonomik që ishte karakterizuar nga ndryshimet e shpejta teknologjike, ku puna si një faktor prodhimi, ishte zëvendësuar në mënyrë gjithnjë e më të madhe nga teknologjitë e reja’ (Ebersberger & Pyka: 635). Zakonisht ekonomistët neo-klasikë e shpjegojnë këtë fenomen me rënien e çmimit të krahut të punës, ose që të mund të ketë punësim masiv atëherë duhen ulur çmimet e krahut të punës ose duke reduktuar shkallën e rritjes së pagave, e cila nuk duhet që të tejkalojë shkallën e rritjes së prodhimit. Megjithatë Katsoulacos (1984, 1986) në studimet e tij shtoi shpjegime të tjera në lidhje me krijimin e punësimit nëpërmjet prezantimit të inovacioneve në prodhim dhe që do të mund të përkufizohej si ‘punësim ndërmjet inovacionit’ (Ebersberger & Pyka, 2002: 636).

Figura 4: Ndikimi i teknologjisë dhe inovacionit te Tregu i Punës



Constantine dhe Khemraj kanë arritur në përfundimin që strukturat ekonomike kanë një rol të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe për punësimin për shkak të faktorëve që do të rendis më poshtë:

Së pari, vlerat e shtuara të larta në aktivitetet ekonomike prodhohen në tregje konkurruese jo perfekte gjë që bën që pagat dhe përfitimet të mbeten të larta për periudha më të gjata kohore. Kjo gjë përforcon kërkesën dhe rritjen ekonomike të brendshme.

Së dyti, Dasgupta & Stiglitz (1980) shpjegojnë që tregjet konkurruese jo perfekte janë më të prirur drejt inovacionit dhe progresit teknologjik – gjë e cila është mbështetur së fundmi dhe nga Andreoni (2014).


Së treti, strukturat e prodhimit të bazuara në aktivitete ekonomike që rrisin të ardhurat kanë më shumë gjasa që të hedhin farat e tranzicionit dhe konsolidimit demokratik dhe të drejtat demokratike të pronës janë thelbësore për përhapjen e teknologjisë.

Së katërti, aktivitetet ekonomike me të ardhura në rritje gëzojnë një elasticitet më të madh përsa i përket kërkesës në tregjet eksportuese dhe kjo i bën ata nxitës idealë në ekonominë shumë të hapura.

Së pesti, shkallët në karrierë janë më të gjata për aktivitetet ekonomike që kërkojnë teknologji të larta dhe shërbejnë si një mekanizëm i rëndësishëm për mobilitetin në punë, gjë e cila përmirëson dhe shpërndarjen e të ardhurave.

Së gjashti, struktura ekonomike e një vendi është një përcaktues i rëndësishëm për shpërndarjen e kapitalit njerëzor midis sipërmarrjes dhe huamarrjes dhe në mënyrë indirekte ndikon procesin e rritjes ekonomike me anë të tregut të punës. Kjo vjen si pasojë e strukturave ekonomike të prodhimit që kanë një teknologji të lartë dhe që ndikojnë në rritjen ekonomike sepse stimulojnë kërkesën për pasuri duke krijuar aktivitete të tilla si sipërmarrja. Strukturat ekonomike në një periudhë të caktuar kohore nuk përcaktojnë vetëm madhësinë e rritjes ekonomike por gjithashtu dhe shpërndarjen e të ardhurave.

Figura 5: Ndikimi i strukturës ekonomike në shpërndarjen e të ardhurave



Një strukturë ekonomike prodhimi e bazuar në një sërë produktesh komplekse ka më shumë gjasa që të ketë një gamë më të gjerë mundësish punësimi, një hierarki me bazë më të gjerë punësimi, një shpërndarje më të madhe dhe të gjerë të aftësive për punë dhe të dijeve dhe

një ndërgjegjësim më të madh për të drejtat në punë. Nga studime të ndryshme ka rezultuar që ekonomitë relativisht më komplekse kanë një limit strukturor në rritje për të ardhurat më të larta që mund të arrijnë, një ndarje më të mirë të të ardhurave dhe një shtresë të mesme më të fortë – gjë që përkthehet në më pak pabarazi (Constantine & Khemraj, 2019).

Një rol të rëndësishëm luan gjithashtu dhe e ashtuquajtura ‘ndërvlerësia strategjike’. Vendimet optimale varen pjesërisht edhe nga ajo që bëjnë të tjerët. Kështu, dëshira e njerëzve për më shumë arsimim varet dhe nga mundësitë e punësimit që ofrohen për njerëzit e arsimuar, nga përgjigjet që merrni nga shoqëria në lidhje me kostot dhe përfitimet e arsimimit të mëtejshëm, si dhe normat dhe respekti për shkollimin që ekziston në një shoqëri të caktuar (Wydick, 2008:7). Si përfundim mund të themi që, zakonisht, të mirat materiale të prodhuara nga teknologji me cilësi të lartë dhe komplekse prodhohen nga struktura tregu që sjellin inovacione dhe nxisin të ardhura dhe përfitime më të larta në një periudhë më të gjatë kohore. Këto të ardhura të larta sigurojnë shkallë karriere më të gjata dhe shërbejnë si mjete për punësimin për tu ngjitur përgjatë klasave sociale, të cilat përmirësojnë shpërndarjen e të ardhurave. Ka një konsensus ndërmjet studiuesve që sa më e ulët të jetë pabarazia ekonomike dhe sociale aq më e shpejtë dhe intensive do të jetë rritja ekonomike. Për më tepër, tranzicionet demokratike kanë më shumë gjasa që të rrisin të ardhurat e strukturave të prodhimit dhe kjo rrit përhapjen e dijeve teknike të cilat janë shumë të rëndësishme dhe një ndër faktorët kryesorë për rritjen ekonomike (Constantine, 2017: 2).


2.4. Ekonomia e dijes

Shkalla e lartë e rritjes ekonomike, që ndodhi në disa shtete duke filluar së paku nga shekulli i 18-të deri në dekadat e fundit, u shoqërua dhe me procese të tjera sociale dhe ekonomike ku më së shumti është fjala për akumulimin e dijeve, njohurive dhe inovacioneve teknologjike (Kuznets, 1989:8). Procesi i dytë i rëndësishëm ishte zhvendosja në strukturën ekonomike të prodhimit, në shpërndarjen midis sektorëve të ndryshëm të prodhimit të tilla si prodhimi, puna dhe kapitali dhe të një marrëdhënie të ngushtë midis shkallës së lartë të prodhimit për frymë dhe shkallës së lartë të zhvendosjes ndërmjet sektorëve të ndryshëm të prodhimit. Tendenca e tretë më e rëndësishme kishte të bënte me

faktin që rritja ekonomike moderne u pa e lidhur me funksionet dhe ndikimet komplekse të shtet-kombit sovran (Kuznets, 1989: 8). Megjithatë gjatë dekadave të fundit, interesi ndaj dijeve, inovacionit dhe teknologjisë në lidhje me rritjen ekonomike ka ardhur gjithnjë në rritje. Kjo sepse revolucioni industrial i shekullit të 19-të dhe revolucion shkencor i shekullit të 20-të i kanë dhënë një rëndësi të madhe njohurive apo dijeve për zhvillimin ekonomik. Themelet e ekonomisë së dijes mund të gjenden në teoritë e reja të rritjes ekonomike gjatë viteve 1950-të. Gjatë kësaj kohe Drucker prezantoi termin ‘ekonomi e dijes’ që theksonte rëndësinë që kishte dija dhe teknologjia për rritjen ekonomike dhe për zhvillimin ekonomik (Donlagic & Kurtic, 2016: 92). Përveçse ekonomia e dijes është e lidhur me teknologjinë dhe strukturat ekonomike, ato ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në shpërndarjen e vendeve të punës dhe të talentit njerëzor.

Sidoqoftë, ashtu siç u shpjegua dhe më lart, strukturat e prodhimit e ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë tregun e punës apo më konkretisht shpërndarjen e talentit në të. Sipas Collin Constantine ‘një strukturë ekonomike e dhënë ka një shpërndarje të dhënë punësimi, dhe të ardhurat për aktorët kryesorë janë shumë më larta se talenti i tyre si sipërmarrës’. Sipas tij ‘punësimi është një burim i rëndësishëm i pushtetit politik *de facto*, dhe kjo ndikon në rirforcimin e strukturës ekonomike për të ruajtur shpërndarjen e punësimit. Kjo krijon një ekuilibër midis pushtetit politik, institucioneve dhe strukturave ekonomike (Constantine, 2017: 3).

Figure 6: Ndryshimet që solli rritja ekonomike e qëndrueshme në vendet e zhvilluara (Kuznets, 1989)



Por, ekonomia e dijes nuk mund të zhvillohet pa një sistem efikas dhe modern arsimimi apo edukimi. Në vitin 2012, gjatë zhvillimit të konferencës së Këshillit të Ministrave të BE-së për procesin e Bolonjës është vlerësuar që ‘arsimi i lartë është një pjesë e rëndësishme e zgjidhjeve të vështirësive të tanishme. Sistemet arsimore të forta dhe të përgjegjshme sigurojnë bazat për shoqëritë e dijes. Arsimi i lartë duhet të jetë në zemër të përpjekjeve për të tejkaluar krizat e tanishme më shumë se asnjëherë më përpara’ (Donlagiç & Kurtiç, 2016: 92). Gjithashtu kjo konferencë vlerësonte që arsimi i lartë mund të kontribuonte në rritjen e konkurrencës në ekonomi. Sistemi arsimor në ekonominë e dijes luan një rol të rëndësishëm për të gjeneruar kushtet për investime në krijimin dhe përdorimin e dijeve dhe teknologjive të reja të cilat janë jetësore për rritjen e prodhimit dhe për të siguruar një rritje ekonomike sa më të qëndrueshme. Shumë ekonomistë theksojnë rëndësinë e arsimimit dhe sidomos të arsimimit të lartë në ekonominë e dijes për shkak të rolit që luajnë institucionet e arsimimit në krijimin dhe transferimin e njohurive të reja. Është për këtë arsye që vendet që i përkasin OECD-së investojnë përafërsisht 12% të buxhetit të tyre në arsimim (Ibid).

Zakonisht me inovacion teknologjik kuptohet një mënyrë e re për prodhimin e të mirave ekzistuese ose të atyre të reja. Sipas Kuznets (1989) përderisa kemi të bëjmë me inovacion teknologjik do të thotë që janë metoda të reja që kanë zëvendësuar metodat e vjetra dhe që këto metoda të reja e kanë rritur prodhimin dhe në këtë mënyrë kanë ndikuar dhe te një rritje ekonomike më e madhe. Një gjë e tillë do të thotë që teknologjia shpesh përdoret për të kontrolluar natyrën (duke përfshirë dhe natyrën fiziologjike dhe sociologjike njerëzore) për të arritur qëllimet e njerëzimit dhe qëllimet ekonomike ndërmjet tyre; përderisa lidhja ndërmjet teknologjisë dhe inovacionit sjell rritje të prodhimit (Kuznets, 1989: 9). Por, përveç aspektit të dijeve dhe teknologjisë, duhen patur parasysh dhe aspekte të tjera. Kështu për shembull Ebersberger & Pyka kur shkruanin për proceset dhe modelet e inovacionit përfshinin dhe konceptet e paqartësisë, heterogjenitetit dhe dijeve, që ishin diskutuar më parë dhe ekonomistët evolucionarë dhe nga Schumpeter (Ebersberger & Pyka, 2002: 636). Të tjerë të tillë si Hidalgo et al. (2007) theksonin pozitën gjeografike të një vendi apo pozitën e tij në hapësirën e prodhimit, e cila sipas tyre ishte një parashikues i mirë për performancën ekonomike të tij. Me hapësirën e prodhimit ato kuptonin rrjetin e

përfaqësimit të ndërlidhjes ose përfaqësimit të produkteve që tregtoheshin në tregun global. Kur një vend prodhonte një të mirë materiale që ishte e lokalizuar afër qendrës së hapësirës së prodhimit, shumë produkte të tjera të ndërlidhura mund të prodhoheshin me një teknologji të dhënë. Por kjo nuk vlente për vendet që ndodheshin në periferi – të mirat e prodhuara në periferi ishin shpesh të palidhura dhe kërkonin një teknologji shumë të ndryshme. Kështu sipas Hidalgo et al (2007) rritja ekonomike kishte më shumë gjasa që të ishte e dobët në ato vende që prodhonin më shumë komodite në vende që ishin të lokalizuara në periferi të hapësirës së prodhimit, ku burimet natyrore ishin të mëdha por komoditetet prodhoheshin me teknologji më të prapambetur. Ndërkohë, rritja ekonomike pritej që të ndodhte në ato vende që prodhonin të mira të lokalizuara pranë qendrës së hapësirës së prodhimit. Kjo do të thotë që rritja ekonomike është procesi i lëvizjes nga periferia drejt qendrës, në fjalë të tjera, rritja e qëndrueshme është pasojë e një forme të veçantë të transformimit strukturor. Kjo do të thotë që jo të gjitha ndryshimet strukturale ndikojnë në rritjen ekonomike – një zhvendosje nga qendra drejt periferisë së hapësirës së prodhimit sjell dhe një reduktim të rritjes ekonomike (Constantine, 2017: 4).

E gjithë shpjegimi më sipër lidhet me faktin që ‘dija’ konsiderohet si një nga përbërësit më të rëndësishëm për zhvillimin e inovacioneve dhe nuk mund të fitohet vetëm duke investuar në burimet natyrore. Zhvillimi teknologjik ka një natyrë përmbledhëse, që do të thotë që avancimet teknologjike të tanishme ndërtohen mbi inovacionet e suksesshme të së shkuarës. Pa fituar një njohuri të rrugës teknologjike specifike të së shkuarës një firmë apo një ndërmarrje nuk mund të kuptojë dot zhvillimet e tanishme dhe ta transferojë këtë dije në biznesin e saj. Në këtë mënyrë, aktorët e inovacionit karakterizohen nga aftësi jo perfekte, por që bazohen thelbësisht në historinë e tyre, rrugët e tyre janë të ndërvarura. Ky ndryshim teknologjik, hap pas hapi, mund të sjellë dhe ndryshime dhe avancime shumë të mëdha, ku disa aftësi dhe kompetenca të së kaluarës ta humbasin rëndësinë e tyre dhe të zëvendësohen nga kompetenca dhe aftësi të reja. Janë këto aftësi që shkatërrojnë ndryshimet teknologjike. Prezantimi i një inovacioni, shihet si një zhvendosje në rrugën e re të teknologjisë, pra, me shumë gjasa do të thotë që një firmë me aftësi të reja inovatore duhet të nxjerrë jashtë

funksionit disa pjesë të njohurive që ajo kishte si pjesë të rëndësishme të procesit të saj të prodhimit (Ebersberger & Pyka, 2002: 640).

Ekonomia e dijes dhe inovacionet kanë kërkuar gjithmonë një rritje të kërkesave dhe aftësive në arsimim. Kjo kërkesë e teknologjive të avancuara për kapacitete më të mëdha nga popullsia aktive, nga ana ekonomike, vjen si pasojë e zbatimit të dijeve dhe njohurive të reja në fushën e prodhimit (Kuznets, 1989: 16). Shpesh, kjo kërkesë e inovacionit teknologjik shoqërohet edhe me migracion të brendshëm dhe të jashtëm, dhe me një mobilitet më të madh të punonjësve. Por, mbi të gjitha, inovacionet teknologjike sjellin gati gjithmonë një rritje ekonomike më të madhe, e cila, më pas ndikon në strukturën ekonomike prodhuese të një vendi, dhe më konkretisht në tregun e tij të punës. Për këtë do të shkruaj më shumë në pjesën vijuese.

2.5. Ndikimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme në tregun e punës

Motorri që ushqen çdo treg në ekonominë e tregut është konkurrenca. Sipas ekonomistëve të mëdhenj perëndimorë dhe atyre të zhvillimit, ky treg duhet të jetë sa më konkurrues dhe jo perfekt që të prodhojë sa më shumë inovacione dhe progres teknologjik, dhe për pasojë dhe zhvillim ekonomik (Constantine, 2017: 4). Andreoni (2014) shpjegon që procesi i të mësuarit strukturor dhe të ndryshimit teknologjik përcaktohet nga lloji i strukturës ekonomike. Aktivitetet ekonomike me të ardhura më të mëdha janë më të rëndësishme sepse ato shërbejnë si burime për inovacion. Gjithashtu, ato shërbejnë edhe si bazament për diversifikimin ekonomik. Po ashtu, aktivitetet ekonomike me të ardhura më të mëdha kanë një shkallë më të lartë të elasticitetit të çmimeve të kërkesës në tregjet eksportuese – këto i bëjnë ato nxitësit kryesore në ekonomitë e hapura dhe së fundi, hierarkia e vendeve të punës është më e gjerë dhe e lartë për aktivitetet ekonomike të vendeve të zhvilluara dhe kjo sjell një eksperiencë shumë të vlerësuar pune për punonjësit. Për më tepër, mundësitë e ndarjes së punës janë relativisht më të gjera dhe kjo sjell forcimin midis rritjes ekonomike dhe të punësimit (Constantine, 2017:4).

‘Një forcë pune e pajisur me aftësitë, kompetencat dhe njohuritë e përshtatshme është e rëndësishme në ekonominë e dijes për shkak të ndryshimeve në strukturën e punës që kanë

kontribuar në rritjen e kërkesës për punonjës të arsimuar. Institucionet e arsimit të lartë në ‘ekonominë e dijes’ pritjet që të mundësojnë përthithjen e njohurive dhe të zhvillojnë aftësitë që duhen në botën e biznesit. Pritshmëritë janë që të ketë një kërkesë në rritje për punonjës të arsimuar me arsim të lartë, dhe kjo gjë do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe institucionet e arsimit të lartë duhet që të përgatiten për këtë sfidë. ‘Në vendet e OECD-së mesatarja e papunësisë të individët që nuk kanë arsim të lartë është më e lartë sesa shkalla e papunësisë së individëve që zotërojnë një diplomë të shkollës së lartë’ (Donlagiç & Kurtiç, 2016: 93). ‘Një nga pohimet më të rëndësishme të teorisë ekonomike neoklasike është mobiliteti perfekt i burimeve në hapësirë. Forca e punës besohet se është një nga këto burime që kanë mobilitet apo lëvizshmëri perfekte që sjell dhe një barazim të faktorizimit të çmimit’ (Lim, 2011: 213).

Zakonisht supozohet nga ekonomistë të ndryshëm që zhvillimi ekonomik përfshin një ndryshim cilësor ndërsa rritja ekonomike në limitin e tij të reduktohet te një ndryshim sasior i pastër. Por për Saviotti & Pyka, ky pohim e mbivlerëson këtë dihotomi. Rritja ekonomike nuk mund të ndodhë pa një ndryshim cilësor. ‘Në fakt që nga koha e revolucionit industrial, zhvillimi ekonomik është karakterizuar nga një lindje e entiteteve të reja, të cilat mund të jenë ose produkte apo shërbime të reja. Shembuj të këtyre entiteteve të reja, janë si për shembull makinat, televizionet, kompjuterat, aeroplanët ose shërbimet e reja, të tilla si paketat e udhëtimit, paketat financiare, shërbimet e bazuara te interneti etj. Këto entitete të reja janë të ndryshme nga entitetet paraardhëse të tyre dhe në këtë mënyrë mund të themi që zhvillimi ekonomik është karakterizuar nga një ndryshim cilësor. Ndryshimi cilësor është i përafërt me ndryshimin strukturor por është më depërtues. Të dy, si ndryshimi strukturor dhe ndryshimi cilësor ndryshojnë përbërjen e sistemit ekonomik, por ndryshimi cilësor krijon ndryshime edhe në nivelet më të vogla të sistemit’ (Saviotti & Pyka, 2008: 323). Për Saviotti-m dhe Pykën zhvillimi ekonomik duhet kuptuar si një proces transformimi, i cili përfshin si ndryshimin cilësor ashtu dhe sasior, të cilin ata e shprehin me dy trajektore apo tendenca:

- 1) Efikasiteti i rritjes; dhe
- 2) Llojshmëria e rritjes.

Të parën ata e lidhin me një performancë me efikase sesa në të kaluarën, duke rritur raportin ndërmjet output-eve dhe inputeve të një procesi të dhënë. Ndërsa e dyta ka të bëjë me krijimin e entiteve të reja, të cilat nga ana cilësore janë me të ndryshme nga entitetet para-ekzistuese. E dyta është rezultat i krijueshmërisë (Saviotti & Pyka, 2008: 337). Zakonisht, duke iu referuar Kuznets (1989) 'shkalla e lartë e rritjes së produktit për punëtor ose për frymë, karakteristikë e rritjes ekonomike moderne, u shoqërua në mënyrë të pashmangshme me një normë të lartë të ndryshimeve strukturore. Këto ishin ndryshime në aksionet e sektorëve të prodhimit në prodhimin, kapitalin dhe fuqinë punëtore të vendit, me ndryshime të nënkuptuara në aksione të grupeve të ndryshme sipas statusit të tyre të punës ndërmjet të angazhuarve me fitim dhe në kushtet e punës dhe jetës së tyre; e llojeve të ndryshme të kapitalit dhe format e ndërmarrjes ekonomike; dhe në strukturën e tregtisë së vendit dhe ndërhyrje të tjera ekonomike me pjesën tjetër të botës. Implikimet e ndërrimeve të tilla strukturore për ndryshimin e pozicionit të disa grupeve socioekonomike ishin veçanërisht të rëndësishme, sepse përgjigjet e këtyre grupeve ndaj ndikimit të teknologjive të avancuara formësuan shoqërinë moderne' (Kuznets, 1989: 15). Pasojat e ndërrimeve të shpejta në shpërndarjen e popullsisë aktive ekonomikisht (dhe vartësit e tyre) në mesin e disa sektorëve të prodhimit ishin të shumtë dhe të rëndësishëm në transformimin dhe modernizimin e vendeve të zhvilluara. Një nga pasojat më të mëdha ishte mosvazhdimësia sektoriale midis brezave, të cilat nuk mund të akomodoheshin për shkak të rritje së madhe natyrore të popullsisë dhe ndryshimeve në pjesëmarrjen e forcës së punës (Kuznets, 1989: 16). Nga ana tjetër shkencëtarët besojnë që dijet apo njohuritë dyfishohen çdo 7 vjet, që do të thotë që dija që kanë marrë individët gjatë semestrit të parë të studimeve do të skadojë në kohën që ata kanë mbaruar arsimimin e tyre. Për këtë arsye institucionet e arsimit duhet tu sigurojnë studentëve njohuritë e nevojshme dhe ti mundësojnë atyre që të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për tu adaptuar ndryshimeve në botën reale (Donlagiç & Kurtiç, 2016: 93).

KAPITULLI III: TRANZICIONI EKONOMIK SHQIPTAR

Tranzicioni ekonomik, në mënyrë të thjeshtë, është përkufizuar si ‘zhvendosja nga një ekonomi e planifikuar drejt ekonomisë së tregut’ (Ateljeviç & Triviç: 2016: 1). Fischer & Gelb (1991) e kanë përkufizuar si një ‘proces reformimi në vendet që kanë vendosur që të kalojnë nga një sistem socialist i ekonomisë së planifikuar te një sistem privat i ekonomisë së tregut, në të cilën mbizotëron pronësia private dhe shumë burime janë të shpërndara me anë të tregjeve’. Ndërkohë që sipas FMN-së (2000), duke ju referuar autorëve të mësipërm, aspektet kryesore të procesit të tranzicionit dhe të cilat mbizotërojnë pak a shumë në të gjitha vendet në tranzicion janë:

- (1) Liberalizimi;
- (2) Stabilizimi makro-ekonomik;
- (3) Privatizimi; dhe
- (4) Reformat ligjore dhe institucionale.

Të shumta kanë qenë dhe diskutimet mbi kohëzgjatjen e tranzicionit ekonomik në Shqipëri. Duke qenë se është një fenomen i njohur rajonal dhe ndërkombëtar, dhe që përfshiu mbi 20 vende të Evropës Lindore dhe Qendrore, fillesat e tij janë teorizuar nga autorë të ndryshëm. Sidoqoftë në literaturë duhet bërë dallimi midis tranzicionit politik dhe tranzicionit ekonomik. Po ashtu shumë klasifikime të tjera përmenden dhe tentojnë që të ri-përkufizojnë periudhën e tranzicionit të tilla si periudha post-socialiste ose tranzicioni post-socialist, si dhe çështja e modernitetit dhe post-modernitetit. Ndonëse nga pikëpamja politike, sociale dhe kulturore, tranzicioni është një fushë shumë e gjerë, tranzicioni ekonomik është i përkufizuar në terma dhe shifra thellësisht ekonomike. Përsa i përket rastit të tranzicionit të Shqipërisë prof. Civici në një nga librat e shumtë të tij nuk preferon që ta quajë ‘tranzicion’ por ‘transformim’ si pasojë e reformave të shumta që duhet të ndërmerreshin. Ndërsa përsa i përket dy rrugëve kryesore të reformave, ‘terapisë së shock-ut apo të gradualizmit të disa vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, ai shprehet që ‘Shqipëria evidentohet si një rast i veçantë i një rruge të tretë, “stop and go” pra “ec e ndalo” me një trajektore që kalon nga një krizë në tjetrën në raportin e kalimit të tranzicionit. Kjo përbën një specifike që

justifikon ato që kanë ndodhur dhe ato që kemi arritur deri tani' (Civici, 2014). Për të kuptuar ku ndodhej Shqipëria dhe gjithë vendet ish-komuniste në vitet 90-91, ai perfrazon një deklaratë të Michel Candesy, ish shefi i FMN-së në atë kohë, i cili në një takim me kryeministrat dhe ministrat e këtyre vendeve tha: “është një gropë shumë e madhe që nuk kalohet me dy tre kërcime sepse nuk ke ku e mbështet këmbën, pra duhet bërë një hop i madh. Nuk kemi asnjë teori tranzicioni dhe asnjë libër se çfarë duhet të bëjmë në këtë periudhë. Mendojeni veten si aktorë, autorë, regjizorë të një veprë që quhet tranzicion”. Në këtë këndvështrim sipas Civicit të gjithë kemi qënë në një farë mënyrë dikush aktor, dikush regjisor, i kësaj veprë që quhet tranzicion, por siç thekson Civici: “më shumë se tranzicion koha provoi se është transformim dhe një transformim i madh”. Në këtë libër botim të UET Press, Adrian Civici mbron tezën se tranzicioni mund të quhet i përfunduar me hyrjen në Bashkimin Evropian, duke e parë rrugën e integritit në BE të lidhur ngushtë me transformimin e ekonomisë (Civici, 2014:3).

Kështu, në fillim të viteve 1990-të, shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore hynë zyrtarisht në një proces të ri ekonomik dhe politik. Rënia e murit të Berlinit dhe të ekonomive të centralizuara të planit shënuan dhe rënien e regjimit komunist, dhe nxitën reforma të thella ekonomike, politike dhe institucionale që kishin për qëllim që të përmirësonin konkurrencën dhe efikasitetin e njohur si faza e tranzicionit (Capolupo, R., 2012: 530). Shumë nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ishin dhe anëtare të Paktit të Varshavës, gjë e cila donte të thonte se merrnin pjesë gjithashtu dhe në planifikime ekonomike rajonale (Bjornskov & Potrafke, 2011: 202), ndryshe nga Shqipëria që ndoshta ishte i vetmi rast i një ekonomie autarkike. ‘Shqipëria në fakt kishte qënë gjithmonë një vend shumë i veçantë komunist. Nga ana politike, Shqipëria kishte qënë diktatura komuniste më i izoluar, e centralizuar dhe e ashpër në Evropën Lindore. Po ashtu ishte dhe nga ana ekonomike: autarkike dhe e izoluar. Vetë natyra ekstreme e politikës dhe e ekonomisë shqiptare e bënë këtë vend një laborator eksperimenti për tranzicionin ndaj ekonomisë së tregut’ (Aslund & Sjoberg, 1992: 135). ‘Tranzicioni post-komunist i referohej një mundësie unike për një transformim të përgjithshëm të vendosur nga politikanët, që i duhej që të zgjidhnin midis një tranzicioni të shpejtë, të bazuar në atë që filloi të njihej si Konsensusi i Washingtonit (të lidhur kryesisht me politikanët e djathtë)

dhe një tranzicioni më gradual drejt një shoqërie ku shteti vazhonte të kishte një rol të rëndësishëm dhe që ishte më në akordancë më politikanët tradicionalë të së majtës (Bjornskov & Potrafke, 2011: 202).

Në këtë kapitull do të shkruaj për procesin e gjatë dhe të vështirë të tranzicionit, i cili shpeshherë është shoqëruar dhe me reforma të dhimbshme, por që asnjëherë nuk i perceptuan si të tilla nga individët e shoqërisë shqiptare, të cilët ishin të etur dhe entuziastë për reformat e ekonomisë së tregut. Në fakt ata po dilnin nga një sistem në të cilën marksizmi duke iu referuar Schumpeter kishte zëvendësuar besimin fetar. Për besimtarin e komunizmit, marksizmi ishte një sistem që mishëronte kuptimin e jetës dhe standartet më të mira për të gjykuar ngjarjet dhe veprimet; dhe së dyti, ishte një udhëzues për tu ruajtur nga ato rreziqe nga të cilat duhej ruajtur individ (Schumpeter, 2003: 5). Shqipëria po dilte nga një sistem, i cili kishte bërë një propagandë të madhe për zhvillimin ekonomik dhe arritjet modernizuese të vendit, dhe ku rrallë ishte përmendur kriza ekonomike që kishte kapluar shtetin socialist gjatë viteve 1980-të. Shifrat e dobëta ekonomike ishin mbuluar nga një propagandë e verbër që demaskohej vetëm nga mungesat e produkteve në treg, por që sidoqoftë mbetej e pastudiuar nga ana ekonomike. Në ato artikuj të paktë për gjendjen në vend, krahasimi për rritjen dhe zhvillimin ekonomik bëhej duke filluar nga viti 1945, domethënë që pas Luftës së Dytë Botërore dhe nuk kishte krahasime midis periudhave të ndryshme kohore. Nga shifrat zyrtare rezultonte që ‘rritja mesatare vjetore kombëtare për vitet 1966 -1970 ishte 9.1 përqind’ (Hofstein, 1975: 155), dhe mendohej që kjo rritje ekonomike do të ishte e qëndrueshme në dekadat që do të vinin, bazuar dhe ndihmën e madhe ekonomike që merrte nga Bashkimi Sovjetik dhe më pas nga Kina. Ashtu siç do të theksonin në artikullin e tyre dhe Aslund dhe Sjoberg (1992) ‘në fakt, ekonomia shqiptare kishte qenë jashtëzakonisht e varur nga ndihma ekonomike; së pari, deri në vitin 1961, nga BS; pastaj nga viti 1962 deri në vitin 1978 nga Kina. Pas vitit 1978, Shqipëria nuk mori asnjë ndihmë financiare. Si rezultat, të ardhurat kombëtare për frymë pësuan stanjacion, ndërsa popullsia u rrit në mënyrë të shpejtë (Aslund & Sjoberg, 1992: 137). Sipas një përllogaritje të Sandstrom & Sjoberg rritja e produktit material neto nga viti 1981 deri në vitin 1988 ishte 1.7% ndërsa popullsia ishte rritur me 2% në vit (Aslund & Sjoberg, 1992:

138). Kjo ishte situata e përgjithshme përpara viteve 1990-të dhe që i parapriu tranzicionit dhe transformimit ekonomik drejt ekonomisë së tregut.

3.1. Transformimi i strukturës ekonomike

Ideja kryesore në të cilën bazohen ekonomitë në tranzicion është që ekonomitë e mëparshme të planifikuara kishin zhvilluar institucione dhe struktura shumë të ndryshme ekonomike: për shkak të nënshtrimit ndaj normave të sistemit të mëparshëm, ekonomitë në tranzicion duhet të bënin ndryshime ekonomike ri-strukturuese dhe ri-rregulluese të thella, e cila në disa vende mori dhe emrin ‘recension transformues’ (Stephan, 1999: 5). Edhe qeverive shqiptare, të krijuara pas vitit 1991, iu desh që të bënin përpjekje të mëdha për të ndërmarrë reforma institucionale, ekonomike dhe ligjore në të gjitha drejtimet në mënyrë që të kontribuonin në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat, i cili mendohej se ishte motorri i rritjes i të gjithë ekonomisë (Xhillari & Telhaj, 2003: 245). Në fakt, pritshmëritë ishin që pas disa kontraksioneve të shkurtra të fillimit, PPB e bazuar në sistemin e ri të liberalizimit të tregut do ta merrte veten dhe do të sillte një rritje të shpejtë. Por në kundërshtim me këtë, procesi i tranzicionit ka qenë i gjatë dhe i vështirë dhe vendet e ndryshme të Evropës Lindore dhe Qendrore kanë evoluar në mënyrë të ndryshme nga njëra tjetra gjatë këtyre viteve të tranzicionit ekonomik. ‘Për ekonominë shqiptare vitet e para të tranzicionit kanë qenë shumë dramatike. Në fakt, PPB-ja mbeti në rënie për tre vite rresht 1990, 1991 dhe 1992 (duke arritur vetëm 60% të PPB të vitit 1989), por tranzicioni u bë akoma më i vështirë me krijimin e skemave piramidale në vitin 1997, e cila solli gjithashtu dhe një krizë politike dhe sociale. Konflikti i Kosovës provokoi gjithashtu një fazë tjetër kritike që rezultoi në një krizë të re ekonomike gjatë vitit 1999, nga e cila u prekën të gjitha vendet e rajonit, edhe ato të cilat nuk ishin të përfshira drejtpërdrejtë në konflikt (Capolupo, 2012: 530). Viti 1991 shënoi dhe vitin në të cilin filluan privatizimet e ndërmarrjeve dhe njësive të vogla të tilla si dyqanet, restorantet, njësitë e vogla të prodhimit të cilat u ndodhën nga privatizimi i shpejtë i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Tregtia me jashtë dhe liberalizimi i çmimeve në mes të vitit 1992 i hapi rrugë zgjerimit të sektorit privat veçanërisht në aktivitetet e tregtisë dhe shërbimeve të cilat siguronin dhe mundësitë më të mëdha për punësim (Xhillari & Telhaj, 2003: 245).

Duhet theksuar dhe njëherë që vendi po dilte nga një socializëm dhe centralizim i plotë i institucioneve dhe ndërmarrjeve. ‘Shkalla e autarkisë ishte kaq e lartë sa edhe nëse PPB-ja të llogaritej në terma realiste të shkallës së shkëmbimit, varësia nga tregtia e jashtme përbënte vetëm 6% të PPB-së në gjysmën e dytë të viteve 1980-të. Pavarësisht ekonomisë së vogël dhe mungesës së ndonjë tradite industriale, Shqipëria zgjodhi të ndiqte modelin e shteteve të mëdha komuniste të industrializuara, dhe në këtë mënyrë zhvilloi një ekonomi tradicionale sipas modelit sovjetik, e cila ishte dhe shumë e vështirë për tu vlerësuar nga ana e zhvillimit ekonomik, sepse statistikave e publikuara nuk ishin realiste (Aslund & Sjoberg, 1992: 136). Tranzicioni ekonomik mbi të gjitha kërkonte një transformim të strukturës ekonomike në të gjitha nivelet e tij. ‘Përderisa të ardhurat dhe kapitali në një ekonomi të planifikuar kishin kryer funksione sistemike të ndryshme dhe u kishin shërbyer qëllimeve ekonomike të ndryshme nga ato të ekonomisë monetare, tregjet financiare ekzistuese nuk ishin të përshtatshme për të funksionuar në një ekonomi monetare pa bërë ndryshime rrënjësore. Në fakt, që në fillim emergjenca për të ndryshuar sistemin bankar doli si emergjenca dhe protagoniste për sigurimin e fondeve për investimet dhe kredive (Stephan, 1999: 16).

Nga ana tjetër, implikimet për të ndryshuar kushtet e punës dhe mënyrën e jetesës rezultuan akoma dhe më shumë të vështira, aq sa tranzicioni vazhdoi që të justifikohet si një proces i gjatë dhe i vështirë. Sidoqoftë, në bazë dhe të ndryshimeve strukturore, kjo periudhë e gjatë tranzicioni duhet ndarë në tre periudha kohore të rëndësishme, të paktën për rastin e Shqipërisë, evolucioni i së cilës ka qenë i ndryshëm nga ai i vendeve të tjera. Si bazë kryesore për këtë klasifikim, është bërë, përveç ndryshimeve ri-rregulluese strukturore, dhe performanca e rritjes ekonomike sipas PPB-së, dhe duke iu referuar statistikave zyrtare të INSTAT dhe raporteve të institucioneve të tjera ndërkombëtare.

- Periudha 1991 – 1998;
- Periudha 1999 – 2010;
- Periudha 2011 – 2019 ;

Periudha e parë (1991 – 1998) shënon dhe vitet e para të tranzicionit shqiptar, e cila u shoqërua nga privatizime të shpejta të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kjo periudhë

regjistron dhe miratimin e legjislacioneve të para për zhvillimin e ekonomisë së tregut. Kjo fazë e parë u shoqërua nga sektori financiar informal dhe nga shkalla e lartë e evazionit fiskal. Ndikimet e tyre kryesore në këtë tranzicion të hershëm shqiptar ishin: kreditë me risk të lartë, defiçiti buxhetor në rritje, lidhja e dobët që ekzistonte midis kursimeve dhe investimeve, dhe shtrembërimi i tregtisë së të ardhurave dhe kohës së lirë, dhe një nxitje e dobët për punën. Pavarësisht zhvillimit shumë të shpejtë të fillimit, kjo situatë krijoi probleme serioze pas vitit 1994 dhe në vazhdim (Xhillari & Telhaj, 2003: 282). Dhe reforma të tjera strukturore nevojiteshin të ndërmerreshin dhe gjatë fazës së dytë të tranzicionit.

Periudha e dytë (1999 – 2010) kërkonte që të rregullonte vështirësitë dhe problemet strukturore që kishte krijuar tranzicioni gjatë periudhës së parë të tij. Kështu, shumë hapa u ndërmorën për ti rregulluar këto probleme, ku vëmendja kryesore u përqendrua në përmirësimin e sistemit bankar, i cili ishte një nga institucionet më të rëndësishme të ekonomisë së tregut. ‘Një sistem bankar modern ishte i rëndësishëm për të përmirësuar performancën e sistemit bankar, për të promovuar konkurrencën në tregjet financiare të sistemit bankar, për të siguruar kreditë për sektorin privat për mobilizimin e kursimeve të brendshme, dhe për të kontrolluar paratë që qarkullonin jashtë sistemit bankar (Xhillari & Telhaj, 2003: 282). Për këtë arsye u ndërmorën reforma ligjore dhe institucionale që kërkonin që një vëmendje më e madhe ti përkushtohej zbatimit të ligjit. Gjatë periudhës së dytë kohore të tranzicionit shqiptar duhet theksuar që rritja ekonomike ishte intense dhe shënoi një rritje vjetore mesatare diku te 6 përqind, që shënoi një progres në krahasim me vitet e para të tranzicionit (Capolupo, 2012: 530). Kjo periudhë u shënua dhe nga kriza ekonomike globale, gjatë vitit 2008, por që në Shqipëri u ndje më vonë, dhe kryesisht me uljet e remitancave të emigrantëve. ‘Në këta 20 vjet, në Shqipëri, një pjesë e mirë e të ardhurave kombëtare vijnë pikërisht nga dërgesat e emigrantëve, të njohura gjerësisht me termin remitanca. Shifrat zyrtare tregojnë se remitancat përbëjnë një burim të madh të dërgesave nga jashtë, ku në 2007-n remitancat kishin vlerën 951.7 milionë euro dhe përfaqësonin rreth 12% të PPB-së. Një studim i vitit 2005 i IOM tregoi së 68% e emigrantëve dërgonin remitanca në familjet e tyre. Kriza financiare ka bërë që emigrantët

në vitet e fundit të sjellin më pak të ardhura për familjet e tyre, ku këto të ardhura janë një faktor shumë i rëndësishëm për buxhetet familjare dhe për zhvillimin e ekonomisë. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2008 kanë qenë rreth 800 milionë euro, një shifër kjo e barabartë me 9,2% të PPB-së. Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e defiçitit tregtar llogaritet rreth 33%, me një rënie prej 12 pikësh përqindjeje, kundrejt vitit të kaluar”, – theksoi raporti i Bankës së Shqipërisë. Edhe për vitin 2009 emigrantët shqiptarë kanë dërguar rreth 53 milionë euro më pak në shtëpitë e tyre, krahasuar me vitin 2008. Po kështu ka ecur edhe 2010-ta, emigrantët shqiptarë kanë dërguar rreth 690 milionë euro (514 milionë euro nga Greqia). Pra, rreth 11% më pak në krahasim me vitin 2009. Sipas një raporti të EUROSTAT, kriza financiare dhe ekonomike greke bëri që emigrantët shqiptarë që punonin dhe jetonin në Greqi të humbnin besimin në sistemin bankar grek dhe kanë parë si më të sigurt Shqipërinë për të mbajtur kursimet e tyre. Po ashtu vihet re që edhe viti 2011 ka pasur rënie të remitancave, edhe pse kjo rënie duket shumë e vogël në krahasim me ato të vitit 2010. Kriza financiare që ka prekur tashmë pjesën më të madhe të ekonomive botërore, por sidomos vendet ku kanë emigruar shumica e shqiptarëve, në Greqi dhe Itali, është pasqyruar me humbjen e vendeve të punës nga ana e emigrantëve, e cila reflektohet më së miri me këtë tregues, edhe pse duhet të pranojmë se, krahas krizës, ulja e nivelit të dërgesave ka të bëjë edhe me stabilizimin social të tyre në vendet ku kanë emigruar. Shumë emigrantë, pasi kanë kaluar rreth 20 vjet në emigracion, stabilizohen në atë vend dhe fillojnë të investojnë të ardhurat e tyre në po atë vend, përmendim këtu rreth 4500 biznese të vogla të shqiptarëve që jetojnë në Itali. Remitancat kanë një efekt të lartë në luftën kundër varfërisë, si dhe në stimulimin e zhvillimit. Ato shërbejnë gjithashtu për të mbështetur financiarisht zhvillimin e rajoneve në gjithë territorin e Shqipërisë. Emigracioni i lartë shqiptar, përveçse ka ndihmuar në zhvillimin e vendit me anë të remitancave, uljen e varfërisë me anë të dërgesave që u bëhet familjeve, me rritjen e konsumit, rritjen e investimeve, ka ndikuar gjithashtu shumë pozitivisht edhe në zhvillimin e sektorit të ndërtimeve, pasi një pjesë e mirë e emigrantëve kanë investuar një pjesë të mirë të të ardhurave në këtë sektor. Një efekt pozitiv, rrjedhojë e emigracionit shqiptar, ka qenë ulja e papunësisë në Shqipëri, pasi vendet që lihen vakante nga ata që emigrojnë, zihen nga ata që

ishin me status të papuni. Kthimi i emigrantëve do të ndikojë në mënyrë indirekte në rritjen e papunësisë, si në rang lokal edhe në atë kombëtar (Qiqi, 2012).

Periudha e tretë (2011 – 2019) shënon dhe ndryshimet më të mëdha strukturore në ekonominë shqiptare. Pas një privatizimi intensiv të dy periudhave të para, privatizimet në periudhën e tretë ishin më të pakta dhe përfshinë kryesisht veprat e mëdha energjetike si dhe dhënien e koncesioneve nëpërmjet partneriteteve publike dhe private. Sipas analistëve ekonomikë të tillë si Ornela Liperi ka ndodhur gjithashtu dhe një ndryshim strukturor përsa i përket mikro-ndërmarrjeve. ‘Mikrondërmarrjet kanë qenë zemra e ekonomisë shqiptare në epokën e pas viteve ‘90. Pa ndonjë strategji dhe duke shkatërruar pothuajse çdo trashëgimi nga e kaluara, hapja e bizneseve të vogla në tregti e shërbime ishte modeli ku u vet-orientua ekonomia vendase. Një model që kishte pak lidhje me vlerën e shtuar, produktivitetin, prodhimin e produkteve për të cilin ne mund të kishim avantazh konkurrues etj., por që i shërbeu të paktën vetëpunësimit. Shqipëria, rezulton një ndër vendet me normën më të lartë të vetëpunësimit në botë, ku rreth 30% e të punësuarve e kanë siguruar vetë jetesën nëpërmjet mikrondërmarrjeve. Në dekadën e fundit, struktura e ekonomisë po ndryshon. Hapja e qendrave të mëdha tregtare dhe e rrjeteve të supermarketeve po nxjerr jashtë loje bizneset e vogla. Kjo u bë më e dukshme në vitin 2017, ku të dhënat e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve të INSTAT tregojnë se ndërmarrjet mikro me 1 deri në 9 të punësuar, që përbëjnë 94% të totalit të bizneseve në vend, u reduktuan në numër, ulën shitjet, të punësuarit dhe vlerën e shtuar në krahasim me vitin e mëparshëm’ (Liperi, 2019). E kundërt ka qenë tendenca për Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar), Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar) dhe Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar), të cilat kanë parë rritje të punonjësve, shitjeve dhe vlerës së shtuar. Në total, ekonomia në 2017-n gjeneroi shitje prej 2 trilionë lekësh, ose gati 16 miliardë euro, me një rritje prej 8.3% me bazë vjetore. Ndikimin kryesor në rritjen e shitjeve e dhanë ndërmarrjet e konsideruara të vogla, me 10-49 të punësuar, të cilat raportuan një zgjerim të shitjeve me 18%. Ndërmarrjet e mesme i zgjeruan shitjet me 17% dhe ato të mëdha me 11%. Ndërsa shitjet e mikrondërmarrjeve ranë me 13% (INSTAT, 2017).

Sipas të dhënave të INSTAT për 2017-n, rreth 47% e të ardhurave nga shitjet në ekonomi gjenerohen nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë. Shqipëria është një importuese neto për pothuajse gjithçka, madje edhe për produkte bujqësore, ndonëse ky sektor gjeneron rreth 20% të prodhimit të brendshëm bruto të vendit. Tregtia qarkulloi rreth 7.4 miliardë lekë të ardhura në 2017-n, me rritje gati 5% me bazë vjetore. Në vend të dytë është ndërtimi, me 12% të totalit, një sektor mjaft i preferuar për shkak të kthimit të shpejtë që ai ka dhe hapësirave të shumta që ka pasur në ndërtim, në mungesë të një plani afatgjatë rregullues, sidomos në bregdet e kryeqytet. Në 2017-n, shitjet nga ky sektor gjeneruan 1.9 miliardë lekë të ardhura, me rritje gati 13% me bazë vjetore. Të dhëna të tjera të INSTAT për vitin 2016 tregojnë se 74.3% e investimeve të brendshme në ekonomi shkuan pikërisht në sektorin e ndërtimit, më e larta nga vendet e rajonit dhe Europa. Sipas të dhënave të përpunuara nga revista “Monitor” nga institutet statistikore të rajonit, edhe në Maqedoni, ndërtimi merr rreth 63% të investimeve. Në Mal të Zi dhe Serbi, ndërtimi zë rreth gjysmën e investimeve të brendshme. Kanalizimi i fondeve të lira, kryesisht në banesa, ka bërë që vendi ynë të ketë peshën më të lartë të ndërtimit në Prodhimin e Brendshëm Bruto në Europë. Me gati 11% të PBB-së, ndërtimi qëndron gati 3 pikë përqindje më lart nga ndjekësi më i afërt, që është Maqedonia. Mali i Zi, Serbia dhe Bosnja kanë qenë më të frenuar në zhvillimin e këtij sektori, që zë mesatarisht 4-6% të PBB-së. Në vendet e Bashkimit European, ndërtimi, i maturuar prej vitesh, zë rreth 5.3% të PBB-së. Investimi në ndërtim mund të ndikojë në rritjen e qarkullimit të parave dhe hapjen e vendeve të reja të punës, por që në afat të gjatë nuk i jep vlerë të shtuar ekonomisë, teksa nuk ndikon në rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, duke shkuar në linjë të kundërt me atë që kanë rekomanduar ekspertët dhe institucionet ndërkombëtare. Në vend të tretë renditet industria përpunuese, që gjeneron po gati 12% të shitjeve në ekonomi, e ndjekur nga shërbimet (10%), transportet e komunikacioni (7.3%), energjia, gazi dhe uji (rreth 6%) (Liperi, 2019).

Përsa i përket anës institucionale procesi i regjistrimit për bizneset e reja, vendase dhe të huaja, nuk është shumë i vështirë dhe nuk harxhon shumë kohë. Procesi i liçensimit duket sikur është një pengesë serioze. Firmat e reja janë më shumë të shqetësuara për çështjet

fiskale: taksat e larta dhe kontributet si dhe rregulloret dhe legjislacionet që ndryshojnë në mënyrë të shpeshtë. Taksat janë relativisht të larta dhe ato janë gjithashtu subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme. Sidomos gjatë viteve 1990-të dhe 2000 kishte shumë diskriminim ndërmjet firmave përsa i përkiste pagesës së taksave dhe doganave, të cilat shkaktoheshin për shkak të zbatimit të pakët të ligjit, gjë e cila sillte konkurrencë të paligjshme. Po ashtu, shkalla e lartë e kontributeve sociale dhe të shëndetit dhe rritja e tyre në afat-gjatë është një shqetësim tjetër i të gjitha kompanive. Ligjet e punës, nga ana tjetër, nuk shkaktojnë ndonjë problem për firmat. Punonjësit janë në gjendje që të shkarkojnë nga detyra punonjësit e tyre në më pak se një javë, pa ndonjë pasojë. Nuk ka masa diskriminuese ndaj firmave të huaja. Ligjet që lehtësojnë investimet e huaja dhe punët e paguara lirë perceptohen pozitivisht nga investitorët e huaj (Xhillari & Telhaj, 2003: 282).

Në çfarëdo analize të transformimit të sistemeve apo të strukturës ekonomike, parashikimet e politikave mbështeten në dy zhvillime kryesore:

- Konstituimet monetare respektive të çdo vendi të cilat duhen shqyrtuar në mënyrë të hollësishme; si dhe
- Vlerësimi i sektorit të ri privat, i cili zakonisht vlerësohet si pjesë e analizës së rritjes ekonomike (Stephan, 1999: 9).

Praktikat e tranzicionit ekonomik u zbatuan edhe në shumë vende të tjera, përveç atyre të Europës Qendrore dhe Lindore, por ndryshe nga këto vende, vende të tilla si për shembull ato të Amerikës Latine kishin një avantazh sepse ato tashmë kishin një kulturë të gjatë dhe të pandërprerë të sektorit privat. Ndërkohë që vendet ish komuniste duhet të bënin ndryshime strukturore shumë të mëdha dhe të zhduknin monopolin ekonomik të shtetit në një kohë shumë të shkurtër. Ky monopol shtetëror kishte uzurpuar si sipërmarrjen vendase ashtu dhe investimet e huaja (Kasser, 1996: 209). Problem tjetër i rëndësishëm strukturor ishte fakti që për më tepër vendet që përjetuan dhe praktikuan tranzicionin ekonomik duhej që të ndërtonin institucione që tashmë në vendet e zhvilluara ishin zgjeruar së tepërmi dhe kishin evoluar nga pozicioni i tyre fillestar. Eksperienca dhe praktika e këtyre institucioneve nuk mund të praktikohesh menjëherë në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (Stephan, 1999: 9). Për më tepër ai që arrin vonë në zhvillimin ekonomik nuk

mund të avancojë në mënyrë të shpejtë nëse kushtet e tjera të domosdoshme për zhvillimin ekonomik nuk janë plotësuar ose ekonomia, për shembull, vuan nga një konkurrencë e disavantazhuar me vendet e ekonomive më shumë të zhvilluara (Stephan, 1999: 10).

Në studime të ndryshme të publikuara nga ekonomistë shqiptarë dhe të huaj, si dhe duke u bazuar dhe në statistikën zyrtare dhe ato të raporteve ndërkombëtare ka rezultuar në fakt që për arsye të ndryshme tranzicioni shqiptar ishte problematik jo dhe aq për shkak të ndryshimit të strukturës ekonomike, por kjo strukturë ekonomike ishte e vështirë që të implementohej dhe të vihej në lëvizje në të njëjtat parametra që ajo ekzistonte në vendet e zhvilluara. Ndryshimet strukturore u bënë, por, ato nuk sollën zhvillimin dhe rritjen ekonomike që pritej. Disa studime ia vunë fajin sistemit të dobët të kredive gjë që vështirësoi që sipërmarrësit të krijojnë biznesin e tyre dhe të financonin rritjen e tij. Gjithashtu, dhe rregulloret fiskale dhe ligjore, nuk ishin instrumenta neutralë që të mund të kishin një ndikim të drejtpërdrejtë në jetëgjatësinë e bizneseve. Kështu ato ndikonin në performancën ekonomike të firmave dhe në rritjen e tyre (Xhillari & Telhaj, 2003: 282). Po ashtu studime të tjera theksojnë faktin që mungonte sundimi i ligjit, konkurrenca e pandershme, informaliteti, korrupsioni, mungesa e kulturës së mekanizmave të ekonomisë së tregut, apo dhe institucionet e dobëta shtetërore apo qeveritare. Të gjitha këto faktorë strukturorë të marrë së bashku bënë që zhvillimi ekonomik dhe rritja ekonomike në Shqipëri të ishte minimale, dhe kjo ekonomi pak vende të lëvizte në renditjen e vendeve më pak të zhvilluara në Europë dhe në botë. Shumica e studiuesve nuk vunë në dyshim mekanizmat e ekonomisë së tregut por strategjinë me të cilën ekonomia shqiptare i ishte përafruar ekonomisë së tregut dhe konkretisht privatizimin e shpejtë të ndërmarrjeve shtetërore dhe posaçërisht *Terapinë e Shock-ut*, për të cilën do të shkruaj më gjatë në pjesën në vazhdim.

3.2. Burimet e transformimit ekonomik ose Terapia e Shock-ut

Strategjia e privatizimeve në Shqipëri u zgjodh pa bërë akoma një analizë të mirëfilltë se ku kishte dështuar ekonomia shqiptare. Përgjithësisht kjo analizë u huazua nga vendet e tjera ish-komuniste, që më së shumti, fajësonin ideologjinë marksiste dhe komuniste dhe nuk dinin se cili mekanizëm konkretisht i ekonomisë së planifikuar kishte dështuar. Kjo nuk

ishte akoma e qartë edhe për ekonomistët më të mirë të vendeve më të zhvilluara perëndimore. Do duhej një dhjetëvjeçar për të bërë një analizë të qartë të asaj që kishte ndodhur. Përqasja më e përgjithshme ndaj dështimit u përqendrua te perspektiva monetare. Sipas kësaj perspektive, duke përqafuar normat e një sistemi monetar konkurues dhe integritit gradual në ndarjen ndërkombëtare të punës, ekonomitë e Evropës Qendrore dhe Lindore kishin hyrë në një ‘konkurrencë sistemike’. Sipas Johannes Stephan ‘ato hynë në një garë të cilën nuk mund ta fitonin. Nuk ishte kundërshtimi i normave të sistemit konkurrues monetar, por pranimi i këtyre normave që i detyroi ekonomitë e planifikuara që të hynin në një proces konkurrimi sistematik. Ato nuk mundën dot që të fitonin sepse pranimi i këtyre normave të huaja ishte në kontradiktë me aftësinë e sistemit të ekonomisë së planifikuar që të funksiononte. Duke marrë në konsideratë këtë, nuk është e habitshme që çdo përpjekje për të plotësuar parashikimet e planit, apo të siguronin aktorë ekonomikë që të funksiononin me mekanizmat e çmimit dhe të dërgonin sinjale në treg’ (Stephan, 1999: 8). Kjo gjë dhe ky shpjegim vlente dhe për Shqipërinë që pas vitit 1978 ndërtoi një shtet të izoluar dhe një ekonomi autarkike, por që nuk mundi dot ti shpëtonte kësaj konkurrence në arenën ndërkombëtare dhe që reflektohej më së miri te çmimet, që ekonomia shqiptare arrinte që ti kontrollonte dhe ti modifikonte për tregun shqiptar, por nuk mund ti ndikonte në arenën ndërkombëtare, dhe dashje pa dashje arriti që të hynte në një konkurrencë ndërkombëtare monetare.

Pas rënies së komunizmit, qëllimi kryesor i vendeve ish –komuniste ishte privatizimi masiv që do të ndodhte me anë të një ri-strukturimi të konsiderueshëm të ekonomive të tyre. Sasia i këtij ri-strukturimi dhe shpejtësia e tij varionte nga njëri vend në tjetrin dhe jo të gjithë vendet zgjodhën të njëjtën strategji. Madje sipas Bjørnskov & Potrafke (2011) këto strategji të këtyre vendeve ishin në kontradiktë me njëri tjetrin sepse disa zgjdhën një përjasje graduale ndërkohë që të tjera ndoqën një përjasje ‘bing-bang’, ndërkohë që pak vende vendosën që të ri-strukturonin edhe njëherë ekonomitë e tyre të centralizuara të planit (Bjørnskov & Potrafke, 2011: 202). Kjo bëri që të ngriheshin shumë pyetje kërkimore ndërmjet studiuesve. Kështu për shembull rasti i Shqipërisë, përveç një autarkie ambicioze, nuk prodhoi ndonjëherë ndonjë makineri apo të mira materiale që të sillnin të ardhura nga eksportet, madje më së shumti kërkonin disa importe të llojeve të veçanta. Deri në vitin

1990-të Shqipëria e kishte të ndaluar marrjen e borxhit të huaj, e cila ishte e ndaluar në Kushtetutën e vitit 1978. Kjo gjë donte të thonte që si pasojë, të mirat materiale shqiptare ishin kryesisht ato që mbizotëronin nga koha e ndihmës së sovjetikëve të viteve 1950-të dhe më vonë të ndihmës kineze që gjithashtu ishte teknologji e vjetër e para Luftës së Dytë Botërore. Pak nga kamionet, për shembull që mbizotëronin në Shqipëri në atë kohë ishin kopje kineze të kamionëve sovjetikë Zil të viteve 1950-të, të cilët nga ana e tyre imitonin kamionët amerikanë që datonin në vitet 1920-të dhe 1930-të. Pak mallra të tjera materiale tentonin të kishin origjinë Çekoslovake, të Gjermanisë Lindore ose të Polonisë. Në fakt, pak nga asetet shqiptare të vitit 1990-të do të kishte ndonjë vlerë për ekonominë e tregut perëndimor dhe edhe për vetë Shqipërinë ato nuk kishin ndonjë vlerë (Aslund & Sjoberg, 1992: 137). Ishte kjo arsyeja kryesore që për rastin shqiptar u pa e udhës një privatizim i shpejtë i këtyre aseteve që nuk kishte ndonjë vlerë në ekonominë e tregut.

Ka shumë burime të transformimit ekonomik, por ato mund të grupohen në dy kategori të mëdha:

- Ndërhyrja e shtetit; dhe
- Transformimi i jashtëm.

Ndërhyrja e shtetit përfshin një ndryshim të paramenduar të incentivave në treg dhe krijimin apo shkatërrimin e tregjeve. Shembuj të këtyre ndërhyrjeve shtetërore janë tregjet e reja në Azinë Lindore apo në Evropën e vjetër të shekullit të 19-të dhe 20-të. Ndërkohë që nga ana tjetër, transformimet e jashtme përfshijnë luftërat, fatkeqësitë natyrore dhe transformimet apo krizat ekonomike etj. Chang (2011) shpjegon që shteti është institucioni i të gjitha institucioneve, i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rolin e institucioneve që luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimet strukturore dhe të rritjes ekonomike. Institucionet e ‘mira’, të tilla si të drejtat e pronësisë mund të bëjnë ndryshime strukturore vetëm nëse zbatohen në mënyrën e duhur, dhe studiues të caktuar theksojnë që kjo gjë mund të varet nga lloji i strukturës ekonomike. Por edhe në rast se ato zbatohen, nuk ka një arsye apriori që këto incentiva të reja në treg dhe struktura ekonomike do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë te rritja ekonomike e qëndrueshme. Marrëdhënia që ekziston midis strukturës ekonomike dhe rritjes ekonomike vazhdon që të mbetet akoma e paqartë (Constantine, 2017: 5).

Burimi kryesor i transformimit ekonomik në Shqipëri ishte ‘terapia e shock’-ut dhe si pasojë në vitin 1992 në Shqipëri filloi që të zbatohesh një privatizim në shkallë të gjerë në një program të udhëhequr nga FMN-ja dhe Banka Botërore (Lami, Imami & Kächelein, 2016: 201). ‘Ministria e Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit ishin përgjegjëse për furnizimin, projektimin dhe zbatimin e procedurave për dokumentimin e ndërmarrjeve dhe organizimin e tenderave. Në fillim të viteve 1990-të, u vunë në qarkullim bonot e kompensimit dhe të privatizimit, të cilat iu shpërndanë të gjithë popullsisë së rritur në Shqipëri. Këto bono u përdorën për të blerë aksione në kompanitë tregtare të cilat do të privatizoheshin. Banka e Shqipërisë ishte përgjegjëse për lëshimin e këtyre bonove sipas kërkesave që kishte vendosur Ministria e Financave. Që nga lëshimi i tyre në treg, vlera e bonove filloi që të binte në mënyrë të vazhdueshme. Gjatë krizës së vitit 1997, vlera e tyre reale ra në 1.6% të vlerës së tyre të vërtetë, ndërkohë që kishte një tregti të kufizuar të tyre. Përdorimi i bonove të privatizimit nuk ishte i suksesshëm – gjatë procesit të privatizimit dhe vetëm një pjesë e vogël e bonove të shpërndara u përdorën (21.25%). Pavarësisht përdorimit të vogël të sistemit të bonove, procesi i privatizimit vazhdoi në mënyrë të shpejtë dhe ekonomia u vendos në duar të ekonomisë private duke filluar së paku nga viti 1996. Megjithatë procesi i privatizimit pësoi një pezullim gjatë vitit 1997, ai rifilloi sërish në vitet në vazhdim (Lami, Imami & Kächelein, 2016: 201). Bazuar në një tregues të BERZH-it, privatizimi i ndërmarrjeve të vogla kryesisht përfundoi në vitin 1995, ndërkohë që privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha dhe të mesme vazhdoi në një nivel të moderuar deri në fund të shekullit të kaluar.

Gjatë viteve 2000, sektori bankar u privatizua në mënyrë të plotë, (në ditët tona të gjitha bankat e nivelit të dytë janë privatizuar). Kompanitë telefonike, të cilat në atë kohë ishin monopol i Albtelecom-it, dhe shpërndarësi elektrik OSSH, dhe e vetmja rafineri e naftës në vend ARMO, ishin privatizime të mëdha që ndodhën vetëm gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2013, tre hidrocentrale të madhësive mesatare të tilla si HEC Bistrica 1, 2 dhe HEC Ulëz Shkopet) u privatizuan dhe që nga ajo kohë ka pasur përpjekje të pasuksesshme për të privatizuar kompanitë më të mëdha të nxjerrjes së naftës në vend, Albpetrolin, në fund të vitit 2012 dhe në fillim të vitit 2013. Kuptohet që të gjitha këto zhvillime patën ndikime të

mëdha në ri-strukturimin e tregut të punës dhe të punësimit i ardhshëm i individëve që ishin të punësuar pranë këtyre kompanive.

Rasti i Albpetrol

Privatizimi i Shoqërisë Shqiptare të Naftës Albpetrol konsiderohet si një prej privatizimeve të fundit strategjike në Shqipëri. Ftesës së Ministrisë Shqiptare të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës gjatë vitit 2012 për të marrë pjesë në tender iu përgjigjën 12 kompani të interesuara. Fituesi i tenderit do të merrte një licencë për nxjerrjen e naftës për 25 vitet e ardhshme. Disa prej emrave më të njohur ishin: Gazprom, kompania shtetërore e prodhimit të energjisë në Rusi, e cila ka edhe një monopol ligjor për eksportin e gazit. Gazprom planifikonte të blente Albpetrol-in në bashkëpunim me kompaninë serbe NIS. “Bankers Petroleum”, kompania tjetër e interesuar, është prodhuesi më i madh i naftës bruto në Shqipëri. Vlera e saj e aksioneve në bursë ka rënë ndjeshëm në muajt e fundit dhe kjo kompani ka aktualisht një vlerë tregtare prej rreth 600 milionë dollarësh. “Çalik Enerji” është një tjetër kompani e njohur në vendin tonë, pasi zotëron bankën BKT, kompaninë “Albtelecom”, kurse në Turqi linja të prodhimit në sektorin energjetik. “Petromanas” është një kompani e regjistruar në Kanada me asete të deklaruar në bilancin e saj të publikuar prej 154 milionë dollarësh. Ajo disponon disa kontrata për ndarjen e prodhimit të naftës në disa zona të Shqipërisë (DIHA, 2012). Sidoqoftë, tenderi dështoi dhe kompania AlbPetrol vazhdon që të mbetet aset shtetëror. Qeveria Rama 2, në programin qeverisës 2017-2021, ka në plan të zbatojë reformë të thellë në ndërmarrjen shtetërore të nxjerrjes së naftës Albpetrol. Në dokumentin e shkruar të programit qeveritar thuhet se, “do të ristrukturohet kompania publike Albpetrol sh.a., duke ruajtur një njësi teknike dhe duke privatizuar asetet e tjera”. Në fakt, sipas burimeve të Ministrisë së Energjetikës, ky është opsioni kryesor që po diskutohet nga grupi i punës. Rezultat i këtij procesi, sipas secilit variant, do të jetë zhbërja e Albpetrol brenda këtij viti dhe copëtimi i tij, ku shtetit i mbeten të drejtat mbi menaxhimin e marrëveshjeve dhe pjesët e tjera të ndërmarrjes do të ofrohen për shitje. Në Albpetrol, vlerësohen fizibël uzina mekanike, qendra për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë dhe sektori i remontit. Uzina mekanike që ndodhet në Kuçovë, në gjendjen që është sot, ofron shumë shërbime edhe për të tretët. Biznese të ndryshme janë në kontrata me uzinën për prodhimin e profileve të veçanta të hekurit. Nëse kjo njësi do të ofrohet për

shitje ndaj një investitori me përvojë në industrinë automative, vlera e uzinës, me pak investim do të shumëfishohej dhe numri i të punësuarve do të rritej, shpjegon eksperti i sektorit të naftës, Panajot Soko. Gjithashtu, qendra për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë, që është aktualisht në pronësinë e Albpetrol, është një sektor me fizibilitet brenda kompanisë. Kjo njësi aktualisht ka të drejtën ekskluzive për të ofruar shërbime të energjisë elektrike në zonat naftëmbajtëse që shfrytëzohen aktualisht nga koncesionarët e tjerë. Ky shërbim, nëse shitet, do të ketë një vlerë të konsiderueshme në treg. Pjesa tjetër e vlefshme vlerësohet sektori i remontit. Aktualisht kjo njësi ofron shërbime të vlefshme jo vetëm për Albpetrol, por edhe për koncesionarët e tjerë. Nëse struktura privatizohet, me pak investime ajo mund të jetë një biznes shumë fizibël. Kompanitë koncesionare mund të blejnë shërbimet e saj, pasi do të kushtojnë shumë më lirë se pagesat ndaj një kompanie të huaj që do të ofronte remonte në Shqipëri.

Ekspertët në Ministrinë e Energjetikës, të cilët janë pjesë e negociatave, pohojnë se ky plan është në shqyrtim. Zbatimi i këtij plani pritet të rrisë fitimet e qeverisë e cila, nëpërmjet një njësie të vogël, do të menaxhojë të ardhurat nga marrëveshjet hidrokarbure, të cilat do të rrisnin të ardhurat *cash* në arkën e shtetit që sot përdoren për të paguar të 2500 punonjësit e kompanisë. Por privatizimi i pjesëve të shëndetshme duket se do të shpëtojë një pjesë të mirë të punonjësve nga papunësia. Aktualisht, Albpetrol ka rreth 10 njësi të veçanta, ku më kryesorët janë qendrat e prodhimit në Ballsh dhe Kuçovë, njësia e shitjes, ajo e sigurisë, shërbimet gjeofizike, njësia e transportit, magazina e materialeve, operatori i energjisë, qendra e transportit dhe uzina mekanike e Kuçovës (Energjia.al). Sidoqoftë duhet patur parasysh që qeveria aktualisht planifikon që të shesë pjesën e mbetur të aksioneve të saj që janë vetëm 17% (Lami, Imami & Kächelein, 2016: 202).

Duke iu referuar treguesve të BERZH, privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha është përmirësuar me kalimin e kohës dhe sidomos gjatë viteve të fundit. Sidoqoftë, duhet patur parasysh që gjatë vitit 2014, kompania e operatorit të shpërndarjes elektrike është rikombëtarizuar apo ri-shtetëzuar. Kjo ndodhi për shkak të menaxhimit të keq nga sipërmarrësi privat, i cili nxorri fitime nga detyrimet kontraktuale të paqarta gjatë procesit të privatizimit, dhe paaftësisë së qeverisë për të bërë audite për performacën e tij, të cilat

eventualisht çuan drejt një serie përplasjesh midis qeverisë dhe pronarit privat (Lami, Imami & Kächelein, 2016: 202). Megjithatë procesi i privatizimit dhe agjencitë që i zbatojnë ato në Shqipëri perceptohen si shumë të korruptuara. Ekzistojnë tregues që privatizimi në Shqipëri, ashtu si dhe në vende të tjera në tranzicion, përdoret shpesh për të financuar shpenzimet në rritje të fushatave për zgjedhje. Vendimet për të privatizuar pjesërisht apo plotësisht disa nga kompanitë shtetërore në fusha të tilla kryesore të tilla si telekomunikacionet dhe energjia, janë bërë vetëm disa muaj përpara zhvillimit të zgjedhjeve. Kjo procedurë është zhvilluar në qeveri të ndryshme, dhe shpesh vendime të tilla janë akuzuar si të lidhura me zgjedhjet nga opozita, media dhe ekonomistët (Lami, Imami & Kächelein, 2016: 202).

Ideja kryesore është që kriteret e procesit të privatizimit, të cilat u vendosën në fillim, nuk u respektuan me kalimin e kohës. Pritshmëritë ekonomike të viteve 1990-të ishin plotësisht të ndryshme nga zbatimi i tyre në vitet në vazhdim. Rekomandimet kryesore në fillim të viteve 1990-të ishin që principet e këtij programi duhej të ndërmerreshin sa më shpejt që të ishte mundur dhe që pronësia duhej të shpërndahej në mënyrë të lirë të marrësit me natyrorë të kësaj pronësie. Qëllimi kryesor ishte që ekonomia ka nevojë për subjekte dhe që asgjë nuk mund të pritet të ndodhë nëse prona private nuk është krijuar apo vendosur. Emergjencia për të pasur një shpejtësi maksimale motivohej nga kriza ekonomike shumë e rëndë e socializmit dhe turbancat reale të trashëgimisë komuniste. Sidomos kjo e fundit nënvizon nevojën për një ndarje sa më të drejtë (Aslund & Sjoberg, 1992: 142). Sidoqoftë, qeveritë shqiptare të fillim viteve 1990-të vlerësonin që kapaciteti administrativ i shteteve dhe veçanërisht kapaciteti ligjor i tyre është shumë i kufizuar. Në këtë mënyrë privatizimi duhet të jetë sa më i thjeshtë që të jetë i mundur. Në mënyrë që të shmangte konflikte të panevojshme, privatizimet fillestare do të fokusoheshin te shtetasit apo individët shqiptarë. Kishte një ndërgjegjësim që nëse qeveria nuk e shpërndante gjithçka në mënyrë të shpejtë, e gjithë prona publike do të vidhej dhe do të shkatërrohej. Në njëfarë mënyre sipas Aslund & Sjoberg (1992) 'qeveria shqiptare duket se ka bërë zgjedhjen perfekte racionale. Për më tepër, ka filluar zbatimin e saj në një formë jashtëzakonisht të vendosur. Fjalëkalimi i saj kryesor është që të fokusohet te ajo që është më e rëndësishme dhe më e lehtë. Duke qenë se më shumë se 50% e forcës punëtore të vendit është e përqendruar në bujqësi, dhe 64

përqind e popullsisë në fshat, duket e natyrshme që të fillohet me bujqësinë. Ligji i ri për pronën u miratua në parlament më 19 korrik 1991, ligj i cili e bënte të qartë që e drejta e pronës i përkiste pronarëve të rinj, duke anuluar të gjitha pretendimet e vjetra. Gjithashtu toka mund të trashëgohet. Toka bujqësore mund tju shpërndahet në mënyrë të lirë të gjithë anëtarëve të fermave bujqësore. Shpërndarja u bë nga komisionet lokale të tokave sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave. Në fillim, toka nuk mund të shitej, por qëllimi ishte që toka mund të fillonte të shitej pas pesë vitesh. Qëllimi kryesor ishte që të gjitha tokat që i përkisnin kooperativave duhej të shpërndaheshin deri në fund të shtatorit të vitit 1991, duke bërë të mundur që pronarët e rinj të mbillnin tokën e tyre duke filluar nga tetori (Aslund & Sjoberg, 1992: 142).

Sidoqoftë, jo të gjitha vendet ish komuniste zgjodhën një përqasje të shpejtë për privatizimin, sic zgjodhi të bënte Shqipëria. Studime të ndryshme kanë treguar që qeveritë e majta patën një përqasje më shumë ndaj pronës publike sesa ato të orientuara ndaj tregut, sidomos në periudhën midis mesit të viteve 1990-të deri në vitin 2007 (Bjornskov & Potrafke, 2011: 203). Më shumë se orientimi politik i qeverive në Shqipëri, disa nga arsytet që shtynë drejt një privatizimi të shpejtë u shpjeguan dhe më sipër, por kishin të bënin dhe me shifrat negative financiare. Në fakt kriza post-komuniste duke filluar nga gjysma e vitit 1989 deri në vitin 1992 ishte shumë e thellë. Inflacioni arriti në 236.6% në vitin 1992, ndërkohë që paratë u dyfishuan nga 2.8 miliardë lekë në Dhjetor 1991 në 5.7 miliardë lekë në Prill 1992, defiçiti buxhetor ishte 2.4 miliardë lekë në tetor 1991 në 8.3 miliardë lekë në Prill 1992. Ishte në këto kushte që qeveria e re filloi të zbatonte një program të ri stabilizimi, liberalizimi të çmimeve dhe tregtisë së jashtme dhe të ndërtimit të institucioneve të ekonomisë së tregut.

Tabela 1: Treguesit makro-ekonomikë 1991 - 1998 (Burimi INSTAT)

Treguesit	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
PPB	-27.7	-7.2	9.6	9.4	8.9	9.1	-7.0	8.0	7.3
Inflacioni	104.4	236.6	30.9	15.8	6.0	17.4	42.1	8.7	-1.0
Papunësia	8.9	27.9	29.0	19.6	16.9	12.4	14.9	17.7	18
Eksportet	73	70	112	141	205	229	167	205	2.75
Importet	281	524	602	601	679	921	685	826	1021
IHD	8	32	45	65	89	97	42	45	51

Ashtu siç tregon dhe Tabela 1 më sipër, qeverisja shqiptare u tregua e suksesshme për të stabilizuar ekonominë pas krizave të njëpasnjëshme. Në vitin 1993, PPB arriti nivelin e tij më të lartë të tranzicionit ekonomik të hershëm. Për shkak të politikave të rrepta monetare dhe fiskale, inflacioni u reduktua me 30%, tregtia e jashtme dhe investimet e huaja direkte filluan të bëheshin gjithnjë e më të rëndësishme. Në vitin 1995 Shqipëria kishte shkallën më të ulët të inflacionit me 6% dhe një rritje ekonomike prej 8.9%. Shqipëria kishte shkallën e dytë më të ulët të inflacionit, pas Kroacisë dhe rritjen ekonomike më të madhe ndër të gjitha ekonomitë në tranzicion. Kjo performancë makro-ekonomike impresionuese i referohej mbi të gjitha heqjes së kontrollit si dhe privatizimeve të hershme në bujqësi, tregtinë me pakicë, NVM dhe disiplinës financiare të përmirësuar të institucioneve buxhetore (Xhillari & Telhaj, 2003: 244).

Sidoqoftë, ashtu siç edhe theksova më sipër, shumë qeveri të majta të vendeve në tranzicion kishin probleme me pranimin e reformave që nënkuptonte Konsensusi i Washingtonit edhe për shkak të kostove të tranzicionit në afat-shkurtër të tilla si kostot sociale që shkaktoheshin nga papunësia masive dhe pasiguria që ofronte ajo. Konsensusi Social Demokratik, i cili u njoh gjithashtu dhe si një përqsasje graduale, nga ana tjetër, favorizonte një sërë reformash të ngadalta që do të ruanin disa ndërmarrje shtetërore dhe rregullore qeveritare. Megjithëse aderuesit e kësaj përqsasje e analizonin zgjedhjen e tyre në bazë të minimizimit të kostove sociale të tranzicionit ose shpërndarjen e këtyre kostove përgjatë një periudhe më të gjatë kohore, kjo gjithashtu nënkuptonte dhe një shkallë respekti për strukturat e pushtetit ekzistues dhe një vazhdimësi të kontrollit politik mbi ekonominë (Bjornskov & Potrafke, 2011: 205).

3.3. Roli i Bankës Botërore

Karakteristikat institucionale të menaxhimit të zhvillimit variojnë gjerësisht ndërmjet vendeve dhe nuk lënë shteg për një përgjithësim të lehtë. Gjithashtu nuk është praktike që të përpiqemi që të ndërtojmë një taksonomi duke i klasifikuar shtetet në bazë të karakteristikave të tyre të ndryshme të qeverisjes. Ky kompleksitet rritet akoma dhe më shumë në bazë të ndikimit të tyre në histori, gjeografisë, kulturës dhe institucioneve dhe rregullave të secilit vend si dhe natyrës multi dimensionale të qeverisjes si një koncept

(Banka Botërore, 1992), Është në bazë të këtij raporti të Bankës Botërore të vitit 1992 që ndryshoi dhe koncepti i saj për zhvillimin, duke e parë gjithnjë e më të lidhur me qeverisjen dhe institucionet shtetërore të çdo vendi. Në fakt kjo përjasje e re e Bankës Botërore ndodhi si pasojë e dështimit të skemave të zhvillimit në vende të ndryshme të botës si për shembull ato në Amerikën Latine, Afrikë dhe Azi. Sipas këtij raporti të parë të vitit 1992, (i cili më vonë u shoqërua dhe nga një raport tjetër në vitin 1994), çdo vend ishte i ndryshëm në nivelin politik, ekonomik dhe social dhe pasqyronte një sërë faktorësh të ndryshëm historikë, gjeografikë dhe kulturorë. Një numër vendesh ndjekësish të Bankës Botërore kanë qenë të suksesshëm në krijimin e institucioneve dhe rregullave për të promovuar zhvillimin ekonomik në shkallë të gjerë. Disa vende të tjera janë në rrugën e duhur për ta bërë këtë gjë, ndërkohë që të tjerë po punojnë në kushte të vështira politike, institucionale dhe ekonomike për të pasur një performancë më të mirë qeverisëse. Sipas këtij raporti, ajo që çfarë thuhet aty duhet që të zbatohet në vendet individuale në kontekstin e tyre. Por qeverisja e dobët mund të njihej në bazë të disa simptomave:

- Dështonte në ndarjen e qartë midis asaj që ishte publike dhe asaj që ishte private, domethënë që kishte një tendencë që ti përdorte pronat publike për përfitime private;
- Dështonte në krijimin e një kornize ligjore të parashikueshme dhe sjellja e qeverisëse të ishte udhëheqëse drejt zhvillimit, dhe të mos kishte arbitraritet në zbatimin e rregullave dhe të ligjeve;
- Rregullat dhe rregulloret e shumta si dhe kërkesat e shumta të liçensimit, dhe kështu me rradhë do të ndalonin funksionimin e tregjeve dhe do të inkurajonin krijimin e borxheve;
- Prioritetet që nuk përputheshin me zhvillimin, do të rezultonin në shpërndarjen e pasaktë të burimeve;
- Vendimmarrja shumë e ngushtë ose e bazuar në një transparencë të pakët (Banka Botërore, 1992: 9).

Programi aktual i punës i Bankës Botërore me Shqipërinë është i përfshirë në Kornizën e Bashkëpunimit me Shqipërinë i cili mbulon periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2019, dhe që ka planifikuar ndërhyrjen në shumë fusha duke siguruar një mbështetje teknike.

Shqipëria është bërë anëtare e Bankës Botërore në vitin 1991, dhe që nga ajo kohë Banka Botërore ka financuar 83 projekte në sektorë të ndryshëm, duke arritur një total prej 2.2 miliardë dollarësh (Shijaku, 2017). Për Bankën Botërore ‘Shqipëria është një vend me të ardhura mesatare që, përgjatë dy dekadave të fundit, ka bërë hapa shumë të mëdha në vendosjen e një demokracie të besueshme shumëpartiake dhe të një ekonomie tregu. Pas kalimit nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim tek Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në vitin 2008, Shqipëria ka qenë përgjithësisht e aftë të ruajë ritme pozitive rritjeje dhe qëndrueshmëri financiare, pavarësisht krizës së vazhdueshme ekonomike. Para krizës financiare globale, Shqipëria ishte një prej ekonomive me rritjen më të shpejtë në Europë, duke gëzuar norma reale rritjeje vjetore prej 6%, shoqëruar nga reduktimi i shpejtë i varfërisë. Por, pas vitit 2008 rritja mesatare u përgjysmua dhe në sektorët publikë dhe të jashtëm u krijuan zhbalancime makroekonomike. Ritmi i rritjes u pasqyrua edhe tek varfëria dhe papunësia: ndërmjet viteve 2002 dhe 2008, varfëria në vend u përgjysmua (në rreth 12.4%) por në vitin 2012 u rrit sërish deri në 14.3 %. Papunësia u rrit nga 12.5 % në vitin 2008 në 17.3 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 ku papunësia e të rinjve arriti 34.2 % (Banka Botërore, 2019).

Banka Botërore ka zhvilluar shumë projekte në Shqipëri dhe ka ndihmuar veçanërisht në rindërtimin dhe ndërtimin e 1700 km rrugëve kombëtare dhe rurale. Ka rehabilituar rreth 335 000 ha të sistemit të vaditjes dhe kanalizimeve ku kanë përfituar rreth 100 000 familje. Ka reduktuar erozionin e tokës në 220 000 ton. Gjithashtu ka ndihmuar produktivitetin dhe të ardhurat duke përmirëduar menaxhimin e burimeve natyrore në rreth 120 komuna. Ka ndërtuar ose ri-konstruktuar më shumë se 300 shkolla ku kanë përfituar më shumë se 100 000 fëmijë; 2000 shkolla të arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm janë pajisur me kompjuter dhe Banka Botërore ka ndërtuar gjithashtu laboratorë të kimisë dhe të biologjisë (Shijaku, 2017).

Sidoqoftë, ashtu siç kam shkruar dhe në pjesë të tjera të këtij disertacioni, kriza ekonomike globale erdhi më vonë se viti 2008 në Shqipëri. Në këtë mënyrë dhe ‘ritmet e rritjes mbi 3% gjatë vitit 2011 u moderuan gjatë 2012 dhe 2013, duke reflektuar në këtë mënyrë situatën e përkeqësuar në Eurozonë dhe si situatën e vështirë të sektorit energjetik. Rritja vazhdoi deri në 2.1 % në 2014, kryesisht për shkak të rritjes në konsum dhe investimet private. Pritet një

rikuperim në vitin 2015, por gjithsesi, rritja pritet të mbetet nën potencialin e vendit në planin afatmesëm. Sipas qëndrimit zyrtar të Bankës Botërore ‘Shqipëria është fokusuar tek mbështetja e rimëkëmbjes dhe rritjes ekonomike në një mjedis të jashtëm të vështirë, duke zgjeruar dhe mbështetur përfitimet sociale të vendit dhe duke reduktuar ndërkaq cënueshmërinë nga ndryshimet klimaterike. Sfidat kryesore për përparimin e Shqipërisë dhe zhvillimin e saj ekonomik sipas Bankës Botërore përfshijnë:

- konsolidimin fiskal dhe përmirësimin e menaxhimit të shpenzimeve publike;
- reformën rregullatore dhe institucionale,
- zvogëlimin e mangësive infrastrukturore; dhe
- përmirësimin e efikasitetit të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve kyçe shëndetësore (Banka Botërore, 2019).

3.4. Roli i FMN-së

Në përgjithësi, roli i organizatave ndërkombëtare në zhvillimin ekonomik të shumë shteteve është kritikuar për faktin që nuk ka sjellë rezultatet e shumë pritura të rritjes ekonomike dhe zhvillimit social të gjithanshëm. Madje roli i tyre shpesh është vënë në dyshim nga studiues dhe ekspertë të njohur të ekonomisë ndërkombëtare. Sidoqoftë, për shumë arsye, që më së pari lidhen me financimet afatgjatë dhe mundësitë kreditimit ndërkombëtar, shumë shtete, në të cilat bën pjesë dhe Shqipëria, kanë zgjedhur që të jenë pjesë e këtyre organizatave. Përveç se janë anëtare, ‘gjatë dekadave të fundit, shumë shteteve kombëtare i kanë besuar funksionet e tyre rregullatore këtyre organizatave ndërkombëtare të tilla si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Organizata Botërore e Tregtisë, të cilat janë të veshura me autoritet rregullues për politikat kyçe dhe instrumentat dhe mekanizmat e zbatimit të tyre, të tilla si mbrojtja e të drejtave të pronës, liberalizimi i sektorit financiar, si dhe kujdesi fiskal ndaj financave publike (Coe et al, 2015: 49).

Në Shqipëri ka pasur gati gjithmonë një debat të hapur për vazhdimin e rolit të FMN-së, më së shumti për shkak se qeveritë kanë dashur që të kenë më shumë liri veprimi më shpenzimet publike në kohë fushatash elektorale. Por, ekonomistët e njohur, në vend janë shprehur ‘pro’ vazhdimit të rolit të FMN-së, ku për shembull prof. Selami Xhepa nënvizon që ‘fondi, me të drejtë, vendos edhe disa paralajmërime që janë të rëndësishme sa i takon së

pari nevojës për të ruajtur stabilitetin e financave publike në terma afatgjatë, pavarësisht se qeveria dhe në programin e saj ka parashikuar që borxhi publik do të vendoset në një trajektore rënëse, për të kaluar nën 60% të PBB-së në katër vitet e ardhshme’ (Xhepa, 2017). Po ashtu ai vazhdon të argumentojë mbi vazhdimësinë e rolit të FMN-së ‘për më tepër që Shqipëria nuk ka dhe çfarë të humbasë, sepse normalisht vazhdimi i disiplinës financiare në Shqipëri është një nevojë emergjente. Në qoftë se borxhi publik është gati 70% e prodhimit të përgjithshëm kombëtar, nuk mund të ketë shqetësim më serioz për të ardhmen e ekonomisë së vendit sesa mbajtja nën kontroll e këtij treguesi dhe për rrjedhojë prezenca e FMN-së do të ishte një garanci më shumë për arritjen e një objektivit të tillë’ (Xhepa, 2017). OECD-ja vlerëson rolin e rëndësishëm që luan FMN në ekonominë shqiptare. Sipas kësaj organizate ‘Shqipëria përfundoi në mënyrë të suksesshme një program 3-vjeçar të Fondit të Facilitetit të Zgjeruar me FMN-në në vitin 2017, gjë e cila kontribuoi në rritjen e stabilitetit fiskal dhe në rënien e nivelit të borxhit publik, megjithëse mbetet sërisht i lartë dhe përbën 71% të PPB-së. Në mënyrë të vazhdueshme, mbledhja e taksave vazhdon që të mbetet një problem. Të ardhurat nga taksat ishin 22.5% të PPB-së së Shqipërisë, që do të thotë se ishin relativisht më të ulëta sesa mesatarja e vendeve anëtare në OECD që është 34.3% (OECD, 2019). Për prof. Civicin ‘problemi më i vështirë duket se është mungesa e konsensusit dhe këndvështrimet e ndryshme që ekzistojnë në lidhje me këtë çështje. Vendet europiane me në krye Gjermaninë dhe Bankën Qendrore Europiane privilegjojnë më shumë politikat e rigorozitetit buxhetor dhe shëndoshjen e financave publike, ndërkohë që SHBA është më në favor të “planeve mbështetëse e stimuluese në ekonomi, në mënyrë që të favorizohet rritja ekonomike”. “Bibla e FMN-së” duket se është një version politikash e masash që kryqëzon të dyja këto këndvështrime. Ekonomistët e saj nënvizojnë se “reduktimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm i deficiteve publike është çelësi për të pasur investime të rëndësishme private dhe për pasojë, rritje të qëndrueshme ekonomike”, por ata theksojnë gjithashtu se në këtë aspekt nuk duhet të shkohet në ekstrem, pasi “rigoroziteti i madh buxhetor mund të asfiksojë rritjen ekonomike”, duke shkaktuar kështu një dëm më të madh sesa avantazhet që përfitohen prej tij’ (Civici, 2010). Për Adrian Civicin ‘e gjithë kjo “filozofi e re” apo paketë masash që propozohet, sintetizohet në dhjetë “urdhëresa” ose vendime bazë në politikat ekonomike e financiare. Duke filluar nga janari i

vitit 2009, Shqipëria është bërë më “institucionale” në marrëdhëniet e saj me FMN-në, duke bashkëpunuar në kuadrin e të famshmit “artikulli 4”, çka nënkupton një prezencë këshilluese, analizuese e rekomanduese të FMN në Shqipëri, por gjithsesi jo “detyruese dhe kushtëzuese” (Civici, 2010).

Pavarësisht krizave ekonomike globale, FMN-ja dhe Banka Botërore vazhdojnë që të luajnë role të rëndësishme në ekonominë globale. Jo vetëm që politikat e tyre mbajnë të informuar shumë vende në zhvillim në lidhje me axhendat ndërkombëtare të zhvillimit, por ato formësojnë rendin ndërkombëtar ekonomik duke plotësuar nevojat e Grupit të të Tetëve (G8) dhe Grupit të Njëzetëve (G20). Megjithëse roli i tyre vazhdon që të mbetet shumë i diskutuar në arenën ndërkombëtare për mënyrën sesi ato i krijojnë politikat, studiuesit dhe ekspertët e ekonomisë janë të përqendruar drejt kuptueshmërisë dhe efikasitetit të institucioneve dhe kërkesat ndaj reformave. Shumica e literaturës tregon pikërisht për sfidat që hasin institucionet dhe pamundësia për ti ndryshuar ato, ose kjo literaturë përmban propozime të detajuara për përmirësimin e tyre. Një pjesë e vogël e literaturës është e përqendruar në investigimin e ideve që qarkullojnë brenda këtyre organizatave dhe ndryshimit brenda tyre (Park & Vetterlein, 2010: 8). Kjo vlen dhe për krijimin, ndërtimin dhe zbatimin e politikave të këtyre organizatave brenda shteteve. Ideja kryesore e kritikës nga antropologjistët e kulturës ka qenë që shpesh këto organizata në këto vende përfaqësojnë ‘dijen’ dhe nuk shfaqen me interesat e tyre konkrete, por ato kanë monopolin e dijes, duke pezulluar çdo dije lokale që mund të kenë këto vende. Dhe thjesht zbatimi i këtyre politikave bëhet i rrezikshëm nëse zbatohet pa marrë parasysh njohuritë lokale apo vendore.

Ndërkohë që prodhimi bëhet akoma dhe më shumë i shpërndarë në mënyrë globale, organizatat ndërkombëtare kanë zhvilluar gjithashtu kode të rëndësishme sjelljeje për kushtet e punës (si për shembull Organizata Botërore e Punës) dhe për etikën e biznesit gjatë investimeve. Të marra sëbashku, këta aktorë ndërkombëtare, të sanksionuar dhe mbështetur nga shtetet kombëtare, luajnë një rol domethënës dhe shpesh plotësues të rolit rregullator të shtetit në rrjetin global të prodhimit (Coe et al., 2015: 49). Ashtu sic shkruante dhe prof. Civici dhjetë vite më parë dhe vazhdon që të mbetet një problem shumë aktual akoma sot ‘niveli i borxheve është përtej çdo kufiri, dhe detyra kryesore mbetet kthimi i

qëndrueshmërisë të treguesve kryesorë. FMN nuk po i sjell Shqipërisë shuma të mëdha, por po i kërkon të kthehet në sjellje të zakonshme konservatore në ekonomi. [...] FMN nuk vjen në vende normale me ndonjë problem të vogël. Ne kemi një problem të madh, kemi një problem strukturor. Kemi një rrezik që na qëndron mbi kokë për stabilitetin e financave publike për borxhin dhe për të ardhmen tonë. Në këto kushte, mësuesi ose receta më e mirë, megjithë e vështirë dhe e dhimbshme, është marrëveshja me FMN. Pra, FMN është një faktor më shumë në rrugën drejt stabilitetit që ne duket se kemi filluar’ (Civici, 2014).

3.5. Roli i BE-së

BE-ja padyshim që luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe politikat që ndërmerren në lidhje me të (Vogler, 2005: 4). Vetë BE, në dokumenta të shumta, e ka njohur nevojën për zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe promovimin e tyre. Sidoqoftë aktivitetet e BE-së në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me politikat globale, dhe sidomos me ato politika që ndërmerren në kuadrin e OKB-së. BE-ja është e përfshirë në punën e organizatave ndërkombëtare dhe të qeverisjes globale në fushën e mjedisit. BE ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm ligjorë për të rregulluar dhe koordinuar aktivitetet e zhvillimit të qëndrueshëm ndërmjet shteteve anëtare. Ajo ka zhvilluar dhe implementuar gjithashtu përqasje të reja për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin ndaj ndryshimeve ekonomike dhe sociale. Me marrjen e këtyre masave si dhe për shkak të besueshmërisë së saj si institucion dhe aktor i rëndësishëm, BE është vetëquajtur një lider për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm (Kilian & Elgström, 2010: 255). Besueshmëria e BE-së si kontribues në qeverisjen globale vjen si pasojë e ‘kapaciteteve të saj për të zbatuar angazhimet që ndërmerr’ (Vogler, 2005: 847). Sidoqoftë, studiues të shumtë kanë mendime të ndryshme për rolin si lider të BE-së ndaj zbatimit të politikave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Së pari, çfarë do të thotë lidërsip? Ka shpjegime të ndryshme për këtë term, megjithëse këtu do të bazohem vetëm në përkufizimin e Megan Dee (2011). Me lidërsip autorja kupton ‘ndikimin që një aktor ushtron mbi të tjerët për të arritur një qëllim të përbashkët’ (Dee, 2011: 4). BE-ja, duke qenë një bashkim i shteteve individuale, ka nevojë për një koordinim të fortë veçanërisht, përse i përket politikave që janë kaq të zgjeruara siç është

për shembull zhvillimi i qëndrueshëm (Baker & Eckerberg, 2008). Qeverisja evropiane përballlet me probleme që kanë të bëjnë me diversitetin e madh kulturor midis vendeve anëtare. Ajo përdor veprimet kolektive si një mënyrë për të promovuar dhe vepruar për zhvillimin e qëndrueshëm. Duke iu referuar Megan Dee (2011) veprimet kolektive filluan të bëheshin primare në procesin politik-bërës evropian, si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Kjo mënyrë e shpërndarjes së përgjegjësisë e kanë bërë BE-në një lider 'drejtues' (Dee, 2011: 4), i cili i merr i pari vendimet dhe zgjidhjet për çështje të ndryshme. Falkner (2006) argumenton që në fakt përpjekjet e BE-së për tu bërë një lider nuk kanë patur shumë sukses. Vogler dhe Stephan (2007) theksojnë që këto veprime bëhen kryesisht për të pasur marrëdhënie më të mira me publikun. Si shembull, merret politika agrare e BE-së e cila ka patur ndikime negative ndaj vendeve në zhvillim. Sidoqoftë, BE-ja akoma është e përkushtuar për tu bërë një aktor udhëheqës në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, megjithëse ka disa fakte dhe prova që konfirmojnë të kundërtën.

Gerald Berger, ekspert i BE-së, shpjegon që ka shumë vite që zhvillimi i qëndrueshëm luan një rol shumë të vogël në BE. BE-ja është e përqendruar më shumë drejt çështjeve të rritjes ekonomike dhe të punësimit. Zhvillimi i qëndrueshëm shihet kryesisht si një rezultat i mirë, por nuk është ai qëllimi kryesor në shumë nga dokumentat politike të BE-së. Në kohën e tanishme, strategjia Europa 2020 shihet nga shumë vetë në Komisionin Evropian (dhe ndoshta dhe nga shumë përfaqësues të Këshillit) si një 'strategji e zhvillimit të qëndrueshëm' sepse ajo përfshin shumë çështje të tilla. Në përgjithësi kjo është e vërtetë, por e gjithë përqasja e strategjisë është e bazuar kryesisht në çështjet e rritjes ekonomike dhe të punësimit dhe me një afat të shkurtër (fokus kryesisht 10 vjeçar); ajo që mungon është një përqasje integrale, një perspektivë (së paku deri në vitin 2050) dhe mungon gjithashtu një vënie në dyshim e parandihmës së rritjes ekonomike, ose se çfarë kuptohet me rritjen ekonomike. Kështu, që potencialisht BE-ja, ia ka arritur qëllimit të përhapjes së ideve por mungon dizenjimi dhe implementimi i politikave që kanë në fokus zhvillimin e qëndrueshëm.

Një rol të rëndësishëm nuk luajnë vetëm vendimet dhe promovimet. BE-ja ka nevojë që të krijojë një proces të politikë- bërjes që të jetë i dedikuar nga zhvillimit të qëndrueshëm

(Meadowcroft, 2007). Ndërkohë që BE vazhdon që të merret me procesin e integritit, një sërë problemesh vazhdojnë të mbeten: çëshjet mjedisore, menaxhimi i integruar i ekonomisë, dhe harmonizimi i interesave kombëtare të çdo vendi anëtar. Në këtë kuadër, roli i politikave si mekanizma të zhvillimit dhe të rritjes ekonomike rritet në mënyrë të ndjeshme. Emergjenca që ka lindur për të krijuar një politikë të zhvillimit të qëndrueshëm të centralizuar dhe strukturuar (ndërmjet të gjitha vendeve anëtare) është e natyrshme.

Strategjia e BE-së për zhvillimin e qëndrueshëm u zhvillua në mënyrë që këto ide të ngriheshin edhe në nivel kombëtar, te vendet anëtare të saj. Sidoqoftë shumë studiues kanë vënë re se megjithëse kishte një vëmendje të madhe ndaj ideve të zhvillimit të qëndrueshëm, ndryshimet në qeverisje ishin të pakta. Stirling (2006) dhe Rauschmayer (2009) mbrojnë idenë që proceset e BE-së që kanë të bëjnë me mirë-qeverisjen, zbatimin dhe vlerësimin e qeverisjes, përmirësojnë rezultatet në vendet anëtare. Procesi i Stabilizim-Asociimit për pesë vendet e Evropës Jug-Lindore, përfshi Shqipërinë, ka filluar që gjatë Samitit të Zagrebit të mbajtur në nëntor të vitit 2000. Veç kësaj, Procesi i Stabilizim-Asociimit (SAP) është konfirmuar si politikë e BE-së për Ballkanin Perëndimor në Këshillin Evropian të Selanikut 2003 dhe, në të njëjtin vit, Presidenti i Komisionit filloi procesin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Republikën e Shqipërisë.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij nga ana tjetër u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2009. Qëllimet e Stabilizim-Asociimit, siç parashikohet në Nenin 1 të Marrëveshjes janë të "mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; për të kontribuar në stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit; të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike

të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë; të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat që mbulon kjo Marrëveshje".

Gjithashtu, Republika e Shqipërisë është e angazhuar për të respektuar parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të të Drejtave të Njeriut siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re. Përveç kësaj, Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, përfshi një nivel të përshtatshëm të marrëveshjeve të ndërsjellta në lidhje me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, sidomos ato që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, migracionit të paligjshëm dhe trafikimit, përfshi në veçanti atë të qenieve njerëzore dhe të drogave të paligjshme. Angazhimet e përmendura më lart janë një faktor kyç që mund të kontribuojë drejt një stabiliteti rajonal dhe bashkëpunimit të mëtijshëm midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Shqipëria paraqiti kërkesën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 28 prill 2009. Pas kërkesës nga Këshilli, Komisioni paraqiti Opinionin e tij mbi aplikimin e Shqipërisë në nëntor 2010. Në Opinionin e tij, Komisioni vlerësoi se para se negociatat e pranimit të mund të hapen zyrtarisht, Shqipëria ende kishte për të arritur një shkallë të nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe në veçanti për të përmbushur 12 prioritetet kyçe të identifikuar në Opinion. Në tetor 2012, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit me kusht plotësimin e masave kyçe në fushat e reformës gjyqësore dhe të administratës publike dhe rishikimin e rregullores së Parlamentit.

Komisioni edhe një herë rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit në Raportin e Progresit 2013 dhe duke identifikuar 5 prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim. Këto prioritete janë: reforma e administratës publike; pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjshmëria e institucioneve gjyqësore; lufta kundër korrupsionit; lufta kundër krimit të

organizuar; mbrojtja e të drejtave të njeriut (përfshi politikat e mos-diskriminimit, komunitetin rom, si dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë). Më 11 nëntor 2013 filloi Dialogu i Nivelit të Lartë për prioritetet kryesore midis Shqipërisë dhe BE-së. Dialogu i Nivelit të Lartë shërben si një mjet për të strukturuar bashkëpunimin BE-Shqipëri dhe për të ndihmuar Shqipërinë të mbajë fokusin dhe konsensusin për integrimin në BE. Opozita dhe institucionet e pavarura të marrin pjesë në mënyrë aktive në Dialogun e Nivelit të Lartë të mes Komisionit Evropian dhe Shqipërisë. Duke pasur këtë parasysh, në dritën e detyrimeve që duhet të përmbushen në kuadër të MSA-së, qëllimin strategjik për të arritur anëtarësimin në BE dhe përgjegjësinë që ky qëllim përfshin, si dhe reformat sociale, ekonomike dhe legislative që tashmë kanë filluar, Shqipëria ka miratuar një qasje strategjike, e cila do të rregullojë detyrimet që ka marrë përsipër në bazë të kapaciteteve të veta dhe interesave kombëtare.

Prioritetet e përcaktuara në Planin Kombëtar për integrimin evropian janë përcaktuar në bazë të një numri burimesh, përfshi Planin Vjetor të Punës të Qeverisë (PVPQ), MSA, Partneritetin Evropian, vlerësimet e progresit të Shqipërisë të përfshira në Raportet Vjetore të Komisionit Evropian. Prioritete afatshkurtra në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian në pesë fushat kryesore prioritare janë të sinkronizuara plotësisht me Udhërrëfyesin mbi 5 prioritetet kyçe të miratuara nga Qeveria shqiptare më 28 maj 2014. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian sapo të jetë shqyrtuar deri nga fundi i vitit 2014, do të sinkronizohet edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020, që do të miratohet në dhjetor 2014. Për këtë arsye, Plani Kombëtar reflekton gatishmërinë e Shqipërisë për të arritur qëllimet e saj prioritare afatshkurtra dhe afatmesme në procesin e përafrimit me BE deri në zbatimin e masave konkrete, me theks të veçantë për vitin 2014 (Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014) .

3.6. Zhvillimi rajonal dhe ndikimi i tij në strukturën ekonomike shqiptare

Përveç anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, Shqipëria gjatë tranzicionit ekonomik të saj ka nënshkruar dhe shumë marrëveshje ekonomike rajonale. Rajoni i Ballkanit ka ndryshuar në një mënyrë shumë thelbësore për shkak të ndërveprimit të shumë forcave të

integritit dhe të tranzicionit ekonomik që e kanë ndryshuar peisazhin e ri ekonomik evropian. Strukturat e vjetra të organizimit ekonomik të brendshëm dhe të marrëdhënieve ekonomike me jashtë, ranë poshtë, dhe struktura të reja ekonomike, politike dhe institucione janë duke u zhvilluar megjithëse ndonjëherë kjo do të thotë që këto reforma të jenë të dhimbshme dhe të detyrueshme. Ndërkohë që ranë ndarjet dhe ndasitë e vjetra evropiane, një gjeografi e re ekonomike lindi, duke ngritur njëkohësisht dhe shumë pyetje mbi karakteristikat ekonomike dhe strukturore. Pavarësisht pritshmërive të ekonomistëve neoklasikë dhe të fillimit për një konvergjencë gjithmonë e më të madhe në një mjedis ekonomik liberal, dhe të drejtuar nga tregu dhe mjedisi ekonomik, ideja kryesore e shumë studiuesve është që integrimi në të njëjtin treg i partnerëve të pabarabartë krijon presione të mëdha dhe divergjenca midis tyre, gjë që lehtësisht vihen re në Evropën Julindore dhe në Ballkanin Perëndimor (Petrakos & Totev, 2000). Këta autorë kanë treguar që rajoni i Ballkanit përbëhet dhe karakterizohet nga axhustime strukturore të pafavorshme dhe është pikërisht në një rajon të tillë që parandigmat e integritit dhe të tranzicionit hasin dhe vështirësitë më të mëdha dhe tregojnë dhe performancë të dobët. Petrakos & Totev (2000) sugjeronin që idetë ekonomike të dinamikës midis integritit dhe tranzicionit duhej që të rivlerësoheshin përsa i përket shpejtësisë dhe performancës së drejtimit që të mos krijoni një hapësirë ekonomike të fragmentarizuar në periferi të Europës (Petrakos & Totev, 2000). Përveç parandigmës së tranzicionit dhe të integritit, në bashkëpunimet rajonale të Shqipërisë me vendet fqinje dhe të rajonit u zbatua dhe paradigma që rritja ekonomike do të sillte dhe paqen midis vendeve, për shkak të lëvizjes së lirë të mallrave, njerëzve dhe kapitalit (Kuznets, 1989: 22). Por kjo paradigmë jo gjithmonë ka rezultuar e vërtetë dhe në shumë raste karakteristika të veçanta të shteteve kombëtare kanë treguar më shumë gatishmëri për format e luftës përsa i përket konkurrencës ndërkombëtare në fushën ekonomike. Këto aspekte të prishjes së paqes shpesh përfshijnë ushtrimin e pushtetit nga vendet e zhvilluara për të imponuar një status të nënshtruar ndaj vendeve më pak të zhvilluara apo që hasin probleme me rritjen ekonomike (Kuznets, 1989: 23).

Zhvillimi rajonal mund të konceptualizohet në këtë mënyrë si një rezultat dinamik i marrëdhënies komplekse midis rrjeteve specifike të rajonit dhe rrjetit global të prodhimit brenda kontekstit të ndryshimit të strukturave të qeverisjes rajonale (Coe et al., 2015: 18).

Pavarësisht trajektoreve të ndërvarura, zhvillimi rajonal vazhdon të mbetet një proces shumë i fragmentarizuar që nuk mund të parashikohet apriori (Coe et al., 2015: 19). ‘Ekonomitë e rajonit dominohen nga industria e shërbimeve dhe e faktoringut, ndryshe nga Shqipëria e cila e ka të pozicionuar strukturën e ekonomisë së saj në bujqësi dhe shërbime edhe pse burimet natyrore të vendit dhe moshë e re popullsishë avantazhojnë sektorët e tjerë’ (Gazeta Dita, 2016).

Sipas statistikave të Bankës Botërore, struktura e ekonomisë së rajonit ku përfshihen Shqipëria, Bosnja, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia dominohen nga shërbimet, të cilat zënë nga 51-71 për qind të ekonomisë në varësi të vendeve. Shqipëria edhe pse ka 316 kilometër vijë bregdetare, industria e shërbimeve zë peshën më të ulët në ekonomi në vetëm 51% në krahasim me vendet e tjera. Në Maqedoni sektori i shërbimeve zë 64 për qind të ekonomisë, në Malin e Zi mbi 71 për qind, për shkak se vendi fqinjë e ka zhvilluar ekonominë bazuar në industrinë e turizmit nëpërmjet modelit të resorteve. Në Bosnjë sektori i shërbimeve zë 64.8% të ekonomisë, në Serbi 59%, ndërsa në Kosovë 57.4%.

Ndryshe nga Rajoni, bujqësia paraqitet dominante në strukturën ekonomisë shqiptare. Edhe pse vendi ynë është një importues neto i prodhimeve bujqësore, ka copëzimin më të lartë tokës në krahasim me rajonin dhe me një zhvillim spontan të paorganizuar pesha e bujqësisë në strukturën e ekonomisë është sa dyfishi i rajonit (22%). Në Maqedoni, bujqësia zë 11% të ekonomisë, në Malin e Zi vetëm 9.8%, në Serbi, 9.4%, në Bosnjë 8.3% dhe në Kosovë 14.4%.

Manifaktura është ajo që bën diferencën. Në rajon kjo degë ka dyfishin e peshës në krahasim me Shqipërinë. Në Shqipëri ajo zë vetëm 5.6% të peshës në ekonomi, ndërsa në Bosnjë 13.2%, në Kosovë 13.2% në Maqedoni 11.8% të ekonomisë, në Malin e Zi, 4.9% dhe Serbia ka peshën më të lartë të manifakturës në ekonomi me 19.1%. Ekonomitë e rajonit paraqesin struktura të ngjashme, ndërsa në Shqipëri ka një kontribut të rëndësishëm bujqësia në dallim nga vendet e tjera. Përsa i përket ecurisë së eksportit të të mirave dhe shërbimeve ndaj PBB-së, Shqipëria mbetet mbas Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi dhe i krahasueshëm me Bosnje-Hercegovinën (Gazeta Dita, 2016).

3.7. Përmbledhja e kapitullit

Si përmbledhje për këtë kapitull mund të thuhet që ekziston një konsensus midis akademikëve, politikë-bërësve dhe praktikuesve të zhvillimit që një shkak thelbësor për vështirësitë e përjetuara nga shumë ekonomi në tranzicion ka qenë fakti që reformat nuk janë shoqëruar nga krijimi i biznesve të reja private, dhe veçanërisht i NVM-ve. Kjo është më së shumti e vërtetë në vende që janë krijuar në Evropë pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Vende të tjera, të tilla si Shqipëria kanë dështuar në krijimin e kushteve të favorshme si për shembull një sistem i drejtë taksimi, korniza ligjore, administrata efikase, dhe kapacitetet e duhura të burimeve njerëzore për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit (Ateljevic & Trivic, 2016: 2). Ajo që i duhet NVM-ve lokale sot në Shqipëri është eksperiencia e madhe që zotërojnë firmat e zhvilluara në ndarjen globale të punës të tilla si:

- Kosto;
- Fleksibiliteti;
- Shpejtësia (Coe et al., 2015: 4)

Këto tre faktorë luajnë një rol të rëndësishëm dhe kanë pasojë diferencuese për konfigurimin e rrjetit global të prodhimit dhe të zhvillimit ekonomik në rajone të ndryshme dhe ekonomi kombëtare.

Sidoqoftë, një analizë e tranzicionit ekonomik të Shqipërisë mund të bëhet dhe duke u bazuar në shtatë variablat kryesore të përpunuara nga BERZH:

- a) Të ardhurat nga privatizimet (përqindja që zënë të vlera e përgjithshme e PPB-së);
- b) Përqindja që zënë të ardhurat nga sektori privat në PPB;
- c) Përqindja që zënë punësimet në sektorin privat në numrin e përgjithshëm të të punësuarve në vend;
- d) Subvencionimi i buxhetit dhe transferimet aktuale (përqindja e PPB-së);
- e) Përqindja që zë industria në punësimin e përgjithshëm;
- f) Ndryshimet në produktivitetin e punës në industri;
- g) Investimet/ PPB-ja (në përqindje). (Bjørnskov & Potrafke, 2011: 211).

Të gjithë këto kriterë klasifikuese do të trajtohen më gjerësisht në kapitullin në vazhdim.

KAPITULLI IV: ZHVILLIMI EKONOMIK DHE RITJA EKONOMIKE SHQIPTARE

Rritja ekonomike zakonisht konceptualizohet si akumulimi i kapitalit (të ri) dhe si rrjedhojë edhe e zgjerimit të tij në aktivitetin ekonomik dhe në prodhim. Ajo përfshin një proces dinamik ku mësohet duke bërë (*'learning-by-doing'*), dhe ku, investitorët të nxitur nga shpirti kejnesian, shfrytëzojnë burimet e papërdorura dhe faktorin e prodhimit të pakufizuar të kapitalit, për të krijuar një aktivitet ekonomik të ri në kushte paqartësie në lidhje me kushtet e ardhshme dhe risqet që e presin (Stephan, 1999: 11). Për më tepër, termi 'zhvillim ekonomik' përshkruan ndryshimet teknologjike dhe strukturore, të cilat ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga rritja ekonomike dhe motivohen apo vihen në zbatim nga proceset integruese.

Ashtu siç e përshkruante dhe Schumpeter, e vjetra duhet që të shkatërrohet që t'ia lërë vendin prodhimeve të reja në strukturat e reja dhe duke vënë në zbatim teknologji të reja: dhe në këtë mënyrë sipas Johannes Stephan tranzicioni ekonomik i vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore megjithëse i përshkruar si një process reçensioni, nëse përkufizohet në termat e mësipërm, si e vjetra që ia lë vendin teknologjive të reja, atëherë këto vende i plotësojnë kushtet që kanë hyrë në një fazë të re të zhvillimit ekonomik (Stephan, 1999: 11).

Megjithatë, duhet theksuar që megjithëse shkenca moderne dhe teknologjia në natyrën e tyre janë 'ndërkombëtare', në kuptimin që gjetjet dhe procedurat e tyre janë të vlefshme dhe të zbatueshme në të gjithë botën, studimet dhe analizat e rritjet ekonomike janë kryesisht shtetërore dhe kombëtare dhe lidhen me njësitë kombëtare sovrane – janë këto njësi që marrin vendimet dhe vendosin kushtet si dhe monitorojnë rregullat e përgjithshme të zbatimit të shkencës dhe të teknologjisë për qëllime njerëzore, dhe ndërmjet të cilave dhe qëllimet ekonomike. Këto njësi kombëtare janë zhvilluar nëpërmjet proceseve të gjata historisë të ndërtimit të ndienjës së komunitetit dhe të interesit të përbashkët; dhe në rastin e vendeve të zhvilluara, këto ndienja lindën shumë më përpara se shekulli i 18-të, i cili është shekulli që shënoi dhe periudhën e rritjes ekonomike moderne. Ishte kjo rritje ekonomike e

cila kontribuoi në forcimin dhe ndërthurjen e nacionalizmit me sovranitetin në shtetin kombëtar laik, në fillim në vendet që u zhvilluan më herët për tu përhapur më pas në të gjithë botën (Kuznets, 1989: 20).

4.1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Në Shqipëri strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm quhet Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Pra, është një ndërthurje midis strategjisë së zhvillimit ekonomik, social, mjedisor, arsimor dhe turizmit dhe çështjeve të integritetit në BE. ‘Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim zëvendëson Strategjinë e mëparshme Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES), e cila ishte dokumenti kryesor strategjik i qeverisë deri në vitin 2006’ (SKZHES, 2006). Ndryshimet që sjell SKZHI-ja kanë për qëllim të përmirësojnë disa kufizime që kishte strategjia e mëparshme e SKZHES:

SKZHES-ja bazohej mbi një numër të kufizuar dokumentesh sektoriale të hartuara *ad hoc* dhe jo si pjesë e një procesi planifikimi të rregullt nëpër ministri. Integrimi Europian dhe anëtarësimi në NATO nuk ishin pasqyruar plotësisht. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim ka disa avantazhe të cilat janë rreshtuar më poshtë:

- o Strategjitë sektoriale janë dokumenti i referencës për Projektin Buxhetor Afatmesëm. Përgatitja dhe aktualizimi i strategjive sektoriale është një nga tiparet kryesore të procesit të SKZHI-së.

- o SKZHI-ja do të jetë e bazuar në një kuadër pesë-vjeçar. Ajo është konceptuar si një dokument afatgjatë, që përputhet me kuadrin buxhetor të Bashkimit Europian dhe veçanërisht me Instrumentin e Asistencës së Para-aderimit.

- o Ajo do të japë informacion për PBA-në duke parashikuar një drejtim afatgjatë për shpërndarjen e të ardhurave midis sektorëve të ndryshëm.

Puna për miratimin e strategjisë së parë kombëtare për zhvillim dhe integrim filloi në vitin 2006 dhe përfundoi me miratimin e kësaj strategjie në një afat pesë- vjeçar: 2007 – 2013. Ndërkohë që gjatë vitit 2013 nisi puna për miratimin e strategjisë së dytë të këtij lloji 2014 – 2020.

Në SKZHI 2007 – 2013, në fjalën e tij të hapjes kryeministri i asaj kohe, Z. Berisha shkruante që ‘për herë të parë harmonizohen në një dokument të vetëm strategjik axhenda për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshëm me axhendën e integritit në Bashkimin Europian dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit’’ (SKZHI, 2006). Kjo strategji shërbente dhe si një proces afatmesëm dhe afatgjatë për planifikimin strategjik, e cila përcakton përparësitë dhe synimet strategjike. Sidoqoftë në këtë proces është e përfshirë dhe Ministria e Financave përdorisa Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili kërkon që çdo ministri të përgatisë midis marsit dhe majit një plan trevjeçar brenda një tavani shpenzimesh të përcaktuar, për të arritur objektivat e politikës, si hapa të ndërmjetshëm për arritjen e qëllimeve të SKZHI-së. Tavanet buxhetore të vitit të parë të PBA-së shpërndahen me detaje gjatë procesit të buxhetit vjetor, që realizohet midis muajve korrik dhe tetor.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programi Buxhetor Afatmesëm gjatë viteve 2007 – 2013 u mbështetën në këto fusha kryesore:

- Integrimin në Bashkimin Europian, veçanërisht zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), dhe Integrimin në NATO përmes plotësimit të standardeve për anëtarësim, në këto fusha: politike, ekonomike, ligjore, ushtarake, financiare dhe të sigurisë së informacionit.
- Menaxhimin e investimeve publike, i cili është bërë pjesë e PBA-së.
- Asistencën e huaj, veçanërisht për të optimizuar përdorimin e ndihmës së huaj në përputhje me zotimet e deklaratës së Parisit për efikasitetin e ndihmës së huaj nënshkruar në muajin mars të vitit 2005 (SKZHI, 2006).

Në bazë të urdhërit të kryeministrit Rama Nr. 183, datë 23.6.2014 ‘Për përgatitjen dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020’ thuhet që në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës, dhe të strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, miratuar me vendimin nr. 692, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave duhej që të fillonte përgatitja për finalizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014 – 2020, si sintezë e të

gjitha politikave publike sektoriale e ndërsektoriale. Në këtë urdhër përcaktohet edhe shtojca të cilën do të ketë kjo strategji. Strategjia 2014 – 2020 nuk parashikon ndonjë ndryshim në krahasim me strategjinë 2007 – 2013 pasi institucioni koordinues mbetet i njëjtë. Ndryshimi i vetëm është emërtimi. Kështu në urdhërin e kryeministrit thuhet që: ‘Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DEPZHFND), në Kryeministri, të udhëheqë procesin dhe të koordinojë institucionet qendrore për finalizimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020’ .

Sidoqoftë titullarët e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore, të sigurojnë zhvillimin e procesit, bashkëpunimin e nevojshëm, si dhe të përgatisin me cilësi dhe në afat të gjitha materialet e kërkuara për politikat sektoriale dhe të koordinuara nga Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DEPZHFND), në Kryeministri. Në urdhërin e kryeministrit është e parashikuar gjithashtu dhe grafiku kohor për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2014-2020. Sipas këtij grafiku i strategjia duhej të miratohej më 24 dhjetor 2014 në Këshillin e Ministrave. Në shtojcën numër 2 të këtij urdhëri është e parashikuar gjithashtu dhe struktura e strategjisë.

Lista e fushave është si më poshtë:

- 1) Integrimi në BE, politika e jashtme dhe e mbrojtjes;
- 2) Demokratizimi dhe shteti i së drejtës;
- 3) Zhvillimi ekonomik dhe social.

Në disa nga draftet e paraqitura ndërmjet viteve 2014 -2016 të ‘Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020’, ato janë bazuar në programin e koalicionit qeverisës dhe si pasojë përfshijnë fushat e mëposhtme:

- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim;
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit;
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian;
- Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve;
- Strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri;
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin & Qeverisjen Vendore (SKZHI, 2006).

‘Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020 është aprovuar nga Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 348, datë 11.5.2016 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 86. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020 (SKZHI) është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritit evropian.

SKZHI 2015 - 2020 kombinon agjendën zhvillimore me proceset integruese të vendit, duke përmbledhur vizionin, prioritetet dhe objektivat madhore kombëtare. SKZHI 2015 - 2020 është një platformë kyçe për planifikimin e zhvillimit të vendit për periudhën 5 vjeçare 2015 – 2020 në fushat e mëposhtme:

- Integrimi evropian
- Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës
- Stabiliteti makroekonomik dhe fiskal
- Rritja e konkurrueshmërisë
- Zhvillimi njerëzor dhe kohezioni social
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve (SKZHI, 2016).

Duhet theksuar që punësimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm përmendet shumë pak në këtë strategji kombëtare shqiptare. Më shumë përmenden kriteret politike dhe ekonomike. Zhvillimi i qëndrueshëm, i cili shpesh përdoret si një markë ‘për të promovuar përqsjet mjedisore për zhvillimin ekonomik’ (Pezzoli, 1997: 549) është interpretuar në mënyrë të paqartë dhe debatet për përkufizimin e tij kërkojnë vëmendje. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është rezultat i zhvillimit socio-ekonomik, diskutimi mbi të cilin filloi në vitet 1970-të, ku një sërë artikujsh iu përkushtuan çështjeve të burimeve natyrore dhe ndotjes mjedisore. Analizimi i strategjive kombëtare dhe evropiane si dhe politikave të tjera mjedisore do të bëhej më i lehtë nëse do të zbulonim rrënjët historike të këtij koncepti. Koncepti përmban perspektiva të ndryshme; ai përqendrohet në diskutimet politike të zhvillimit të qëndrueshëm dhe i kushton më pak rëndësi kërkimit shkencor dhe ndryshimeve të këtij koncepti.

4.2. Aderimi i Shqipërisë në konventat ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm

Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Human, e cila u zhvillua në Stokholm (Suedi) në vitin 1972, ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin fillestar të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, ashtu siç u zbatua më pas dhe nga qeveritë që nënshkruan konventën. Principet e Deklaratës së Stokholmit mbi Mjedisin Human përmbanin disa ‘ligje të buta’ për ruajtjen e mjedisit ndërkombëtar. Konferenca e Stokholmit formuloi të drejtën e individëve për të jetuar ‘në një mjedis cilësor që do të thotë një jetë me prosperitet dhe dinjitoze’ (UNCHE, 1972). Që nga ajo kohë, një numër i madh organizatash dhe institucionesh ndërkombëtare të disa vendeve, kanë adoptuar në dokumentat themelore të shteteve të tyre si dhe në kushtetutat kombëtare si një të drejtë themelore të individit edhe të drejtën ‘për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm’. Për më tepër, mjedisi është përfshirë në listën e prioriteteve në nivelin rajonal dhe kombëtar. Konferenca konfirmoi nevojën për një strategji zhvillimi afatgjatë, duke marrë parasysh ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e çështjeve bashkëkohore.

Termi zhvillim i qëndrueshëm u përhap në vitin 1987, kur një raport ‘Mbi të ardhmen e përbashkët’ u botua nga Komisioni Botëror mbi Mjedisin dhe Zhvillimin. Steurer dhe Martinuzzi e vlerësojnë këtë raport si ‘strategjia apo programi i parë në një kuptim të gjerë të fjalës që eksploronte të ardhmen e politikë – bërjes në termat ‘çfarë’ dhe ‘si’ (Steurer & Martinuzzi, 2007: 149). Hopkins argumenton që raporti ndihmoi për të promovuar në përgjithësi shprehjen ‘zhvillim i qëndrueshëm’, por ai vlerëson që impakti i këtij raporti është materializuar vetëm gjatë këtij shekulli (Hopkins, 2007).

Përkufizimi i zhvillimit të qëndrueshëm, ashtu siç pohohet në raportin ‘Mbi të ardhmen e përbashkët’ është ‘zhvillimi që plotëson nevojat e tanishme duke mos rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre’ (WCED, 1987). Ky përkufizimi i zhvillimit të qëndrueshëm është përdorur shumë, por sidoqoftë ai pasqyron vetëm objektivin strategjik, sesa jep një mënyrë konkrete veprimi. Gjithashtu ai nuk tregon në mënyrë eksplicite idenë për ruajtjen e mjedisit. Njohja zyrtare e pikëpamjes së zhvillimit të qëndrueshëm u bë në konferencën e OKB-së mbi Mjedisin dhe Zhvillimin në Rio de Janeiro në vitin 1992, ku u fut dhe një konceptim i ri i zhvillimit. Sipas Elkingtonit (2007), proceset globalizuese i kthyen teoritë e politikë-bërësve drejt një nevoje për një zhvillim të

qëndrueshëm. Së bashku me ndryshimet globale në fushën sociale, ekonomike dhe mjedisore nisën me të njëjtin hap dhe marrëdhëniet midis “mbrojtjes mjedisore” dhe “zhvillimit ekonomik”(Gamage & Boyle, 2008: 1).

Dokumenti i adaptuar “Akhenda 21” nis me qasjen që “integrimi i përfaqësuesve mjedisore dhe zhvilluesë (...) do të sjellë plotësimin e nevojave bazike, do të përmirësojë standartin e jetës për të gjithë dhe (...) për një të ardhme më të begatshme” (UNCED, 1992). Hopkins vëren që vetë koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm u krijua për të përmirësuar jetën e individëve por argumenton që në ditët tona është më shumë i përkushtuar për të ardhmen.

Samiti i Tokës, ose Samiti Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i mbajtur në shtator të vitit 2002 në Johannesburg (Afrikën e Jugut), riafirmoi edhe njëherë devotshmërinë për idetë për të inkorporuar politika që mbështeten dhe e vënë theksin te mjedisi. Ndërkohë që në konferencën e Rio de Janeiro-s u diskutua më shumë për politikat ambientaliste për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm, në konferencën e Johannesburgut iu kushtua më shumë vëmendje çështjeve sociale dhe ekonomike. U vlerësua që problemi global i degradimit natyror nxitej më shumë nga varfëria dhe nga shpërndarja e pabarabartë e përfitimeve ekonomike; dhe që bota duhej t’i përkushtohej më shumë “zhvillimit mjedisor”.

Kështu, në të dy dokumentet që u adoptuan nga këto dy samite, iu dha prioritet çështjeve sociale për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm, vecanërisht zhdukjes së varfërisë, promovimit të shëndetit e sidomos çështjeve sanitare duke përfshirë ujin e pijshëm të pastër. Është e rëndësishme që të theksojmë që në këto dy samite nuk morën pjesë vetëm struktura qeveritare por gjithashtu dhe organizata jo-qeveritare të nivelit lokal dhe ndërkombëtar. Këto organizata morën nisma të rëndësishme për një sukses me të madh politikave për ujin dhe sanitetin, zhvillimit të energjisë, rritjes së prodhimit bujqësor, përdorimin e duhur të kimikateve toksike, ruajtjes së diversitetit biologjik dhe menaxhimit më të mirë të ekosistemeve.

U vu re që aspektet mjedisore dhe ekonomike nuk janë të mjetueshme për zbatimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm në praktikë: ato duhen plotësuar dhe nga aspekte të tjera: sociale, informimi, menaxhimi (Deklarata mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm në Johannesburg, 2002). Çështjet mjedisore filluan të shihen në kontekstin e qëndrueshmërisë dhe u diskutuan si për shembull ruajtja e bazës së burimeve natyrore për

zhvillimin ekonomik dhe social, duke pohuar që këto çështje nuk mund të shiheshin të pavarura nga njëra tjetra. Në këtë mënyrë, aktorët e pranishëm në këto samite arritën që të miratonin një parandihmë të re të zhvillimit të qëndrueshëm. Për herë të parë u përmend që masat për të adresuar dëmin mjedisor duhet të adoptoheshin në nivelin qeveritar. Kjo është dhe një nga hipotezat e kësaj teme.

Principet nga të cilat udhëhiqet zhvillimi i qëndrueshëm janë natyra dhe shoqëria, balanca midis shoqërisë në stadin e tanishëm të zhvillimit si dhe stadave të mëvonshme të zhvillimit të njerëzimit. Përkufizime të tilla u transformuan në një përqsje me tre shtylla kryesore, e cila tregon lidhjet ndërmjet pjesëve ekonomike, sociale dhe mjedisore. Disa autorë të tillë si Elkington (2007) i japin kësaj përqsje një emër tjetër – linja me tre shtylla – e cila ka po të njëjtin kuptim dhe përfshin ‘përgjegjësinë mjedisore, ndërgjegjësimin social dhe përfitimin ekonomik’(Elkington, 2004). Një shembull i qartë i kësaj përqsje shfaqet dhe në figurat më poshtë:

Figura 7: Tre përbërësit kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm në teori




Figura 8: Tre përbërësit kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm në praktikën e sotshme




Figura 9: Ndryshimi që duhet bërë në komponentët e zhvillimit të qëndrueshëm




Figura 9 tregon sesi duhet të jetë zhvillimi i qëndrueshëm. Ai nënvizon që komponentët socialë, ekonomikë dhe ekologjikë të zhvillimit të qëndrueshëm janë të lidhura ngushtësisht midis tyre. Duke iu referuar Gamage and Boyle (2008) 'të tre komponentët duhen marrë sëbashku kur ndërmerren veprime apo politika të caktuara' (Gamage & Boyle, 2008: 48). Një studiues tjetër, Seghezzo e quan këtë model shumë antro-po-centric, ku mirëqenia njerëore vlerësohet si çështja e fundit 'për mbrojtjen e kapitalit natyror'. Ai shton që samitet i kanë kushtuar më shumë vëmendje ekonomisë, si forca drejtuese e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo ka çuar drejt dominimit të dimensionit ekonomik, ashtu siç tregohet në figurën 9 (Seghezzo, 2009:540). Autorë të tjerë argumentojnë me tone akoma më kritike duke shkruar që idetë për të integruar së bashku zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor janë akoma ide abstrakte, të cilat zhvillohen në momente që mjedisi po shkatërrohet akoma më shumë, dhe shumë pak gjëra të rëndësishme janë arritur duke zbatuar politika të zhvillimit të qëndrueshëm (Vlerësimi i mijëvjeçarit për ekosistemet, 2005).

Duke iu referuar debateve shkencore, zhvillimi i qëndrueshëm karakterizohet si një koncept kontradiktor por efektiv, i cili është vendosur në axhendën e shumë institucioneve qeveritare. Ideja drejtuese e bashkëpunimit kolektiv në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm është akoma një proces në ndërtim e sipër dhe ku duhen ndërtuar struktura bashkëpunuese efikase. Sidoqoftë, debatet e reja shkencore e kanë ndryshuar në mënyrë domethënëse kuptimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ia vlen të përmendim këtu, që disa studiues sot po përpiqen që të shmangin figurën me tre shtylla kryesore dhe po përpiqen që ta transformojnë atë në një teori më përgjithësuese (Ott, 2003: 64). Seghezzo nënvizon

kufizimet e përkufizimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe krijon një trekëndësh alternativ të përbërë nga ‘Vendi’, ‘Vazhdimësia’ dhe ‘Individët’ (Seghezzo, 2009: 540). Ai shkruan për ndjeshmërinë e lartë të kësaj përjasje të re dhe shpjegon sesi eksplorimi i hapësirës, kohës dhe individëve mund të ndihmojnë në formulimin e politikave rajonale apo kombëtare.

Ndërsa një studiues tjetër shkruan për idetë e studiuesve mbi politikën ambientaliste, aty ku shoqëritë dhe mjediset janë në një sistem ndërveprues së bashku (Pezzoli, 1997: 558). Sipas kësaj përjasjeje, veprimi njerëzor dhe ndryshimi i klimës janë probleme globale të ndërlidhura, ndërkohë që zhvillimi i qëndrueshëm kërkon kërkim, planifikim dhe mësim shkencor mbi ‘kuptueshmërinë njerëzore’. Nga ky këndvështrim, studiuesit fajësojnë përkufizimin e Komisionit Brundtland që e vuri theksin te rritja ekonomike ‘për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm’ (Pezzoli, 1997: 556).

Smith dhe Stirling (2010) theksojnë rolin e zgjidhjeve socio-teknike për të zgjidhur problemet e zhvillimit të qëndrueshëm. Ata argumentojnë që teknologjitë me efekte pozitive janë instrumenta të mirë për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë rast, teknologjitë e gjelbra sjellin rezultate pozitive për sistemet politike, ekonomike dhe sociale (Smith & Stirling, 2010: 2). Me shembullin e emetimeve të karbonit, autorët nënvizojnë nevojën për ndryshime rrënjësore në infrastrukturën energjetike në të gjithë botën. Sidoqoftë, kjo çështje mbetet akoma kontradiktore. Gamage dhe Boyle (2008) nënvizojnë zhvillimin e qëndrueshëm nga këndvështrimi i konsumatorëve. Përsa i përket globalizimit dhe përdorimit të madh të burimeve janë vënë re rezultate negative në ekonominë globale. Ndryshimet dhe kërcënimet konsumatore janë të lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm dhe me ‘dimensionet e mirëqenies sociale dhe mjedisore’ (Gamage & Boyle, 2008: 55). Kjo është arsyeja sepse strategjitë kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm nuk mund të krijohen në bazë të ideve, vlerave si dhe mënyra tradicionale të të menduarit. Ato kërkojnë zhvillimin e aftësive të reja shkencore, politike dhe filozofike dhe që janë të përshtatshme jo vetëm për realitetet moderne, por gjithashtu për zhvillimin e këtij mijëvjeçari të ri.

Duke përmbyllur këtë pjesë mund të përmblidhet që zhvillimi i qëndrueshëm i ka rrënjët në institucionet globale dhe kjo marrëdhënie është e rregulluar në procedura ndërkombëtare, e cila vlen edhe për rastin e Shqipërisë. Këto marrëveshje janë të përkthyer në ligje ndërkombëtare si dhe janë të bazuara në institucione ndërkombëtare, të cilat janë të afta për

të zgjidhur në mënyrë formale probleme të ndryshme nëpërmjet veprimit të një sërë aktorësh ndërkombëtarë. Sidoqoftë në nivel global çështja që mbetet akoma për të zgjidhur është një vendimmarrje efektive. Dimensioni i gjerë i qeverisjes globale brenda sistemit të OKB-së ka ndihmuar për të ndjekur njohuritë bazë në shoqëri (Haas, 2002) dhe për të vendosur marrëveshjet e institucionalizuara për politika të zhvillimit të qëndrueshëm. Newig dhe Fritsch (2009) zbuluan që një qeverisje e tillë është një mënyrë më efektive për politika mjedisore. Kështu, në terma të përgjithshëm, zhvillimi i qëndrueshëm filloi të përkufizohej si një strategji për një zhvillim socio–natyror, e cila përfshin evolucionin e përbashkët të natyrës dhe shoqërisë, siguron mbijetesën dhe progresin e vazhdueshëm të shoqërisë dhe nuk dëmton mjedisin, veçanërisht biosferën.

4.3. Rritja ekonomike shqiptare sipas shifrave zyrtare

Faktorët përcaktues të rritjes ekonomike janë faktorë të ndërlidhur midis tyre dhe që ndikojnë në shkallën e rritjes ekonomike të një vendi të caktuar. Ekzistojnë së paku gjashtë faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë rritjen ekonomike dhe mund të grupohen në faktorë përcaktues të ofertës dhe dy prej tyre bëjnë pjesë në grupimin e efikasitetit dhe të kërkesës. Katër faktorët që bëjnë pjesë në pjesën e ofertës dhe të furnizimit janë: burimet natyrore, të mirat materiale, burimet njerëzore dhe teknologjia, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vlerën e të mirave dhe të shërbimeve të siguruara. Një rritje ekonomike që matet nga PPB do të thotë një PPB-ja është në rritje, por ajo që përcakton rritjen e çdo komponenti të PPB-së është shumë e ndryshme. Shpenzimet publike, krijimi i kapitalit, investimet publike dhe private, shkalla e punësimit, shkalla e shkëmbimit monetar etj., kanë ndikime të ndryshme në rritjen ekonomike dhe duhet që të kemi parasysh që këta faktorë kanë ndikime të ndryshme në zhvillimin e një shteti të caktuar. Ekzistojnë gjithashtu dhe faktorët socio-politikë dhe ngjarjet të cilat kanë një ndikim të madh në avancimin ekonomik të një vendi. Ka po ashtu ndryshime ndërmjet faktorëve ekonomikë dhe jo ekonomikë (Boldeanu & Constantinescu, 2015: 329). Faktorët ekonomikë i referohen faktorëve të tillë si akumulimi i kapitalit, progresi teknologjik dhe puna ndërsa burimet jo –ekonomike i referohen faktorëve të tillë si qeverisja, efikasiteti, institucionet, sistemi politik dhe administrative, faktorët kulturorë dhe social, gjeografia dhe demografia (Acemoglu, 2009).

Sidoqoftë, duke iu referuar shifrave zyrtare të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, rritja ekonomike në Shqipëri për vitin 2019 parashikohet të jetë 4 përqind, gjë e cila për Bankën Botërore përkthehet në më shumë vende pune. Në raportin e rregullt ekonomik për Ballkanit Perëndimor, i cili mban titullin “Rritje më e lartë por e brishtë”. Rritja e punësimit ndihmon në uljen e varfërisë në vend, ndërkohë që pritet të zvogëlohen edhe defiçiti fiskal dhe borxhi publik. Shkalla e rritjes për rajonin e Ballkanit Perëndimor çmohet se është fuqizuar në 3.5% për vitin 2018, sipas këtij Raporti. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia çmohet se kanë norma të rritjes nga 2.5% deri në 4%. Edhe pse punësimi është rritur në pesë nga gjashtë vendet e rajonit, 91.400 vende të reja pune të krijuara gjatë periudhës korrik 2017 – korrik 2018 janë ndjeshëm më pak se 214.000 vende të reja pune të krijuara një vit më parë. Shumica e vendeve të reja të punës janë në sektorët e industrisë dhe shërbimeve.


Rritjen ekonomike dhe të vendeve të punës, përfaqësuesit e Bankës Botërore ia atribuojnë investimeve dhe shpenzimeve publike. "Vendet me rritje të investimeve private kanë pasur edhe rritjen më të shpejtë. Megjithëse shpenzimet sociale të përgjithshme dhe pagat publike kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike në periudhën afatshkurtër, ato rrisin cënueshmërinë fiskale. Një mënyrë më e qëndrueshme për të pasur rritje ekonomike është rritja e investimeve private dhe e eksporteve" (Linda Van Gelder, 2019). Në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, borxhi publik, i cili është në nivele të larta dhe vijon të rritet, shoqërohet me mungesa ekuilibri buxhetor dhe të jashtme, çka e bën të cënueshëm parashikimin për të ardhmen për shkak të rritjes së kostove të financimit, nëse do të ketë shtrëngim në tregjet financiare. Mbështetja e rritjes ekonomike në periudhën afatgjatë kërkon pra reforma të brendshme të cilat u hapin rrugën investimeve private dhe eksporteve.

Në raport bëhet thirrje edhe për më shumë integrim ekonomik, për të nxitur një rritje më të lartë dhe të qëndrueshme dhe për të stimuluar krijimin e vendeve të punës. Për ta përsheptuar rritjen ekonomike, për ta kapërcyer problemin e tregjeve të vogla dhe të copëzuara vendase dhe për të siguruar stabilitet ekonomik afatgjatë nevojitet më shumë integrim midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, me fokusin te tregtia, investimet, lëvizshmëria dhe integrimi digjital. Perspektiva e rritjes ekonomike të Shqipërisë mbetet

pozitive. Por, pavarësisht të dhënave të mirëpritura që dëshmojnë më shumë rritje dhe krijim të vendeve të reja punës, konsolidimi fiskal, rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike dhe reformat strukturore janë shumë të rëndësishme për të siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe që sjell barazi (Banka Botërore, 2019).

Duke iu referuar një raporti tjetër të Bankës Botërore, i cili analizon shtyllat e rritjes ekonomike në vend ‘Shqipëria ka bërë hapa të mëdha përpara në zhvillim ekonomik gjatë dekadave të fundit, duke mundur që vendi të rritet në një mënyrë të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Ritmi i shpejtë i rritjes ekonomike e ndihmoi Shqipërinë të ngushtojë hendekun e të ardhurave për frymë – duke i rritur ato nga 18% të mesatares së të ardhurave të Bashkimit Europian (BE) në 1998 në 30% në 2012. Kjo rritje përgjysmoi varfërinë në vend nga 25.2% në 2002 në 12.5% në 2008. Kriza globale financiare e 2008 ndikoi konsiderueshëm rritjen ekonomike në Shqipëri dhe vendi tani po përballet me një sërë sfidash ekonomike dhe fiskale ndërsa është futur në udhën e integritit drejt BE-së (Banka Botërore, 2015).

Figura 10: Faktorët që përcaktojnë rritjen ekonomike (Acemoglu, 2009)



Kuadri i Partneritetit për Vendin (KPV) mes vendit dhe Grupit të Bankës Botërore, aprovuar së fundmi, përcakton një program që synon mbështetjen e aspiratave të Shqipërisë për rritje gjithëpërfshirëse dhe integrimin në Bashkimin Europian. E mbështetur në tri fusha

kryesore siç janë rivendosja e ekuilibrave makroekonomikë, stimulimi i rritjes së sektorit privat, dhe forcimin i menaxhimit të sektorit publik e ofrimit të shërbimeve, KPV-ja identifikon prioritetet kryesore të angazhimit për bashkëpunim gjatë pesë viteve të ardhshme.

1#: Drejt një modeli rritjeje ekonomike të qëndrueshme

Qëndrueshmëria fiskale dhe financare ka një ndikim themelor në aftësinë e Shqipërisë për të lëvizur drejt një modeli të një rritjeje ekonomike të përsheptuar dhe të qëndrueshme. Duke paguar pagesat e prapambetura ndaj sektorit publik, për shembull, hartuesit e politikave mund të rrisin flukset financiare drejt sektorit privat – faktor kyç për të rritur kërkesën brenda vendit dhe për të kontribuar drejtpërsëdrejti në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Reformat në paga dhe pensione kanë qenë faktorë kyç në uljen e varfërisë në vend. Menaxhimi më i mirë i shpenzimeve dhe rritja e efikasitetit për to mund të krijojnë mundësi për investime në shërbimet sociale – duke kontribuar kështu në rritjen e mirëqenies për të varfërit dhe 40 përqindëshit të popullsisë me nivelin më të ulët të të ardhurave.

2#: Të përmirësosh biznesin, të përmirësosh jetët

Reformat për përmirësimin e mjedisit të biznesit janë kritike për krijimin e vendeve të reja të punës dhe mund të forcojnë lidhjen mes rritjes ekonomike dhe reduktimin të varfërisë. Konkurrueshmëria, krijimi i vendeve të punës, inovacioni dhe fusha të tjera të angazhimit mund të ndihmojnë në kapërcimin e sfidave të vazhdueshme, të cilat pengojnë mjedisin e biznesit në vend. Sektori i turizmit në Shqipëri ka përjetuar një rritje të shpejtë vjetore me vizitat e turistëve gjatë viteve të fundit, por pasuritë natyrore të vendit dhe bukuria natyrore e pacënuar do të duhet të vihen në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Vendi vijon të mësojë nga rezultatet e projekteve të mëparshme për të siguruar zhvillimin e turizmit dhe nxitur rritjen ekonomike – duke konsideruar dallimet rajonale dhe nevojat e grupeve të përjashtuara.

3#: Rritje ekonomike dhe investime energjike

Vendosja e sektorit energjetik në baza të qëndrueshëm financiarisht është shumë e rëndësishme për rritjen dhe konsolidimin fiskal në Shqipëri. Sigurimi i një furnizimi të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm me energji është një nga themelet e rëndësishme për

nxitjen e investimeve, rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë. Prodhimi i energjisë varet tërësisht nga burimet ujore. Zhvillimi i potencialeve hidroenergjitike të vendit mund të shërbejë si një shtytës i fuqishëm për rritjen ekonomike për të ndihmuar rajonet e pafavorizuara që të kapërcejnë pabarazinë dhe varfërinë.

4#: Të sigurosh tokën për të ardhmen

Menaxhimi i paqëndrueshëm i tokës dhe zbatimi i dobët i të drejtave mbi pronën mbetet një pengesë kryesore për firmat, fermerët dhe familjet për të hyrë në tregun e tokës. Sigurimi i të drejtave mbi pronën, formalizimi ndërtimeve pa leje, dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës mund të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e pabarazive rajonale në Shqipëri – duke ulur varfërinë dhe rritur mirëqenien e 40% të fundit të popullsisë duke mundësuar përdorim më të sigurtë dhe produktiv të aseteve. Shqipëria ka burime të bollshme agro-pyjore – një element i përfshirjes në zhvillimin ekonomik. Vendi mbulohet me pyje e toka pjellore, por pjesa më e madhe e pyjeve dhe kullotave janë në kushte të pafavorshme.

5#: Të rrisësh mirëqeverisjen përmes rritjes së transparencës

Besimi më i madh mes qytetarëve dhe qeverisë në Shqipëri mund të krijohet përmes ndryshimit të ndërveprimit të qytetarëve me qeverinë. Grupi i Bankës Botërore mbetet i angazhuar që të ndihmojë Shqipërinë për të forcuar dhe përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe rritjen e aksesit për shërbimet bazë për të gjithë popullsinë në vend. Përmirësimet në cilësinë e ofrimit të shërbimeve për mbrojtjen sociale, shëndetësinë dhe furnizimin me ujë për 40% e fundit të popullsisë, atyre që jetojnë në rajonet më të varfëra në vend dhe komunitetet në nevojë – përfshirë popullsinë rome – mbeten fushat kryesore të angazhimit për Grupin e Bankës Botërore (Banka Botërore, 2015).

Për OECD-në Shqipëria është një vend me të ardhura ekonomike mbi mesataren, ku të ardhurat për frymë të një popullsie prej 2.87 milionë banorësh janë 4537 \$ (duke iu referuar çmimeve të 2017), vendi i dytë me të ardhura më të ulta në Ballkanin Perëndimor. Megjithëse ekonomia është e udhëhequr nga sektori i shërbimeve, industria dhe bujqësia vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm. Në vitin 2017, sektori i shërbimeve kontribuonte 47.3% të vlerës totale të shtuar, duke u ndjekur nga industria me 21.1% dhe bujqësia me 19%. Sidoqoftë bujqësia punëson 40.3% të popullatës, pavarësisht se kontributi i bujqësisë

në ekonomi është i vogël, dhe pak më pak se sektori i shërbimeve i cili punëson 41.1% të popullsisë. Pjesa që zë industria në punësimin e përgjithshëm është 18.6% (OECD, 2019).

Grafik 1: Rritja reale e PPB-së sipas përqindjeve vjetore (burimi FMN)



©IMF, 2019, Source: World Economic Outlook (April 2019)

Tabela 2: Rritja e PBB-s në përqindje (Burimi: INSTAT)

Viti	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Rritja vjetore reale PBB (në përqindje)	2.55	1.42	1	1.77	2.22	3.31	3.82

4.4. Dritëhijet e zhvillimit ekonomik

Studiues të ndryshëm vlerësojnë që shpërndarja e të ardhurave është një nga përcaktuesit kryesor të pushtetit politik *de facto* – atij pushtet që nuk mund të shpërndahet nga institucionet politike formale të tilla si kushtetuta apo agjencitë qeveritare. Ose atëherë kur pabarazitë në të ardhura janë relativisht të larta, - dhe të pasurit kanë një ndikim të shproporcionuar në institucionet politike formale (Constantine & Khmeraj, 2019: 6).

Pushteti politik *de juro* rrjedh nga institucionet politike, le të themi kushtetuta që thekson pushtetin juridik të Presidentit apo të principeve të ndarjes së pushteteve. Ashtu siç argumentojnë dhe Constantine & Khmeraj (2019) pushteti politik *de facto* ndikon institucionet e ardhshme politike. Elitat preferojnë të ushtrojnë kontroll dhe ndikim me kalimin e kohës dhe njëra mënyrë për të mbështetur politikanët e tanishëm ose të ardhshëm është vetëm duke miratuar ligje që mbështesin elitën (Constantine & Khmeraj, 2019: 9).

Në një material të posaçëm të përgatitur nga ekspertët e Bankës së Shqipërisë për “Monitor”, në lidhje me zhvillimet ekonomike të vitit 2019 dhe në periudhën afatmesme, Banka Qendrore parashikon se rritja do të vijojë të ushqehet, në masën më të madhe, nga gjallërimi i konsumit dhe investimeve në ekonomi, ndërkohë që kontribut pozitiv pritet të vijë edhe nga rritja e mëtejshme e eksporteve.

Por në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, balanca e rreziqeve qëndron e zhvendosur në kahun e poshtëm. Kjo do të thotë se probabiliteti i ngjarjeve, të cilat mund të prodhojnë shmangie të ekonomisë në kahun e poshtëm të pritjeve është më i madh se probabiliteti i ngjarjeve, të cilat mund të sjellin surpriza pozitive, pra shmangie në kahun e sipërm. Banka e Shqipërisë vë në dukje se ambienti i huaj vijon të karakterizohet nga paqartësi lidhur me kahun dhe intensitetin e zhvillimeve ekonomike. Ky tipar është veçanërisht i pranishëm në partnerët tanë kryesorë tregtarë, si Italia dhe Greqia, por edhe në vendet e Bashkimit Europian dhe të Eurozonës. Në rast reduktimi të ritmit të rritjes, forcimi të barrierave proteksioniste, apo problemeve dhe turbullirave financiare në to, ndikimi në Shqipëri do të ishte i pashmangshëm. Së dyti, me gjithë konsolidimin progresiv të burimeve të rritjes ekonomike, qëndrueshmëria e tyre nuk duhet të merret e mirëqenë.

Ekonomia shqiptare ka qenë dhe do të mbetet subjekt goditjesh, të cilat mund ta shmangin atë nga trendi i rritjes dhe të cilat mund të dëmtojnë edhe perspektivën afatmesme e afatgjatë të zhvillimit. Goditje të tilla nuk mund të përjashtohen as në të ardhmen, e afërt, të mesme apo të largët. Nga ana tjetër, viti 2018 shënoi edhe disa zhvillime të rëndësishme strukturore, veçanërisht në drejtim të konsolidimit të sektorit bankar, si dhe identifikoi disa sfida dhe oportunitete shtesë për zhvillimin e vendit në horizontin kohor afatmesëm e afatgjatë (Revista Monitor, 2019). Fakti që ekonomia shqiptare po zgjerohet, rritja ekonomike e cila arriti në 3.8% në vitin 2017, më së shumti reflekton rritjet në kapitalin e

investimeve, por gjithashtu tregon dhe rritjen e konsumit. ‘Konsumi privat ka arritur majat falë krijimit të shpejtë të punëve, rritjes së rrogave dhe rritjes së kredi dhëniës për kryefamiljarët. Investimet në kapital janë në momentin e tyre më të mirë për shkak të dy projekteve të mëdha energjetike, Hidrocentrali i Devollit dhe Projekti i Gazsjellësit TAP’ (OECD, 2019).

Sipas Bankës të Shqipërisë shanset dhe sfidat e zhvillimit me të cilat përballet vendi janë të shumta.

- ✚ Së pari, ambienti i huaj vijon të karakterizohet nga paqartësi lidhur me kahun dhe intensitetin e zhvillimeve ekonomike. Ky tipar është veçanërisht i pranishëm në partnerët tanë kryesorë tregtarë, si Italia dhe Greqia, por edhe në vendet e Bashkimit European dhe të Eurozonës. Në rast reduktimi të ritmit të rritjes, forcimi të barrierave proteksioniste, apo problemeve dhe turbullirave financiare në to, ndikimi në Shqipëri do të ishte i pashmangshëm.
- ✚ Së dyti, me të gjithë konsolidimin progresiv të burimeve të rritjes ekonomike, qëndrueshmëria e tyre nuk duhet të merret e mirëqenë. Ekonomia shqiptare ka qenë dhe do të mbetet subjekt goditjesh, të cilat mund ta shmangin atë nga trendi i rritjes dhe të cilat mund të dëmtojnë edhe perspektivën afatmesme e afatgjatë të zhvillimit. Goditje të tilla nuk mund të përjashtohen as në të ardhmen, e afërt, të mesme apo të largët. Detyra e politikëbërësve është që të kujdesen për uljen e probabilitetit të këtyre goditjeve dhe rritjen e rezistencës së ekonomisë tonë ndaj tyre.
- ✚ Së treti, në një kontekst afatmesëm dhe afatgjatë, përshpejtimi i ritmit të rritjes ekonomike dhe i shpejtësisë së konvergimit të mirëqenies së shqiptarëve me atë të vendeve të Bashkimit European do të kërkojë rritjen e mëtejshme të produktivitetit, si dhe zgjerimin e tregjeve dhe të konkurrueshmërisë së produkteve tona. Kjo detyrë bëhet më komplekse nëse mbajmë parasysh dy trende të zhvillimit ekonomik botëror dhe rajonal:
 - 1) Shtërngimin e kushteve të financimit për vendet në zhvillim, si në kontekstin european, ashtu dhe në atë botëror. Ky shtërngim, pasojat e të cilit kanë qenë dhe janë të pranishme në ekonominë shqiptare, imponojnë zhvillimin e segmenteve

të reja të tregjeve financiare dhe një disiplinë më të madhe në përdorimin e fondeve.

- 2) Rritje e konkurrencës rajonale për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, si një nga instrumentet më efektive për nxitjen dhe përsheptimin e zhvillimit ekonomik. Adresimi i sfidave afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit realizohet vetëm nëpërmjet zbatimit dhe përsheptimit të reformave strukturore në vend. Këto reforma duhet të bazohen në një vizion të qëndrueshëm afatgjatë zhvillimi, ndërsa hartimi dhe zbatimi i tyre duhet të tërheqë ekspertizën më të mirë ndërkombëtare, si dhe të mbajë parasysh burimet e kufizuara financiare të vendit.

✚ Së fundi, vizioni afatgjatë i zhvillimit dhe lista e reformave prioritare duhet të bazohen në një konsensus sa më të gjerë politik e social, çka do të garantonte qëndrueshmërinë, do të ndihmonte koherencën e brendshme dhe do të rriste konsistencën e tyre në kohë (Revista Monitor, 2019).

Në vizionin e Bankës së Shqipërisë, detyra e përcaktimit të prioriteteve dhe e shpërndarjes së fondeve, në një ekonomi të tregut të lirë, ka qenë dhe duhet të jetë prerogativë kryesore e sektorit privat. Nga ana tjetër, detyra e politikëbërësve është të garantojnë në mënyrë prioritare stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit, të përcaktojnë dhe të kujdesen për zbatimin e rregullave të lojës, si dhe të adresojnë mangësitë e infrastrukturës së zhvillimit.

Në afat të gjatë, ndjekja dhe përmbushja e këtyre objektivave nga sektori publik jo vetëm që nuk krijon konflikte, por dhe përforcon efektin e njëri-tjetrit. Në afat të shkurtër, për arsye të burimeve të kufizuara financiare, ndjekja dhe zbatimi i këtyre objektivave të zhvillimit ka dhe do të ketë gjithnjë konflikt. Për këtë arsye, reforma strukturore duhet të jetë gjithnjë e studiuar dhe e bazuar në një analizë sistematike të kostove dhe përfitimeve të alternativave të saj. Ajo që Banka e Shqipërisë ka kërkuar dhe kërkon në vazhdimësi është garantimi me prioritet i qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare të vendit.

Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, ngjarja madhore e vitit 2019 do të jetë – padyshim – çelja e pritur e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian. Shqipëria duhet të kujdeset që të mos ta humbë këtë datë, për asnjë arsye të brendshme. Ndërkohë, paralelisht me të, autoritetet publike duhet të vazhdojnë t'i kushtojnë rëndësi dhe vëmendje procesit të

konsolidimit fiskal, zhvillimit të mëtejshëm të reformës dhe ristrukturimit të sistemit financiar, si dhe monitorimit e shfrytëzimit të oportuniteteve, që shfaqen në mjedisin e brendshëm e të jashtëm (Revista Monitor, 2019). Kjo rritje do të vijojë të ushqehet, në masën më të madhe, nga gjallërimi i konsumit dhe investimeve në ekonomi, ndërkohë që kontribut pozitiv pritet të vijë edhe nga rritja e mëtejshme e eksporteve. Faktorët mbështetës të saj do të jenë të njëjtë me ata të vitit të shkuar: një ambient i brendshëm financiar i përshtatshëm, një fuqi blerëse në rritje e familjeve, si pasojë e rritjes së punësimit e pagave, si dhe një ekonomi e huaj përgjithësisht e stabilizuar apo në përmirësim.

Po ashtu, sipas Bankës së Shqipërisë, kontributi pozitiv që solli prodhimi i energjisë elektrike në rritjen e vitit 2018 do të vijë në zbehje vitin e ardhshëm. Vijimi i rritjes ekonomike dhe konvergimi gradual i ekonomisë drejt potencialit do të ndihmojnë përmirësimin e mëtejshëm të ekuilibrave të brendshëm dhe të jashtëm të vendit. Megjithatë, sikundër është theksuar vazhdimisht nga BSH, balanca e rreziqeve rreth këtij skenari të pritur zhvillimesh qëndron e zhvendosur në kahun e poshtëm. Kjo do të thotë se probabiliteti i ngjarjeve, të cilat mund të prodhojnë shmangie të ekonomisë në kahun e poshtëm të pritjeve është më i madh se probabiliteti i ngjarjeve të cilat mund të sjellin surpriza pozitive, pra shmangie në kahun e sipërm (Revista Monitor, 2019).

Politikat ekonomike dhe infrastruktura ligjore, ekonomike dhe sociale e zhvillimit, duhet të garantojnë ambient të përshtatshëm për një rritje sa më të shpejtë dhe sa më të qëndrueshme ekonomike. Në minimumin e vet, ky ambient duhet të garantojë stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit, si dhe duhet të ofrojë: një mjedis ligjor, i cili garanton respektimin e kontratave dhe mbështet e inkurajon konkurrencën e ndershme; një mjedis fiskal, i cili inkurajon investimet afatgjata; një sistem financiar, i cili mundëson ndërmjetësimin eficient të kursimeve në investime; një kuadër marrëveshjesh ekonomike dhe tregtare, të cilat inkurajojnë eksportet shqiptare dhe investimet e huaja në Shqipëri; një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të shëndetshme; si dhe, një infrastrukturë të zhvilluar dhe të integruar me vendet partnere. Sidoqoftë, sipas OECD-së, rritja pritet që të zvogëlohet, duke filluar nga fundi i vitit 2020, me përfundimin e dy projekteve të mëdha të energjisë. Defiçiti aktual mbetet në 7.5% të PPB-së, megjithëse ka rënë nga 10.8% që ishte në vitin 2014. Eksportet

neto janë ritur me 31.5% të PPB-së në vitin 2017; ndërsa importet kanë rënë në mënyrë të lehtë megjithëse mbeten të larta në 46.6% të PPB-së. Eksportet neto janë projektuar për tu rritur me një hap solid për shkak të kërkesës në rritje të mallrave nga tregu i BE-së, por kontributi i tyre në rritjen e PPB-së pritet që të sfumohet nga rritja në importe (OECD, 2019).

4.5. Ndikimi i ekonomisë informale dhe korrupsionit

Ekzistojnë studime të ndryshme në lidhje me ndikimin e ekonomisë informale dhe korrupsionit në zhvillimin ekonomik të vendit e sidomos në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe të tregut të punësimit. Një studim i tillë është edhe ai i Shera et al. (2014) i cili është kryer në 22 vende në zhvillim, të tilla si ish vendet socialiste në Ballkan, Europën Qendrore dhe Lindore dhe në Azi ,dhe i cili ka studiuar ndikimin e korrupsionit në rritjen ekonomike. Rezultatet e studimit të tyre kanë treguar që korrupsioni ka pasur një ndikim statistikor dhe negativ në rritjen ekonomike të këtyre vendeve (Boldeanu & Constantinescu, 2015: 334). Sidoqoftë, përkufizimi i korrupsionit nuk është i lehtë. Në thelb, nëse një person përdor zyrën e saj/ tij publike për përfitime private, do të mund të konsiderohej si një akt korrupsioni.

Përkufizimi i gjerë dhe i pranuar i korrupsionit është dhënë nga UNDP në vitin 1999 dhe i cili i referohej ‘shpërdorimit të pushtetit publik, pushtetit të dhënë nga posti ose autoritetit për të përfituar në mënyrë private- me anë të mitmarrjes, zhvatjes, ndikimit në përzgjedhje, nepotizmit, shkeljeve në detyrë, ndërmjet parave të shpejta dhe përvetësimit’ (UNDP, 1999). ‘Në fakt korrupsioni ka qenë i përhapur në vendet Perëndimore, përpara industrializmit të plotë që solli përmirësime thelbësore në standartin e jetesës të njerëzve. Korrupsioni u zhduk në vendet e zhvilluara të Perëndimit pas rritjes së të ardhurave dhe standartit të jetesës. Shumë studiues kanë argumentuar që korrupsioni nuk mund të zhduket me anë të legjislacionit apo të qëndresës politike. Një ndikim i drejtëpërdrejtë i korrupsionit është fakti që është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me krimin dhe me korrupsionin e sistemit gjyqësor’ (Ghosh & Siddique, 2015).

Në indeksin e korrupsionit për vitin 2018 të *Transparency International*, Shqipëria ishte e renditur në vendin e 99 nga 180 vende (Transparency International, 2019). Në përgjithësi studimet e kësaj organizate për Shqipërinë vlerësojnë se ‘institucionet kyçe në luftën kundër korrupsionit si zyra e Prokurorisë, Gjykata e Lartë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit janë subjekte të trysnisë dhe ndërhyrjeve politike, duke minuar aftësinë e tyre për të përmbushur detyrën e ndalimit të korrupsionit. Kuadri ligjor i Shqipërisë nuk garanton pavarësinë e këtyre institucioneve të rëndësishme nga pushteti politik, pavarësisht se reformat e fundit janë hartuar në përputhje me kërkesat e BE-së për hapjen e negociatave për anëtarësim (Transparency International, 2016). Korrupsioni mbi të gjitha ndikon menjëherë në hapjen e bizneseve të reja, ecurinë e atyre ekzistuese si dhe investimet e huaja direkte. Shkalla e lartë e korrupsionit ndikon në konkurrencën e pandershme dhe si pasojë sjell mbylljen e bizneseve apo largimin e investitorëve të huaj. Për pasojë do të ketë dhe një rënie të të ardhurave dhe një papunësi të shtuar në vend, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë te zhvillimi i qëndrueshëm i një vendi.

Si në shumë vende të tjera post-socialiste, korrupsioni përbën një nga sfidat më të mëdha për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare në tërësinë e saj. Korrupsioni ishte i pranishëm gjatë regjimit socialist dhe në njëfarë mënyre ka vazhduar dhe gjatë tranzicionit post-socialist, me mitmarrje, klientelizëm dhe favorizim si praktika të zakonshme (Zhllima et al., 2018: 51). Megjithatë këto praktika kanë qenë të paligjshme dhe të papranueshme nga ana shoqërore në të dy sistemet, ato kanë vazhduar dhe të formësohen sëbashku me transformimet sociale si të shkëmbimeve monetare dhe atyre që nuk kishin lidhje me paranë. Studimet që merren me vlerësimin e perceptimit të korrupsionit në Shqipëri tregojnë për mbizotërimin e tij: është i shprehur në një llojshmëri formash dhe në sfera të ndryshme dhe në nivele të shumëfishta (qendrore dhe lokale) të parashikimit të shërbimeve si dhe të veprimeve të zyrtarëve të degëve ligjvënëse, gjyqësore dhe ekzekutive (Zhllima et al., 2018: 51). Sipas Transparency International ‘pavarësisht një betimi paanësie, ndikimet politike kanë qenë të dukshme në vitet e fundit. Mbrojtja e anëtarëve të KQZ-së është e dobët dhe partitë kanë në dorë ndryshimin e përbërjes së komisioneve të niveleve më të

ulëta – madje edhe ditën e zgjedhjeve. Partitë politike rezultojnë të kenë nivelin më të ulët të integritetit, krahasuar me të gjithë aktorët dhe institucionet e vlerësuara-ato nuk janë të detyruara të raportojnë fondet dhe shpenzimet gjatë fushatave elektorale, ç’ka nënkupton se votuesit nuk e dinë se kush po mbështet secilin prej kandidatëve, përpara se të bëjnë zgjedhjen e tyre. [...] Shqipëria ka një ndër nivelet më të larta të korrupsionit të perceptuar në të gjithë rajonin. Shqiptarët janë të zhgënjyer nga sistemi politik dhe janë të lodhur teksa shohin të korruptuarit që përdorin paratë dhe influencën për t’i shpëtuar ndëshkimit’ (Transparency International, 2016).

Në shumë shoqëri post-socialiste, praktika e të ofruarit të pagesave informale për shërbimet publike që supozohet që të sigurohen pa kryer ndonjë pagesë, është justifikuar me faktin që zyrtarët publikë kishin paga të ulëta. Studiues të tjerë kanë ndërmarrë studime dhe përjasje analitike më teorike dhe sistemike në lidhje me këtë çështje duke e studuar atë në kontekstin e arsimit të lartë dhe në strukturat e centralizuara të trashëguara nga e kaluara. Studimet e fundit studiojnë gjithashtu dhe rolin e elitave që përpiqen të kontrollojnë arsimin e lartë (Zhllima et al., 2018: 53). Korrupsioni në të gjitha nivelet e qeverisjes – në ekzekutiv, legjislativ dhe në gjyqësor – është tani i vështirë për tu përhapur në vendet e zhvilluara, megjithëse disa zyrtarë publikë akoma nxirren përpara drejtësisë për veprimet e tyre korruptuese. Por në vendet në zhvillim korrupsioni ekziston në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe ndonjëherë është e vështirë që të mbarohet ndonjë punë e thjeshtë, e tillë si marrja e një license për një aktivitet, pa ofruar rryshfet, në para ose në sende materiale, për zyrtarët publikë (Ghosh & Siddique, 2015: 11).

E njëjta gjë ndodh në sistemin arsimor, i cili përgatit dhe punonjësit e ardhshëm që do të kalojnë në tregun e punës. Studime të ndryshme kanë treguar për një korrupsion të lartë të institucioneve publike të arsimit të lartë. ‘Fitimi financiar dhe patronazhi politik u kthyen në mediume të shkëmbimit të përfitimeve në marrëdhëniet sociale gjatë periudhës post-socialiste... [...] për më tepër, ndryshimet strukturore të ndërmarra në sistemin arsimor gjatë periudhës socialiste dhe post-socialiste shkaktuan një përhapje të madhe të regjistrimeve në shkolla të mesme dhe në universitet, gjë që solli reduktimin e cilësisë së studentëve dhe të cilësisë së mësimdhënies. Kjo nga ana tjetër shërbeu edhe si një mundësi për lindjen dhe

zhvillimin akoma më shumë të praktikave korruptive. Kështu, në këtë mënyrë, korrupsioni u bë shpesh më i sofistikuar në natyrën e tij; mitmarrja dhe favorizimi u kamufluan në shitjen e detyrueshme të librave dhe në kurset private të profesorëve’ (Zhllima et al., 2018: 60).

Nga ana tjetër, interesi publik dhe akademik për të reduktuar korrupsionin tregojnë problemin e zbatimit të disa lloj legjislacioneve në këto vende. Në rastet ku institucionet politike janë vënë në zbatim në mënyrë të papërshtatshme, elitat e kanë më të lehtë të ndikojnë politikat e tanishme dhe të ardhshme. Një mënyrë efikase për të mbrojtur bazat e pozicionit të tyre ekonomik – është mbrojtja e strukturës aktuale ekonomike. Është studiuar që elitat ndikojnë pushtetin politik de jure për të zbatuar institucionet ekonomike që rirforcojnë strukturën ekonomike (Constantine & Khmeraj, 2019: 9). Përsa i përket rastit të Shqipërisë, korrupsioni në sistemin arsimor që më pas reflektohet në tregun e punës mund të zhduket me anë të një reforme të gjithanshme si dhe zhvillimi ekonomik të madh, i cili të ndikojë në rritjen e të ardhurave të individëve. Përveç plotësimit dhe zbatimit të reformës në drejtësi, Transparency International jep rekomandimet kryesore të mëposhtme për çrrënjosjen e korrupsionit në Shqipëri dhe për të garantuar funksionimin pa ndërhyrje politike të institucioneve mbikëqyrëse.

- ✚ Komisioni Parlamentar *ad-hoc* për reformën elektorale duhet të marrë funksion të plotë. Pavarësia e administratës zgjedhore duhet të jetë fokusi kryesor i tij.
- ✚ Parlamenti duhet urgjentisht të ngrejë një komision *ad-hoc* të asistuar nga një sekretariat teknik për të kryer reformën e konfliktit të interesit dhe rregulloret mbi lobimin. Ky komision duhet të ketë mandat për të propozuar ndryshime që lehtësojnë kuadrin ligjor, forcojnë pavarësinë e institucioneve kyçe dhe e bëjnë të mundshëm zbatimin në praktikë.
- ✚ Partitë politike duhet të zbatojnë standarde më të larta kur zgjedhin kandidatët elektorale dhe funksionarët publikë, në mënyrë që të garantojnë profesionalizmin dhe nivele më të larta të integritetit në sektorët publikë (Transparency International, 2016).

Tabela 3: Treguesit makro-ekonomikë 2018 (AIDA)

PBB Nominal (2018, MFE, në miliard Lek)	1,647.6ⁱ
PBB për frymë (në EUR)	4,494ⁱⁱ
Rritja nominale e PBB-së 2018 (në %)	6.1
Rritja reale e PBB-së 2018 (në %)	4.2
Inflacioni mesatar vjetor 2018	2.0
Inflacioni fund viti 2018	1.8
Norma e papunësisë Q4 2018 (në %)	12.3
Rritja e eksporteve (2018/2017, në %)	13.7
Eksportet (në % të PBB-së)	18.81
Rritja e importeve (2018/2017, në %)	2.4
Importet (në % të PBB-së)	38.87
Fluksi neto i investimeve të huaja direkte (2018, në mil EUR)	1,021

4.6. PPP-të dhe investimet e huaja

Studime të ndryshme empirike kanë treguar që shkalla e rritjes ekonomike të një vendi përcaktohet dhe nga rritja ekonomike e investimeve të huaja dhe të raportit të të ardhurave midis importeve dhe eksporteve. Vendet që kanë teknologji prodhimi më të kufizuara kanë më shumë kërkesa për mallra importi (Constantine & Khmeraj, 2019: 4), ndërkohë që eksportojnë më shumë krah pune dhe ikje të trurit apo të studentëve dhe specialistëve më të shkolluar, duke i hequr mundësinë dhe këtyre vendeve për inovacion. Nga njëra anë, Shqipëria ka qenë gjithmonë e hapur për investime të huaja direkte dhe ka pasur gjithmonë politika lehtësuese ndaj bizneseve të huaja. Në kohën e sotshme, ‘regjimi i investimeve të huaja direkte në Shqipëri ka më pak kufizime se cdo mesatare tjetër në vendet e OECD-së apo të BE-së. Sidoqoftë është më pak e hapur ndaj investimeve të huaja se çdo ekonomi tjetër e Ballkanit Perëndimor (OECD, 2016). Për të ulur më tej kufizimet për Investimet e Huaja Direkte (IHD), qeveria shqiptare planifikon që të adaptojë një ligj të ri për investimet të programuar në fund të vitit 2018, por aktualisht projekt-ligji është paraqitur në parlament për shqyrtim në maj 2019. Ligji i ri, ndërmjet të tjerash do të garantojë që qeveria nuk do të shpronësojë investimet e huaja dhe të brendshme, përveçse në rastet kur ky veprim është

veprimi i fundit që duhet ndërmarrë dhe në akordancë me principet e të drejtës ndërkombëtare. Ky ligj pritet që të rrisë besimin e investitorëve duke krijuar mekanizmat për trajtimin e ankesave të investitorëve të cilat do të menaxhohet nga Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) (OECD, 2019: 465). Gjithashtu ligji do të përcaktojë dhe sektorët strategjikë. Sektorët strategjikë në përputhje dhe në zbatim të këtij ligji janë:

- ✚ sektori energjetik dhe mineral;
- ✚ sektori i transportit, i infrastrukturës, i komunikimeve elektronike dhe i mbeturinave urbane;
- ✚ sektori i turizmit (strukturat turistike);
- ✚ sektori i bujqësisë (fermat e mëdha bujqësore) dhe i peshkimit;
- ✚ sektori i zonës ekonomike dhe zonat me prioritet zhvillimi.

Sipas këtij ligji, për zhvillimin dhe realizimin e projekteve të investimeve strategjike vihen në dispozicion troje, pyje, tokë bujqësore, si dhe pasuri të tjera të paluajtshme në pronësi të Shtetit shqiptar. Në funksion të mbështetjes shtetërore për realizimin e investimit, krijohet Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (Kondi, 2019).

4.7. Mundësimi i një rritje ekonomike të qëndrueshme sipas praktikës shqiptare

‘Në vitet e fundit, ekonomia e Shqipërisë ka pasur një zhvillim të pakontestueshëm, ekonomia ka pasur ritme shumë të larta zhvillimi. Kostoja shumë e ulët e forcës punëtore, taksa të ulëta dhe pozicioni shumë i mirë gjeografik e bëri Shqipërinë një vend shumë tërheqës për të huajt, ku IHD kaluan vlerën e një miliard dollarëve në vitin 2010. Por kjo rritje mbas 2010-s filloi të venitet çdo ditë e më tepër. Përpara se të ndalemi në këtë venitje, le të vërejmë pak bilancin tregtar të Shqipërisë. Ne një vështrim të shpejtë, dallojmë që raportet tregtare të Shqipërisë me Italinë kapin vlerën e një miliard eurove, me një bilanc shumë pozitiv për Italinë (pasi importon më tepër Shqipëria), e cila është edhe partneri i parë tregtar i Shqipërisë, me një kuotë rreth 34% të gjithë biznesit të jashtëm të Shqipërisë (Qiqi, 2012).

Duke marrë në konsideratë shkëmbimin tregtar të Shqipërisë me vendet e Bashkimit European, vëmë re që përqindja e eksportimit drejt Italisë ishte e barabartë me 77,94%, ndërsa importi ishte i barabartë me 43,76%. Partnerët kryesorë si për sa i përket importit, po

ashtu edhe eksportit, janë dy shtetet fqinje Italia dhe Greqia. Të dyja këto vende janë në prag default-i, ekonomia e tyre po zhytet gjithmonë e më tepër në reëension ekonomik. Vlerësime zyrtare tregojnë se pas vitit 1990 rreth 1/5 e popullsisë aktuale shqiptare ose rreth 0,75 milionë individë jetojnë jashtë saj si emigrantë. Ndërkohë, vlerësime të tjera e llogarisin numrin e emigrantëve nga 0.8 në deri 1 milion. Pavarësisht se cila shifër i afrohet më shumë realitetit, një fluks kaq i lartë emigracioni e rendit Shqipërinë si një ndër vendet me nivel më të lartë migrator, ku pjesa më e madhe e këtyre emigrantëve jetojnë pikërisht në Greqi dhe Itali (Qiqi, 2012).

Nga ana tjetër qëllimi kryesor i Shqipërisë është anëtarësimi në BE, i cili ka politika shumë të rëndësishme ndaj zhvillimit të qëndrueshëm. Politikat e BE-së për mjedisin kanë si qëllim që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen mbi integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin ndotësi paguan, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim dhe ndarjen e përgjegjësi. Legjislacioni mjedisor përfshin mbi 200 akte ligjore kryesore, të cilat mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, organizmat e modifikuara gjenetikisht, kimikatet, zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme, por sjell edhe përfitime të rëndësishme. Një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal është e domosdoshme për aplikimin dhe zbatimin e *acquis*.

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat kryesorë të Shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit siguron bazat për akte ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, etj. Megjithëse përafrimi me *acquis* ka përparuar, përsëri nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një përafrim të plotë me *acquis* mjedisor të BE-së. Në këtë kuadër, si dhe me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë

të BE-së deri ne vitin 2020, Shqipëria po punon për draftimin dhe amendimin e disa ligjeve kryesore, si dhe hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e mjedisit dhe atë te ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, progres ka pasur edhe për sa i përket kuadrit institucional dhe administrativ. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të vitit 2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është riorganizuar ku përveç ndryshimit te emrit ne Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe shtimit te përgjegjëseve, është rritur edhe numri i punonjësve, nga 42 ne 62 punonjës. Ne varësi te AKM-se kanë kaluar edhe 12 Drejtoritë Rajonale te Mjedisit, të cilat do të operojnë dhe koordinojnë punën dhe funksionet e tyre me ato te AKM-së, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar. Në Janar 2014, është krijuar Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, i cili është një institucion publik nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit, që do të garantojë zbatimin dhe imponimin e ligjit në fushën e mjedisit, pyjeve dhe ujërave. Me qëllim përmirësimit e zbatimit të ligjit, Inspektorati i Mjedisit ka rritur ndjeshëm numrin e kontrolleve në zonat industriale, ku në kryerjen e kësaj detyre ka bashkëpunuar ngushtë me inspektoratet dhe institucionet e tjera shtetërore. Kjo gjë do të ketë efektet e veta dhe në kushtet e punësimit të punonjësve.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë një sërë masash administrative për sa i përket shkeljeve të kushteve të lejes mjedisore, si dhe detyrimeve të tjera që lindin nga legjislacioni mjedisor. Gjithashtu, me qëllim ndalimin aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura, janë ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm siç janë (i) miratimi i akteve ligjore që ndalojnë gjuetinë apo transportin e qymyrit të drurit, (ii) nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme “Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pyjeve”, i cili krijon Task Forcën mbi Pyjet, (iii) rritja e numrit të kontrolleve nga ana e Policisë Pyjore, (iv) vendosja e masave administrative për të gjithë shkelësit e legjislacionit mjedisor, etj. Me Urdhër të Kryeministrit në Shkurt 2014, janë krijuar 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor.

Disa vendime të Qeverisë kanë përmirësuar ndjeshëm partneritetin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile. Miratimi i VKM “Për miratimin e rregullave, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", rritja e numrit të stafit

AKM-së i përfshirë drejtpërdrejt në shqyrtimin e aplikacioneve për lejet mjedisore, kryerja rregullisht e konsultimeve me publikun për planet e mjedisit, programet dhe legjislacionin, organizimi takimeve të rregullta me OJQ-të mjedisore, si dhe shpërndarja e Buletineve Mjedisore Javorë dhe Mujorë, kanë përmirësuar ndjeshëm situatën lidhur me ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrjen mjedisore, si dhe aksesin e publikut për informacion mjedisor. Me organizimin e ri të AKM-së dhe në përputhje të plotë me detyrat dhe përgjegjësitë e saj, vëmendje e veçantë i është dhënë forcimit të Laboratorit të AKM-së. Laboratori është zhvendosur në një vend të ri, plotësisht të rinovuar dhe në përputhje me standardet e kërkuara ISO 170 25 të manualit të cilësisë. Numri i stacioneve të monitorimit të ajrit është rritur në 6 stacione për vitin 2014. Të dhënat e monitorimit do të japin një pasqyrë të plotë të cilësisë së ajrit në të gjithë vendin, duke përfshirë Tiranën. Buxheti i monitorimit për vitin 2014 është dyfishuar në krahasim me vitin 2013.

Përveç rinovimit të ndërtesës së Laboratorit të AKM-së është realizuar edhe blerja e pajisjeve teknike për analizimin dhe monitorimin e parametrave themelor të cilësisë së ujit. Për më tepër, për vitin 2014 është përfshirë edhe monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor, lumenjve, liqeneve dhe ujërave bregdetar, si dhe përcaktimi i metaleve të rënda në lumenj. Për vitin 2014 Shqipëria ka 33 stacione monitorimi në lumenj, 7 stacione në liqene dhe 8 në pjesët bregdetare. Gjatë vitit 2013 Shqipëria kishte vetëm gjysmën e numrit të përgjithshëm të këtyre stacioneve.

Fushat kryesore që përfshijn rishikimi i legjislacionit mjedisor shqiptar sipas legjislacionit evropian (Burimi: Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014):

1. Legjislacioni Horizontal;
2. Cilësia e Ajrit dhe Ndryshimet Klimatike;
3. Menaxhimi i Mbetjeve;
4. Cilësia e Ujërave;
5. Mbrojtja e Natyrës;
6. Kontrolli i Ndotjes Industriale dhe Menaxhimi i Riskut;
7. Organizmat e Modifikuara Gjenetikisht;
8. Kimikatet;

9. Zhurmat;
10. Pyjet.

Gjithashtu, duke filluar nga viti 2015, të gjitha vendet kandidate për në BE si dhe kandidatet potenciale janë të detyruara që të përgatisin Programet e Reformës Ekonomike (PRE). PRE i përgatit kandidatet e ardhshme të zgjerimit për anëtarësimin e tyre dhe pjesëmarrjen e ardhshme në procedurat koordinuese të politikës ekonomike të BE-së. Ato gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin e planifikimit të politikave ekonomike dhe reformave të tjera shqyrtuese dhe që mbështesin stabilitetin makroekonomik, nxisin konkurrencën dhe përmirësojnë kushtet për rritjen përfshirëse dhe krijimin e punësimit (KE, 2018).

PRE përmban projeksione afatmesme të indikatorëve makroekonomikë (duke përfshirë dhe PPB-në, balancën tregtare dhe flukset e kapitalit), planet buxhetore për tre vitet e ardhshme dhe një axhendë të reformës strukturore. Axhenda e reformës strukturore përfshin reformat për të nxitur konkurrencën dhe për të përmirësuar kushtet për rritje sa më përfshirëse dhe për krijimin e punëve në fushat e mëposhtme:

1. Financat publike;
2. Energjinë dhe tregjet e transportit;
3. Zhvillimin sektorial;
4. Mjedisin e biznesit dhe reduktimin e ekonomisë informale;
5. Reformat që kanë të bëjnë me tregtinë;
6. Arsimin dhe aftësitë për punë;
7. Punësimin dhe tregjet e punës;
8. Përfshirjen sociale, reduktimin e varfërisë dhe mundësitë e barabarta.

Është Komisioni European dhe Banka Qendrore Europiane ato që vlerësojnë këto shtatë programe. Këto formojnë dhe bazat për dialogun e politikës ekonomike të shumëanshëm duke përfshirë vendet që i përkasin procesit të zgjerimit, vendet anëtare të BE-së, Komisionin dhe Bankën Qendrore Europiane. Dialogu arrin në pikën e tij më të lartë me takimin e nivelit të lartë ku secili nga pjesëmarrësit adopton përfundimet e përbashkëta që ti përfshijë në çdo politikë udhëzuese specifike të secilit vend duke reflektuar dhe reformat ekonomike që nevojiten më shumë. Kështu për shembull rezultatet dhe gjetjet e studimit të

vlerësimit të VNM-ve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë sigurojnë sfondin analitik dhe udhëzimet përkatëse ndaj shtatë vendeve candidate të BE-së dhe vendeve potenciale për identifikimin e pengesave kryesore ndaj konkurrencës dhe rritjes ekonomike dhe zhvillimin e reformës strukturore për ti tejkaluar ato (KE, 2018).

4.8. Përmbledhja e kapitullit

‘Gjatë periudhës kohore 1998 - 2008 Shqipëria shënoi rritje [ekonomike] të qëndrueshme, por nga viti 2009 deri në 2013, norma e rritjes pësoi rënie mesatarisht në 2.4%, duke arritur minimumin e saj në 0.4% në vitin 2013. Ky ngadalësim në performancën ekonomike të vendit u shkaktua nga një numër faktorësh të ndryshëm. Këto faktorë lidhen kryesisht me përdorimin e tejzgjatur të instrumenteve monetare dhe fiskale për të ushqyer rritjen ekonomike, ndërkohë që nga ana tjetër u neglizhuan reformat strukturore në ekonomi. Gjithashtu, duhet theksuar dhe nuk duhet lënë pa përmendur edhe kriza globale financiare pas vitit 2008. Aktualisht, Shqipëria po përballlet me nevojën për identifikimin e burimeve të reja të cilat do të ushqejnë rritjen ekonomike dhe do të krijojnë profilin ekonomik për dekadat e ardhshme’ (ILO & SHKP, 2014). Kuptohet që e gjithë kjo do të ketë ndikimet e veta të tërthorta në kushtet aktuale të punonjësve dhe në tregun e punës në përgjithësi. Nga njëra anë pritet një përmirësim i dukshëm i kushteve bazike të punës, por nga ana tjetër do të pengojë hapjen e vendeve të reja të punës apo rritjen e pagave në sektorin privat. Kjo sepse zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm kërkon përdorimin e lëndëve të para të kushtueshme, gjë që do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e pagave të punonjësve dhe reduktimin e stafeve të punës në zonat industriale.

KAPITULLI V: ZHVILLIMI I KAPITALIT NJERËZOR DHE PUNËSIMI

Tregu i punës në Shqipëri ka pësuar disa ndryshime të mëdha gjatë dekadës së fundit, duke kontribuar në rritjen e produktivitetit. Punësimi formal jobujqësor në sektorin privat është dyfishuar në periudhën ndërmjet 1999-2013, i nxitur në një masë të madhe nga investimet e huaja. Emigrimi dhe urbanizimi kanë sjellë zhvendosje strukturore nga sektori i bujqësisë drejt industrisë dhe shërbimeve, duke i lejuar ekonomisë të fillojë ofrimin e një sërë shërbimesh, që nga sektori bankar e deri tek telekomunikacioni dhe turizmi (Banka Botërore, 2019). Pavarësisht kësaj zhvendosjeje, bujqësia mbetet një prej sektorëve më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm në Shqipëri. Ajo është burim kryesor punësimi dhe të ardhurash - veçanërisht në zonat rurale të vendit - dhe përfaqëson rreth 20 % të PBB-së, ndërkohë që përbën gjysmën e punësimit të përgjithshëm. Megjithatë, sektori i bujqësisë i Shqipërisë vijon të përballlet me një sërë sfidash, duke përfshirë këtu përmasat e vogla të fermave dhe copëzimin e tokës, infrastrukturën e dobët, kufizimet e tregut, aksesin i kufizuar tek kreditë dhe grantet si edhe institucione të papërshtatshme rurale (Banka Botërore, 2019).

5.1. Arsimimi dhe kapitali njerëzor

Marrëdhënia midis arsimit dhe kapitalit njerëzor është studiuar herët duke filluar nga Gary Becker në vitin 1964 dhe Jacob Mincer (1974). Të dy këta autorë kanë argumentuar sesi sektori i arsimit, duke rritur nivelin e aftësive të punonjësve, dhe duke prodhuar më shumë kapital njerëzor, rrit prodhimin e përgjithshëm ekonomik. Përpjekjet e para për të studiuar sektorin e arsimit dhe sesi ai kontribuon te rritja ekonomike zakonisht përfshijnë krijimin e regresionit të pagave sëbashku me arritjet arsimore në anën tjetër. Një gjë e tillë është studiuar dhe nga Eugene Kroch dhe Kriss Sjoblom në vitin 1986, por edhe nga Dale W. Jorgenson dhe Barbara Fraumeni në vitin 1992 të cilët kanë llogaritur investimet në kapitalin njerëzor duke u bazuar në të dhënat e edukimit. Të dy këta autorë e përkufizojnë kapitalin njerëzor si kategoria e dhënë e një personi, një kategori e cila mund të jetë në formën e gjinisë, moshës dhe arsimit. Individët, të cilët ju përkasin kategorive të ndryshme, kanë sasi të ndryshme të kapitalit njerëzor (Ho & Jorgenson, 2002: 292).

Përsa i përket Shqipërisë në fillim të viteve 1990-të, 94% e popullsisë aktive ishte punësuar në sektorin prodhues, ndërkohë që në shtator të vitit 1997 kjo shifër ishte vetëm 74%. Duke i hedhur një vështrim të shpejtë statistikave të punësimit, mund të vëzhgojmë që punësimi në sektorin bujqësor zë pjesën më të madhe, megjithëse i dyti pas sektorit të shërbimeve, dhe ku sektori bujqësor është gati tërësisht pronë private.


Tabela 4: Përqindja e të punësuarve në sektorin bujqësor përgjatë viteve 1990, 1997 dhe 2017

<i>Viti</i>	<i>1990</i>	<i>1997</i>	<i>2017</i>
<i>Përqindja e të punësuarve në zonat rurale</i>	63.2%	54%	40.6%

Shkalla e lartë e punësimit në sektorin bujqësor shpjegohet më së shumti nga fakti që shumica e popullsisë jeton në zonat rurale. Një tipar tjetër karakteristik i tregut shqiptar të punës është mobiliteti i lartë i forcës aktive të punës drejt zonave të mëdha urbane. Sidoqoftë, shkalla e lartë e migrimit nuk është shoqëruar nga një strategji e mirë-përcaktuar. Ka qenë thjesht një lëvizje spontane që ka rritur shumë numrin e të papunësuarve, sidomos ndër moshat e reja (Xhillari & Telhaj, 2003: 246). Turizmi për një kohë të gjatë është parë si një mjet për rigjenerimin ekonomik dhe për krijimin e punësimit (Thomas & Long, 2001: 229). Sidoqoftë Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit (www.wttc.org), llogarit që kontributi i drejtpërdrejtë i turizmit në PBB në vitin 2016 ishte 127.7 miliardë lekë ose 8.4% e PBB-së. Kontributi total vlerësohet në 393 miliardë lekë ose 26% të PBB-së. Sipas Ministrisë së Turizmit dhe të Mjedisit si dhe shifrave zyrtare të INSTAT ‘sektori i turizmit ka gjeneruar zhvillim ekonomik, punësim dhe mundësi të vetëpunësimit. Në terma të gjenerimit të punësimit, turizmi llogariti 7.7% të punësimit të përgjithshëm kombëtar në 2016 me 85.500 vende pune. Në mënyrë indirekte, turizmi përbën 23.9% të punësimit në vitin 2016 me 267.000 vende pune (Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, 2019). Megjithatë, Shqipëria vazhdon që të mbetet një vend i varur edhe nga remitancat e emigrantëve, ku duke iu referuar të dhënave të Bankës Botërore, gjatë vitit

2013 Shqipëria kishte 1 264 200 emigrantë, të cilët përbëjnë 43.6% të popullsisë së saj prej 2.9 milion banorësh. Të njëjtat burime tregojnë gjithashtu që Shqipëria ka shifra jashtëzakonisht të larta të emigracionit të individëve me arsim të lartë, ku 31.3% e të cilëve kanë vendosur të punojnë jashtë Shqipërisë. Nga perspektiva e zhvillimit, humbja e këtyre personave shumë të arsimuar përbën një 'rrjedhje të trurit', e cila ka ndikime të menjëhershme në cilësinë e kapitalit të kualifikuar njerëzor (Gëdeshi & King, 2019).

Figura 11: Tiparet kryesore të punësimit në Shqipëri (ILO & SHKP, 2014)



Dija dhe aftësitë fitohen me anë të programeve të arsimimit, të cilat duhet që të njihen si një burim zhvillimi dhe të avantazhit konkurues në një vend të caktuar. Në këtë mënyrë sistemi i arsimimit është i rëndësishëm për një ekonomi të dhënë dhe duhet supervizuar, adaptuar dhe zhvilluar nga qeverisja. Studimet e fundit nga OECD tregojnë që një forcë pune e arsimuar do të jetë e rëndësishme për të tërhequr investimet e huaja direkte. Një forcë pune

e edukuar dhe aplikimi i teknologjive të reja sjellin një produktivitet në rritje. Sipas të dhënave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), një vit arsimimi më shumë se mesatarja në një vend mund të rrisë produktivitetin e punës nga 5 deri në 15%. Produktiviteti në rritje mund të kontribuojë në tërheqjen nga vendi të investitorëve të huaj. Gjetjet e këtyre studimeve janë veçanërisht të rëndësishme për vendet e vogla në tranzicion, të tilla si Shqipëria, të cilat përpiqen që të tërheqin sa më shumë investitorë të rinj të huaj (Donlagic & Kurtiç, 2016: 93).

Ideja kryesore e shumë studimeve është që pavarësisht shkallës së saj të zhvillimit, çdo vend mund të bëhet një vend i ekonomisë së dijes, por duke investuar te sistemi arsimor, duke investuar të zhvillimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të reja të cilat janë themelet apo bazat e zhvillimit të ekonomisë së dijes. Sipas një studimi, punonjësit e arsimuar apo një forcë punëtare e shkolluar gjeneron afërsisht 60% më shumë të prodhimit. Për më tepër, studimet empirike kanë treguar që ka një korrelacion pozitiv midis punëtorëve të shkolluar, një force pune të arsimuar dhe rritjes ekonomike. Studimet gjithashtu tregojnë që të diplomuarit në universitet arrijnë që të punësohen më lehtë dhe në një periudhë kohore më të shkurtër duke e krahasuar me punonjësit me nivele arsimimi të ulëta, dhe që këto përfitime reflektojnë në përgjithësi te rritja ekonomike. Një sistem arsimor efikas dhe produktiv është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së dijes.

Dija, akumulimi i dijes dhe efekti i saj në produktivitet nuk mund të ndahen nga një sistem arsimor i zhvilluar në mënyrën më të përshtatshme. Institucionet e arsimit duhet që të lejojnë një shkëmbim të dijes midis individëve, organizatave dhe kompanive me anë të një bashkëpunimi më të mirë midis botës akademike dhe biznesit (Donlagic & Kurtiç, 2016: 93). Ashtu siç ngrinte disa çështje të tilla Kuznets në vitin 1989, ndikimi i arsimimit duket më shumë për shkak të ndryshimit të kushteve të punës dhe të jetesës dhe ndryshimit gjithashtu të fazave të prodhimit, prezenca sidomos e e të mirave materiale të prodhuara në fazën e ndërmjetme, të cilat shkaktojnë më shumë probleme. ‘Nëse kërkesa e punësimit modern është të jetuarit në komunitete urbane, ose të shërbyerit si një i punësuar sesa i vetë-punësuar, a nuk duhet vlerësuar se pari ekseternalitetet pozitive dhe negative të secilës? (Kuznets, 1989: 19).

Nga ana tjetër, struktura e ekonomisë shqiptare vazhdon që të mbetet shumë e centralizuar. Vetëm 3 produkte përbënin 76% të të mirave materiale të eksportuara në vitin 2017: 1) tekstilet dhe këpucët (43.6%); 2) Mineralet, karburantet dhe elektriciteti (16.6%); dhe materialet e ndërtimit edhe metalet (15.9%). Kjo mungesë e diversitetit dhe karakterit të teknologjisë së ulët të shportës së eksportit kontribuojnë në zgjerimin e defiçitit të jashtëm, duke e lënë ekonominë të ekspozuar ndaj krizave specifike të këtyre industrive. Defiçiti i tanishëm mbulohet nga volumi i gjerë i remitançave nga shqiptarët që jetojnë jashtë – duke arritur 8.6% të PPB-së në vitin 2017. Kjo gjë ndikon dhe te llojshmëria e profesioneve në tregun e punës dhe te shkallët hierarkike të ngjitjes në karrierën personale të secilit punonjës. Ashtu siç e kam përmendur në pjesë të tjera të këtij studimi, zakonisht ekonomitë e industrializuara dallohen për një llojshmëri më të madhe profesionesh dhe për shkallë më të gjata karriere për punonjësit, gjë që tregon dhe për një specializim më të madh të tyre. Por ndërkohë, ekonomia shqiptare ndihmohet dhe nga industria e turizmit, e cila parashikohet që të jetë në një rritje ‘me një mesatare prej 7.8% në vit për tre vitet e ardhshëm’ (OECD, 2019). Turizmi shton profesionet e mundshme në tregun shqiptar të punës, por sidoqoftë shkallët hierarkike të karrierës mbeten të shkurtra dhe me shumë pak diferencime në role dhe në paga. Një shembull më të zgjeruar për këtë do të përbëjnë dhe rastet studimore që do të shtjellohen në kapitujt në vazhdim, të cilët do të jenë të bazuar në tre raste empirike brenda kompanive që operojnë në Shqipëri.


5.2. Rritja ekonomike, të ardhurat dhe ngjitja e shkallëve të karrierës

Rritja ekonomike gjeneron punësim dhe të ardhura për kryefamiljarët dhe shërben në këtë mënyrë një nga kushtet kryesore për një rritje të qëndrueshme dhe për krijimin e një punësimi të vazhdueshëm. Rritja ekonomike dhe krijimi i punësimit kontribuojnë në reduktimin e varfërisë duke rritur kërkesën për punësim, e cila shpeshherë është i vetmi aset që posedojnë të varfërit. Por shkallët e njëjta të rritjes ekonomike ndërmjet vendeve të ndryshme mund të kenë ndikime krejt të kundërta në perspektivat e punësimit dhe te qëllimet më të mëdha si ato të zhvillimit njerëzor. Numri dhe lloji i punësimit të gjeneruar nga një shkallë e dhënë e rritjes ekonomike do të varet nga karakteristikat e rritjes dhe nga lloji i punësimit që kërkohet për të mbështetur modelet e rritjes (Sen & Kirkpatrick, 2011:

135). Tregu i punës në vendet më të zhvilluara po përballlet me pabarazi të mëdha midis grupeve të kualifikimeve të ndryshme. Ndërkohë që niveli për të punësuar më të lartaka ardhur gjithnjë në rritje, kërkesa për punonjës më pak të kualifikuar ka pësuar një rënie të konsiderueshme. (Schlitte, 2012).

Një ndikim të rëndësishëm luan dhe zhvillimi teknologjik i një vendi. Rrugët e ndryshme të zhvillimit teknologjik ndikojnë dhe në mundësitë për rritje ekonomike dhe për zhvillim ekonomik. Shpesh zhvillimi teknologjik kundërshtohet edhe si një progres që shkakton edhe shumë papunësi, gjithësesi kjo mbetet e paprovuar dhe ekzistojnë teza të ndryshme në lidhje me këtë. Sidoqoftë në lidhje me firmat apo ndërmarrjet ekziston një rregull që mundësitë teknologjike vijnë në rënie nga intensiteti i shfrytëzimit të tyre. ‘Nga njëra anë, ato sigurojnë një zhvillim të rregullt të një fluksi teknologjik, ndërkohë që nga ana tjetër, ato sigurojnë gjithashtu mundësi të kufizuara për firmat që të konkurojnë në mënyrë të suksesshme në një garë të karakterizuar nga elementë të fortë inovatorë (Ebersberger & Pyka, 2002: 638). Për më tepër që në rrjetin global të prodhimit, ka një sërë aktorësh të tjerë që nuk kanë të bëjnë me shtetet apo me organizatat ndërkombëtare të tilla si grupet e punësimit, konsumatorët dhe organizata të tjera të shoqërisë civile të cilët sot kanë mundësinë që me anë të rrjeteve sociale të organizohen dhe të ndikojnë në vendimmarrjen e firmave apo të korporatave të fuqishme (Coe & Wai-Chung, 2015: 49).

Figura 12: Procesi i ndikimit të sistemit arsimor te struktura ekonomike e një vendi



Zhvillimi teknologjik i një vendi, i cili më pas ka ndikimin e tij të drejtëpërdrejtë te struktura ekonomike e tij dhe te rritja dhe zhvillimi ekonomik, varet shumë nga aftësitë që individët fitojnë gjatë procesit të edukimit në sistemin arsimor të atij vendi. Është për këtë arsye që studimi i kapitalit njerëzor po zë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme të një vendi. Pavarësisht arsyetimit të thjeshtëzuar të figurës më sipër, sistemi arsimor nuk është faktori i vetëm që ndikon në formësimin e strukturës ekonomike të një vendi. Ndikim të rëndësishëm luajnë dhe burimet natyrore, pozita e tij gjeografike, kultura dhe politika lokale, investimet e huaja direkte etj. Por sistemi arsimor mbetet një faktor i rëndësishëm nëse duam që një vend të ketë një rritje ekonomike të qëndrueshme. Duke iu referuar të dhënave të mbledhura nga OECD ‘Shqipëria ka pasur përmirësime përsa i përket performancës së saj në shkencë, lexim dhe në matematikë, duke iu referuar rezultateve të vitit 2015 të Programit Ndërkombëtar për Vlerësimin e Studentëve (PISA), i cili tregon që vendi po i kushton një rëndësi gjithnjë e më të madhe faktit që rinia të përmirësojë aftësitë e tyre dhe të mundësojë aksesin e tyre në tregun e punës. Që nga viti 2009, performanca mesatare e Shqipërisë është përmirësuar me 37 pikë në shkencë dhe 36 pikë në matematikë, të cilat nga vlerësimi dhe krahasimi i të dhënave me vendet e tjera janë respektivisht përmirësimi i tretë më i madh në rastin e shkencës dhe përmirësimi i madh në rastin e matematikës, ndër sistemet e arsimore të vendeve të anëtarësuara në OECD (OECD, 2019). Por, sidoqoftë, vlerësohet se pavarësisht këtyre ndryshimeve të mëdha dhe të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të matematikës, rezultatet e fundit të PISA për Shqipërinë janë sërish nën mesataren e vendeve të OECD-së dhe të BE-së (Ibid.).

Zhvillimi më i rëndësishëm arsimor gjatë viteve të fundit përsa i përket reformave dhe zhvillimit të sistemit arsimor në Shqipëri ka qenë ‘sistemi i Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) i cili përfshin shkollat Profesionale (ShP) dhe Qendrat e Formimit Profesional (QFP) të cilat mund të jenë institucione publike dhe private, sektor i cili mbizotërohet nga institucionet publike. ‘Sistemi publik i AFP shtrihet në 42 Shkolla publike Profesionale dhe 10 QFP publike të shpërndara në 8 Rajone (që do të thotë në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Durrës, Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë). Pjesa më e madhe e tyre janë klasifikuar në kategorinë e performuesit të dobët dhe kanë nevojë urgjente për

përmirësime të ndjeshme në shkallë të gjerë' (ILO, 2014). Megjithëse qeveritë e ndryshme kanë qenë vazhdimisht të interesuara për përputhjen e njohurive dhe aftësive të ofruara nga sistemi i Arsimit dhe Formimit Profesional me kërkesat e tregut të punës, arritjet kanë qenë shumë të pakta në këtë drejtim.

Përfshirja e sektorit privat në adresimin e sfidave të tilla dhe shkalla në të cilën janë përdorur burimet e disponueshme të ndërmarrjeve, është modeste, ndërkohë që vetë sektori privat nuk është aktiv për të mobilizuar burime financiare shtesë. Në të njëjtën kohë, ekziston një lidhje mjaft e dobët, madje jofunksionale, midis strukturave akademike dhe sektorit privat, si për hartimin e kurrikulave ashtu edhe për kërkimet shkencore për të adresuar sfidat që hasen gjatë zhvillimit të sipërmarrjes private. Një krahasim më i fokusuar midis kërkesës dhe ofertës do të transmetonte sinjale të rëndësishme në lidhje me natyrën e profesioneve të kërkuara nga tregu i punës, duke shërbyer kështu si tregues edhe për sistemin arsimor, në veçanti për formimin dhe rikualifikimin profesional të forcës së punës me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e duhura (ILO, 2014).

Studime të ndryshme kanë evidentuar sfidat serioze që ekzistojnë në lidhje me kualifikimin e forcës së punës. Mjedisi i Biznesit dhe Performanca e Ndërmarrjeve (MBPN) ka dëshmuar se më shumë se gjysma e kompanive kanë raportuar që mungesa e forcës së aftësuar të punës përbën një pengesë për biznesin. Për më tepër, Anketa për Klimën e Investimeve (AKI) ka arritur në konkluzionin që 51 % e kompanive të mëdha, 41% e eksportuesve dhe 48% e kompanive të huaja e konsiderojnë mungesën e aftësive si pengesën kryesore në aktivitetin e tyre, ndërsa mbi 35% e kompanive, të cilat kanë adoptuar teknologjitë e reja, përmendin faktin që trajnimi i forcës së punës përbën një kufizim serioz për përdorimin e tyre. 'Shkalla e produktivitetit të punonjësve me kualifikime më të ulta mund të ndikohet në mënyrë pozitive nga zhvillimi i kapitalit njerëzor lokal. Acemoglu (1996) tregon në mënyrë teorike që një shkallë e madhe e punonjësve të kualifikuar inkurajon që firma të kryejë investime të teknologjisë prodhuese, e cila ndikon në rritjen e produktivitetit të punonjësve' (Schlitte, 2012).

E nisur në vitin 2008, Analiza e Nevojave për Aftësi (ANA) u përkufizua si instrumenti kryesor për të përmirësuar AFP-në me qëllim harmonizimin e profileve të AFP dhe

kurrikulave të AFP me nevojat e Tregut të Punës (TP). Më parë Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) ka kryer tre ANA, përkatësisht në 2008, 2010 dhe 2012. Objektivi i përgjithshëm i ANA në vitin 2008 ishte “identifikimi i nevojave të ndërmarrjeve për aftësi dhe trajnim si një faktor i rëndësishëm që qëndron në thelb të shërbimeve të këshillimit për punësim, orientimit të karrierës dhe formimit profesional si dhe i dobishëm (ILO, 2014). Anketa mbuloi 988 subjekte biznesi të përzgjedhura me një metodologji kampionimi të shtresëzuar bazuar në tre dimensionet: aktiviteti kryesor, madhësia e kompanisë (mikro, e vogël, e mesme, e madhe) dhe lokaliteti (12 Rajonet e Shqipërisë).

Gjetjet kryesore të anketës ishin: (i) Pothuajse të gjitha bizneset e intervistuar kanë cituar si problemin e tyre kryesor "kualifikimin e papërshtatshëm të forcës së punës", "qëndrimin e punëkërkuesve/kulturën e punës" dhe "barrën e lartë fiskale përsa i përket punësimit"; (ii) “niveli i papërshtatshëm i forcës së punës” duket se përbën një problem madhor për shumicën e bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e bujqësisë, në industrinë përpunuese dhe nxjerrëse dhe në industrinë energjitike, si edhe në sektorin e shëndetësisë; (iii) Shumica e kompanive që deklarojnë se vuajnë nga mungesa e aftësive të punonjësve të tyre janë bizneset e mesme dhe ato të mëdha, ndërsa pothuajse të gjitha bizneset mikro deklarojnë që nuk kanë mungesë aftësish në stafin e tyre ekzistues. Kategoritë profesionale për të cilat është deklaruar se ka mungesë aftësish tek punonjësit ekzistues janë "punonjësit e shitjeve dhe shërbimeve", "punëtorët e montimeve, të mirëmbajtjes dhe të makinerive”, si edhe "technikët dhe specialistët zbatues"; (iv) Masat më të shpeshta që përdoren nga kompanitë në rast të mungesë së aftësive janë ofrimi i trajnimit i ndjekur nga përmirësimi i procedurave të rekrutimit dhe zëvendësimi i stafit; (v) Mënyrat kryesore të përdorura nga bizneset për rekrutimet e reja janë "të njohurit, të afërmit dhe miqtë" dhe "marrja e rekomandimeve nga të njohurit"; (vi) "aftësitë profesionale" dhe "korrektësia/integriteti" janë vlerësuar nga bizneset si kritere tepër të rëndësishme për rekrutimin në punë; (vii) Më të vështirat për t'u gjetur përsa i përket aftësive specifike dhe kritereve janë "aftësitë profesionale" dhe "eksperienca e punës". Aftësi të tjera të vështira për t'u gjetur në grupin e menaxherëve dhe specialistëve të lartë janë "kreativiteti" dhe "aftësitë organizative"; (viii) Industria përpunuese rezulton të jetë industria më aktive përsa i përket ofertës së trajnimit.

"Trajnimi në vendin e punës" është cituar si trajnimi i përdorur më shpesh; dhe (ix) Pothuajse të gjitha llojet e trajnimit janë afatshkurtra, dhe kryhen në një muaj ose maksimumi për një periudhë deri në 3 muaj; (x) Trajnimi në vendin e punës dhe trajnimi formal brenda në kompani, shpeshtësia e trajnimit dhe kohëzgjatja e trajnimit janë pothuajse të njëjta. Situata ndryshon me trajnimet që kryhen jashtë kompanisë ose jashtë vendit, ku drejtuesit, specialistët dhe stafi administrativ kanë 2-3 herë më shumë mundësi për ta përfituar këtë krahasuar me punonjësit në prodhim. Niveli i bashkëpunimit midis bizneseve që organizojnë trajnimin e stafit të tyre dhe sistemit të arsimit profesional apo atij të formimit profesional në tërësi është shumë i ulët (ILO, 2014).

Pavarësisht studimeve të shumta të zhvilluara me anë të anketave apo pyetësoreve në firma të madhësive të ndryshme, vendase apo të huaja, ajo që ka qenë më pak e studiuar është marrëdhënia midis nivelit të arsimit dhe të ardhurave apo pagave të individëve. Dhe më konkretisht sa përqind të pagës dhe të ardhurave do të shtonte një vit më shumë arsimim në një firmë apo kompani të caktuar? Mbledhja dhe analizimi i këtyre të dhënave është i vështirë për tu realizuar edhe sepse do të kërkonte një informacion të detajuar nga kompanitë që jo gjithmonë arrijnë të sintetizojnë të dhënat që kanë në të tilla drejtime investigimi apo studimi. Gjithësesi në botë, studime të tilla bëhen në mënyrë periodike dhe kanë filluar herët dhe gjithmonë duke përdorur regresionin linear apo të shumëfishtë si një metodë studimi dhe analizimi sasior të të dhënave. Pozicioni i punës luan gjithashtu një rol qendror në tregjet e punësimit. Individët zakonisht kryejnë një arsimim formal dhe një trajnim për të zhvilluar një sërë aftësish që të arrijnë sukses në kategori të ndryshme të punësimit. Pozicionet e punës janë klasifikime që përdoren si nga firma ashtu dhe nga punonjësit për të lehtësuar komunikimin mbi përmbajtjen e punës., e cila promovon një seleksionim më efikas të aplikantëve për punësim. Pa një klasifikim të pozicioneve të punës, nuk do të kishte një shpërndarje efikase të burimeve në tregun e punës (Levenson & Zoghi, 2010). Në kohën moderne, pozicioni i punës mund të jetë shumë i korreluar me të ardhurat. Kjo reflekton pjesërisht kompleksitetin e fitimit të dijeve apo të aftësive, sesa kohë nevojitet për të mësuar një sërë aftësish; për shembull doktorëve iu nevojitet një trajnim i gjatë dhe intensive gjë e cila më pas reflektohet edhe te të ardhurat dhe te paga.

Gjatë shekullit të 19-të pozicionet e punësimit zakonisht klasifikoheshin në bazë të industrisë ku ishin të punësuar apo të produktit që nxirrnin në shitje për shembull punëtorët e qymyrgurit. Alba Edwards propozoi (1911, 1938, 1941) propozoi që një punonjës duhej të klasifikohet jo nga produkti që prodhonte por nga lloji i punës që bënte ose nga shërbimi që kryente (Levenson & Zoghi, 2010). Shumë statistika moderne apo anketa kombëtare kanë filluar ti kryejnë më së shumti klasifikimet nëpërmjet nivelit të të ardhurave, pasi dhe klasifikimi me anë të pozicioneve ka problematikat e tij, si për shembull disa punë konsiderohen më shumë të gjinisë femërore dhe nuk arrijnë që të kapin të gjithë spektrin e aftësive. Në këtë disertacion kam zgjedhur të fokusohem në studimin e variablave të edukimit, të pagës dhe të pozicionit të punës. Më poshtë është një përshkrim i detajuar i metodologjisë së përdorur.

KAPITULLI VI: METODOLOGJIA

6.1. Mbledhja e të dhënave


Të dhënat janë mbledhur për tre kompani (firma, ndërmarrje) private, të cilat veprojnë në fusha të ndryshme të tregut të punës në Shqipëri, por përzgjedhja e tyre është bërë në fusha që kërkojnë më së shumti njohuri teknologjike pasi merren me produkte të reja inovatore. Të treja firmat dhe kompanitë kanë më shumë se 15 vite që operojnë në tregun shqiptar dhe kanë ardhur duke u zgjeruar dhe duke shtuar si shërbimet, klientët dhe numrin e punonjësve. Për të zhvilluar këtë studim dhe për të përdorur të dhënat e mbledhura nga to, secilës kompani i është dërguar një kërkesë zyrtare në zyrat përkatëse të Burimeve Njerëzore. Prej tyre është marrë leje zyrtare, por jo të gjitha kompanitë kanë rënë dakort për përdorimin e emrit të tyre në këtë studim, dhe për këtë arsye kompanitë janë koduar. Kjo bëhet edhe për tu ruajtur privatësinë e individëve të punësuar pranë tyre sepse studimi përmban të dhëna sensitive që kanë të bëjnë, me edukimin, pagën dhe pozicionin e tyre aktual në kompani. Kompanitë janë koduar në:

- ✚ *Kompania X (e cila operon në fushën e instalimit të internetit);*
- ✚ *Kompania Y që operon në fushën e sistemit bankar dhe konkretisht të dhënat i përkasin punonjësve të një banke të nivelit të dytë, dhe*
- ✚ *Kompania Z, e cila operon në fushën e energjisë.*

Për të bërë një krahasim në rezultatet e të dhënave, është menduar që të përfshihet në studim edhe një kompani publike, e cila në këtë studim përfaqësohet nga Kompania Z.

Në fillim është studiuar marrëdhënia midis variablit të edukimit – si një variabël i pavarur dhe variablit të pagës – si një variabël i varur. Në një moment të dytë do të trajtohet marrëdhënia midis variablit të edukimit si një variabël i pavarur dhe pozicionit hierarkik në kompani si një variabël i varur. Dhe gjithashtu do të kryhet dhe një analizë regresioni në lidhje me pozicionin si një variabël i pavarur dhe pagës si një variabël i varur. Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të studiojë kapitalin njerëzor dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik në Shqipëri. Kapitali njerëzor do të studiohet, jo vetëm si bazë e formimit të tyre nga ana e edukimit apo e sistemit arsimor, por edhe se çfarë avantazhesh

(të ardhurash) dhe aftësish (pozicioni) iu mundëson ky sistem arsimor në tregun shqiptar të punës.



Studimet më të shpeshta në Shqipëri kanë qenë më shumë të fokusuara në nivelin makro të tregut të punës dhe se çfarë mundësish iu ofronte ai individëve dhe më pak te niveli mikro apo te individët dhe se çfarë kapitali përbënin ato për tregun e punës. Ndonëse në përgjithësi studimi do të përdorë të dhëna sasiore, në mënyrë të pashmangshme studimi përmban dhe të dhëna cilësore, të tilla si statusi dhe pozicioni.

6.2. Regresioni Linear – si metoda e analizimit të të dhënave

Analiza e regresionit paraqet procesin e shpjegimit të lidhjes ndërmjet një ndryshoreje të varur dhe një të pavarur (regresioni i thjeshtë) apo lidhjen ndërmjet një ndryshoreje të varur dhe më shumë se një ndryshoreje të pavarur (regresioni i ponderuar) me një barazim matematikor. Në qoftë se në analizën e regresionit lidhja ndërmjet ndryshoreve është lineare quhet regresion linear dhe e kundërta quhet regresion jo linear (Kalayci, 2017).

Modeli i regresioni të thjeshtë linear supozon se relacioni ndërmjet *variablës së varur* y dhe *variablës së pavarur* x mund të përafrohet me anë të një drejtëze.

– Më saktësisht, relacioni ndërmjet vlerës mesatare $\mu_{y|x}$ të variablës së varur y dhe variablës së pavarur x është linear.

Regresioni linear i përket së njëjtës familje të ‘korrelacionit’ por është një hap më i zhvilluar se ai. Kjo metodë zakonisht përdoret kur duam që të parashikojmë vlerën e një variabli duke u bazuar te vlera e variablilit tjetër. Variabli që duam të parashikojmë quhet

variabël i varur. Variabli që do të përdorim për të parashikuar variablin tjetër quhet variabël i pavarur. Për shembull, regresioni linear zakonisht përdoret për të kuptuar nëse performanca në provime mund të parashikohet nga koha e vënë në dispozicion për të studiuar për provimin; nëse konsumimi i cigareve mund të parashikohet nga kohëzgjatja e pirjes së një cigareje; dhe kështu me rradhë. Nëse kemi më shumë se një variabël të pavarur, atëherë duhet që të përdorim regresionin e shumëfishtë.

6.3. Statistikat me anë të programit statistikor SPSS

Përpara se të fillojmë të analizojmë të dhënat me programin statistikor SPSS, duhet që të sigurohemi që të dhënat që do të analizojmë mund të analizohen duke përdorur analizëm e regresionit linear ose të shumëfishtë.

Ekzistojnë 6 rregulla kryesore për të analizuar me anë të këtij programi:


Rregulli #1: Të dy variablat duhet që të jenë të vazhdueshëm. Shembuj të variablave të vazhdueshëm janë: koha e përgatitjes për provim (e matur në orë); inteligjenca (e matur sipas testit të IQ); performanca në provim (e matur nga pikët nga 0 deri te 100); pesha (e matur në kg) dhe kështu me rradhë.

Rregulli # 2: Duhet që të ketë një marrëdhënie lineare midis dy variablave. Kjo gjë duhet bërë duke hedhur të dhënat në programin statistikor SPSS dhe duke studiuar nëse ka një marrëdhënie të tillë lineare midis tyre.

Rregulli # 3: Nuk duhet të ketë një numër të madh pikash të ‘jashtme’. Pikat e jashtme është një pikë që është duke u studiuar dhe që përmban një vlerë të caktuar të variablit të varur dhe që është shumë e ndryshme nga vlera e parashikuar nga ekuacioni i regresionit linear. Si e tillë, një pikë e jashtme do të jetë një pikë e vendosur në fushën e grafikut që është në mënyrë (vertikale) larg linjës së regresionit. Problemi me ‘pikat e jashtme’ është që ato kanë një efekt negativ në analizën e regresionit që përdoret për të parashikuar vlerën e variablit të varur të bazuar te variabli i pavarur. Kjo do të ndryshojë dhe rezultatin e llogaritur me programin statistikor SPSS, dhe të reduktojë aftësinë e ti parashikuese në rezultatet e gjetura. Sidoqoftë, kur përdorim SPSS për të kryer një regresion linear, në guidën teknike të programit shkruhet që mund të përdoret opsioni ‘*casewise diagnostics*’, i

cili është një proces i thjeshtë për reduktimin e efekteve të pikave të jashtme në rezultatin përfundimtar të studimit.


Figura 13: Model i 'pikave të jashtme' gjatë analizimit të rezultateve në programin statistikor SPSS



Rregulli # 4: Duhet që të kemi pavarësi në studim, gjë e cila mund të kontrollohet thjeshtë duke përdorur opsionin statistikor brenda programit SPSS – Durbin – Watson, i cili është një komandë e thjeshtë gjatë përdorimit.

Rregulli #5: Rezultatet e nxjerra nga programi statistikor SPSS duhet të tregojnë që kanë homoskedacitet, gjë e cila do të thotë që variancat përgjatë linjës përputhen mirë me të dhe mbeten me të njëjtën largësi edhe përgjatë vazhdimit të linjës. Megjithëse figurat më poshtë përpiqen që të qartësojnë dhe të kthjellojnë idetë në lidhje me konceptin e 'homoskedacitetit', të dhënat reale shpesh mund të jenë më të vështira për tu klasifikuar.

Figura 14: Shembuj modelesh 'homoskedaciteti' në programin statistikor SPSS



Pohimi # 6: Së fundi, duhet që të kontrollojmë që vlerat e mbetura të linjës së regresionit janë të shpërndara në mënyrë normale. Kjo mund të arrihet me dy mënyra:

- Histogram

- 130

Variabli i edukimit është kategorizuar sipas vlerave të viteve të arsimit që posedojnë njësitë e analizës të marra në shqyrtim nga 0 – 21 vjet apo dhe më shumë. ‘Arsimi formal është përkufizuar në ISCED si një arsim që është i institucionalizuar, qëllimor, dhe i planifikuar nëpërmjet organizatave publike dhe institucioneve private të njohura, që në totalitetin e tyre, përbëjnë arsimin formal të një vendi. Arsimi jo formal, ashtu si arsimi formal, është përkufizuar në ISCED si një arsimim që është i institucionalizuar, që ka objektiva të caktuara nga një institucion arsimor por konsiderohet si një arsimim shtesë, alternativ dhe/ose plotësues i arsimimit formal. Ai mund të zgjasë pak dhe të ketë intensitet të ulët dhe zakonisht ka formën e kurseve të shkurtra, workshopeve ose seminareve. Të mësuarit informal përkufizohet në ISCED si një formë e të mësuarit që ka qëllime dhe objektiva, por nuk është e institucionalizuar. Është më pak e organizuar dhe e strukturuar sesa format formale dhe jo-formale të arsimimit. Mësimi informal mund të përfshijë aktivitete që ndodhin në familje, në vendin e punës, në komunitetin lokal, ose në baza të vetë-mësuarit, ose mbi baza shoqërore (ILO, 2018: 62). Ky disertacion do të përfshijë vetëm arsimimin formal, i cili është dhe më lehtësisht i verifikueshëm në zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive dhe bankës respektive.

‘Format e arsimit në institucionet arsimore në Shqipëri janë: 1) arsimim me kohë të plotë, 2) arsimim me kohë të pjesshme dhe 3) arsimim në distancë. Që në vitin 2008, arsimi bazë me kohë të plotë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët që janë shtetas shqiptarë me banim në vend nga mosha 6 vjeç deri në moshën 15 vjeç. Ai përbëhet nga 9 vite arsim bazë, prej të cilave Arsimi Fillor përbëhet nga 5 klasë dhe Arsimi i Mesëm i Ulët nga 4 klasë. Nxënësit që kanë mbushur moshën 16 vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme. Llojet e Arsimit të Mesëm të Lartë janë (i) gjimnazi (arsimi i mesëm i përgjithshëm) (ii) arsimi i mesëm profesional, dhe (iii) Arsimin e mesëm të orientuar (shkollat artistike, sportive, të gjuhëve të huaja dhe pedagogjike).

Që nga viti 2009-2010, arsimi profesional funksionon në tre nivele duke i ofruar nxënësve formim të përgjithshëm dhe profesional (teorik dhe praktik), si dhe përgatitur për punë dhe arsimim të mëtejshëm. Programet dyvjeçare në nivelin e parë synojnë formimin e punëtorëve gjysmë të aftësuar. Nxënësit e suksesshëm marrin certifikatën bazë të formimit

profesional dhe mund të hyjnë në tregun e punës, ose të vazhdojnë studimet e tyre në nivelin pasardhës. Në nivelin e II-të, njëvjeçar, përgatiten teknikë dhe nxënësit pajisen me certifikatë të formimit profesional. Niveli i III-të, që zgjat edhe një vit mësimor, u hap rrugën nxënësve për arsimin e lartë. Në fund të këtij niveli nxënësit japin provimin e praktikës profesionale dhe atë të Maturës Shtetërore’ (Strategjia Kombetare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020). Në studim variabli i edukimit i janë dhënë vlera jo sipas përkufizimeve të mësipërme të tilla si arsim i mesëm apo i lartë, por në bazë të viteve të shkollimit, për shkak se ka shumë studentë të padiplomuar që përfshihen më herët në tregun e punës.

6.5. Konsiderata etike

Konsiderata etike për mbledhjen e të dhënave kanë të bëjnë me dy elementët më kryesorë të çdo studimi: 1) besueshmërinë dhe 2) vlefshmërinë e studimit.

‘Kërkimi është një ndërmarrje e përbashkët, që kryhet në mjediset akademike, në industri apo në mjedise të tjera. Kërkimi përfshin bashkëpunim, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që shpesh i kapërcen kufijtë socialë, politikë dhe kulturorë. Ai ngrihet mbi bazë të lirisë për të përcaktuar çështjet e kërkimit, për të zhvilluar teori, për të mbledhur materiale empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme. Prandaj, kërkimi del prej punës së komunitetit të kërkuesve dhe, në variantin ideal, zhvillohet në mënyrë të pavarur nga presioni i partive drejtuese, ose nga interesa ideologjikë, ekonomikë apo politikë (Kodi Europian i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, 2019). Sipas nenit 9 të këtij kodi, praktikat më të mira në kërkimin shkencor përfshijnë aspektet e mëposhtme:

- a) mjedisin e kërkimit;
- b) trajnimin për kërkimin;
- c) udhëheqjen e kërkimit dhe të studiuesit;
- d) procedurat e kërkimit;
- e) mbrojtjen e studiuesit;
- f) përdorimin e të dhënave;
- g) punën në skuadër dhe bashkëpunimin;
- h) botimin e rezultateve të kërkimit;
- i) vlerësimin e kërkimit.

Në këtë studim, dhe në përgjithësi në mjedisin e kërkimit shqiptar problemet kryesore me të cilat jam përballur gjatë zhvillimit të tij ka qenë: 1) mjedisi i kërkimit, 2) respekti dhe

masat mbrojtëse në kërkimin shkencor dhe 3) përdorimi i të dhënave. Mjedisi i kërkimit në përgjithësi nuk ka qenë shumë favorizues, dhe për këtë arsye shumë të dhëna zyrtare nga institucionet janë marrë nga publikimet online të tyre sesa nga intervistat e drejtpërdrejta në institucione. Kjo edhe sepse sipas parimeve dhe procedurave të kërkimit shkencor - pyetjet kërkimore dhe hipotezat mbështeten në kontekstin dhe nevojat e zhvillimit shoqëror, kërkuesit bëjnë kujdesin më të madh të mundshëm për mënyrat dhe procedurat e analizës, të dokumentimit dhe të formulimit të rekomandimeve të kërkimit shkencor; Kërkuesit përdorin në mënyrë racionale, me përgjegjësi dhe vetëdije të lartë fondet e kërkimit shkencor, Rezultatet, interpretimet, përfundimet dhe rekomandimet e kërkimit shkencor publikohen të qarta, me saktësi e transparencë, duke respektuar fshehtësinë e të dhënave apo të gjetjeve kur kjo është e nevojshme ose kur kërkohet; Kërkuesit raportojnë rezultatet e kërkimeve me standardet e kërkuara dhe atje ku është e zbatueshme, në mënyrë që të jenë të verifikueshme.

Duke iu referuar draftit për Kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë (neni 13) Respekti dhe masat mbrojtëse në kërkimin shkencor:

1. Kërkuesit veprojnë në përputhje me kodet dhe rregulloret e disiplinave përkatëse të fushave të studimit.
2. Kërkuesit i trajtojnë subjektet e kërkimit, qofshin këto njerëzore, shtazore, kulturore, biologjike, mjedisore, fizike, historike, me kujdes e respekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi.
3. Kërkuesit tregojnë kujdes maksimal për shëndetin, sigurinë, integritetin, dhe mirëqenien e komunitetit, të bashkëpunëtorëve dhe të personave të tjerë që marrin pjesë ose që janë të lidhur me kërkimin.
4. Protokollat, metodologjitë dhe teknikat e kërkimit respektojnë ndjeshmëritë që lidhen me diferencat moshore, gjinore, seksuale, kulturore, fetare, etnike, ekonomike, financiare dhe sociale midis komuniteteve, individëve, bashkëpunëtorëve dhe të personave të tjerë që marrin pjesë ose që janë të lidhur me kërkimin.
5. Kërkuesit shmangin rreziqet dhe dëmet e mundshme që kërkimi mund të shkaktojë mbi

komunitetet, individët, mjedisin, trashëgiminë historike e kulturore, si dhe perspektivat e zhvillimit në territorin ku kryejnë studimet (Drafti i projekt ligjit Për kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë, 2019).


Pjesa më sensitive e rasteve empirike të studimit kishte të bënte me përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave që i korrespondojnë dhe nenit 14 të projekt ligjit të ri për etikën në kërkimin shkencor.

Sipas nenit të 14 ‘Përdorimi dhe ruajtja e të dhënave’:

1. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore mundësojnë ruajtjen e sigurt të të dhënave e të materialeve kërkimore, përfshirë ato të pabotuara, për një periudhë kohore të arsyeshme.
2. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore sigurojnë që qasja në të dhënat të jetë e hapur sa më shumë të jetë e mundur: e gjetshme, e arritshme, ndërvepruese, transparente, e ripërdorshme. Qasja në të dhënat mund të kufizohet atëherë sa e vlerësojnë të nevojshme këto institucione, me qëllim që të ruajnë të dhënat mbi çështje të sigurisë së vendit ose nëse kërkohet nga financuesit e kërkimit.
3. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore prodhojnë të dhëna dhe produkte legjitime dhe të mundshme për t'u cituar, në bazë të standardeve të citimit, të parashikuara nga Shoqata Amerikane e Psikologjisë.
4. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore sigurojnë që çdo kontratë e marrëveshje për publikimin ose përdorimin e rezultateve të kërkimit, të respektojë pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.


Më poshtë, do të trajtoj fillimisht të dhënat e mbledhura nga Kompania X ku janë marrë në shqyrtim të dhënat për 158 punonjës të saj, të cilët punojnë në hierarki të ndryshme brenda kësaj kompanie.

Figura 16: Hedhja e të dhënave të variablave në programin SPSS



	Name	Type	Width	Decimals	Label	Values	Missing	Columns	Align	Measure	Role
1	Edukimi	Numeric	8	2		None	None	8	Right	Nominal	Input
2	Paga	Numeric	8	2		None	None	8	Right	Scale	Input
3	Pozicioni	Scientific	8	2		None	None	8	Right	Nominal	Input
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											

Figura 17: Të dhënat e kompanisë X të hedhura në programin SPSS



	Edukimi	Paga	Pozicioni	var	var	var	var
1	22.00	149787.00	-				
2	8.00	31794.00	-				
3	12.00	45000.00	-				
4	8.00	31406.00	-				
5	12.00	59546.00	-				
6	12.00	58077.00	-				
7	12.00	60000.00	-				
8	8.00	31794.00	-				
9	8.00	51444.00	-				
10	12.00	52970.00	-				
11	8.00	41818.00	-				
12	8.00	35000.00	-				
13	8.00	31794.00	-				
14	18.00	64347.00	-				
15	12.00	69797.00	-				
16	18.00	70000.00	-				
17	8.00	57865.00	-				
18	8.00	35000.00	-				
19	8.00	60435.00	-				
20	8.00	59695.00	-				
21	8.00	53077.00	-				
22	16.00	63452.00	-				
23	16.00	60000.00	-				
24	16.00	63452.00	-				
25	8.00	24000.00	-				
26	12.00	46596.00	-				
27	8.00	36572.00	-				
28	8.00	46714.00	-				
29	12.00	45251.00	-				
30	12.00	26239.00	-				
31	18.00	72005.00	-				
32	16.00	56000.00	-				
33	18.00	523007.00	-				
34	8.00	37072.00	-				
35	8.00	40000.00	-				
36	12.00	37072.00	-				

Për përfitimin e analizës së regresionit logjistik nga programi SPSS shkohet te menuja *Analyze - Regression - Linear*. Në tabelën e dialogut që shfaqet zgjidhen ato opsione që e


bëjnë nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave sa më të besueshëm dhe më afër realitetit të marrëdhënieve midis variablit të varur dhe atij të pavarur. Qëllimi kryesor i studimit empirik në këtë kapitull të studimit është që të zbulojë se cili është ndikimi i strukturës prezente ekonomike shqiptare në tregun e punës, dhe sesi ky treg do të ndikohej nga një rritje e mundshme ekonomike në të ardhmen. Qëllimi i parë është që të zbulojë marrëdhëniet relacionale në tregun aktual të punës ndërsa qëllimi i dytë është më shumë futurist dhe do të trajtohet në kapitullin e fundit të studimit. Për të studiuar tregun aktual të punës janë marrë në shqyrtim tre variabla kryesore: paga, pozicioni dhe arsimimi dhe do të studiohet marrëdhënia e varësisë ndërmjet tyre sipas regresionit linear, jo të shumëfishtë. Kuptohet që në këtë marrëdhënie janë lënë jashtë dhe të pastudiuar edhe shumë variabla të tjerë të tillë si: mosha, vitet e eksperiencës së punësimit, gjinia etj. Por një fokusim i tillë është bërë për të studiuar më mirë marrëdhëniet dhe ndikimin që ka arsimimi në formimin e kapitalit njerëzor të një tregu. Rezultatet do të paraqiten në mënyrë të detajuar në kapitullin në vijim.

KAPITULLI VII: ANALIZIMI DHE KRAHASIMI I REZULTATEVE

7.1. Rezultatet e të dhënave të kompanisë X – Edukimi dhe Paga

Analizat që marrin në shqyrtim nivelin e aftësive tentojnë që të përqendrohen më shumë te pagat, por nuk marrin në shqyrtim ndikimet e punësimit sipas aftësive specifike. Shumë studime që marrin në shqyrtim studimin e rritjes të punësimit nuk e ndajnë këtë rritje sipas aftësive specifike (Schlitte, 2012). Nëse një punë kërkon më shumë aftësi ose diploma të avancuara, paga është zakonisht më e lartë por ky aspekt nuk është pjesë e analizës së këtij kapitulli. Qëllimi kryesor i tij është paraqitja e lidhjes së regresionit midis këtyre dy variablave për të parë nëse paga (variabli i varur) a ndryshon në bazë të edukimit apo arsimimit (variabli i pavarur).

Figura 18: Vendosja e variablave të regresionit linear në SPSS



Më poshtë paraqiten të dhënat e variablit të pavarur ‘edukim’ dhe variablit të varur të ‘pagës’ në Kompaninë e internetit të koduar ‘X’. Janë studiuar 156 njësi të analizës të cilët kanë një pagë mesatare 60 680 dhe vitet mesatare të edukimit janë 13.29 vite. Këto të dhëna janë relativisht më të larta se mesatarja kombëtare e Shqipërisë. Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të parë 2019, është 51.531 lekë, duke u rritur me 4,9 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar (Tabela 5).

Tabela 5: Statistika përshkruese e regresionit linear të edukimit dhe të ardhurave të kompanisë

Statistika Përshkruese			
	Mean	Std. Deviation	N
Paga	60680.0253	61380.92264	158
Edukimi	13.2911	3.33922	158

Tabela 6: Korrelacioni midis variablave edukim dhe të ardhura në kompaninë X

Korrelacionet			
		Paga	Edukimi
Pearson Correlation	Paga	1.000	.323
	Edukimi	.323	1.000
Sig. (1-tailed)	Paga	.	.000
	Edukimi	.000	.
N	Paga	158	158
	Edukimi	158	158

Tabela 7: Përmbledhja e modelit me SPSS të kompanisë X për variablat edukim dhe të ardhura

Përmbledhja e modelit ^b					
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Eaton
1	.377 ^a	.142	.137	44311.53307	1.813
a. Predictors: (Constant), Edukimi					
b. Variabli i varur: Paga					

Vlera R square dhe Adjusted R square na tregojnë se sa përqind e modelit shpjegohet nga vlerësimi i variances, dhe sa afër linjës lineare qëndrojnë rezultatet e të dhënave. $R^2=0.142$ dhe R^2 e korrigjuar $=0.137$. Pra këto vlera kanë shumë pak ndryshim, që do të thotë që modeli shpjegon 14.2% të vlerave, gjë që është një përqindje shumë e vogël dhe që tregon që variabli i edukimit ka një ndikim shumë të vogël të paga në kompaninë X, por që sidoqoftë ka një lidhje ndërmjet variablave.

Tabela 8: Regresioni linear në tabelën ANOVA për variablat e edukimit dhe pagës në Kompaninë X

ANOVA ^a						
Modeli		Shuma e katrorëve	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regresioni	61558088467.102	1	61558088467.102	18.120	.000 ^b
	Residual	529957884886.797	156	3397165928.762		
	Totali	591515973353.899	157			
a. Variabli i varur: Paga						
b. Predictors: (Constant), Edukimi						

Në tabelën 8 janë përmbledhur të dhënat ANOVA të cilat ekzaminojnë regresionin e shumës së katrorëve, mesataren e katrorëve, vlerën F dhe Sig. Bazuar në të sig=0.00 modeli ynë është i rëndësishëm (Kalayci, 2017: 203). Vlerë tjetër me rëndësi e cila duhet të interpretohet në Tabelën 8 është dhe vlera F e cila tregon rëndësinë e modelit dhe vlera Sig. e cila tregon nivelin e rëndësisë. Në qoftë se vlera F është e rëndësishme, mund të vijmë në përfundim se modeli statistikisht është plotësisht i rëndësishëm (Ibid). Por, në rastin e Kompanisë X, vlera F është 18.120, gjë e cila është e ulët dhe në këtë mënyrë dhe marrëdhënia ndërmjet edukimit dhe pagës përkthehet në një marrëdhënie jo shumë të rëndësishme për kompaninë X.


Tabela 9: Parashikimet e parametrave në Kompaninë X sipas variablave të edukimit dhe pagës

Koeficientët									
		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients				95.0% Confidence Interval for B	
		B	Std. Error	Beta				Loëer Bound	Upper Bound
Model	B	Std. Error	Beta		t	Sig.	Loëer Bound	Upper Bound	
1	(Constant)	-18135.244	19086.911		-.950	.344	-55837.381	19566.892	
	Edukimi	5929.911	1393.041	.323	4.257	.000	3178.254	8681.568	
a. Dependent Variable: Paga									


Duke iu referuar Tabelës 9 e cila bën dhe parashikimet e parametrave dhe të ndikimit të variablit të varur në variablin e pavarur. Për çdo vit arsim të kryer më shumë, shtesa në pagë do të jetë 5929 lekë të reja në muaj.

Grafiku 2 tregon normalitetin e histogramit, nëse ai ka një shpërndarje normale të rezultateve brenda kurbës së dhënë dhe pa ekstremitete. Ashtu siç shihet dhe nga grafiku, histogrami ka shumë ekstremitete, të cilat na thonë që nuk është një shpërndarje normale. Histogrami ka më shumë vlera negative sesa pozitive gjë që bën që pjesa e tij më e madhe të mos ketë regression linear midis edukimit dhe pagës.

Grafik 2: Histogrami me SPSS i kompanise X për variablat edukim dhe të ardhura



Grafik 3: Projektioni i vijës së regresionit linear për arsimimin dhe të ardhurat në Kompaninë X




Në grafikun 3 më sipër, rezultatet duhet që të ndjekin vijëzën e drejtë, por ashtu siç tregohet aty, rezultatet janë shumë larg saj dhe e ndjekin atë vetëm në nivelet shumë të larta të edukimit të cilave iu korrespondon dhe një pagë më e lartë. Megjithëse kurba ka një vazhdimësi në rritje, sërish mund të thuhet që nuk ka diferenca të mëdha, dhe nuk ka një rritje progresive të pagave në raport me edukimin në kompaninë X. ‘Si fillim, të gjithë e dimë se edukimi në veçanti është një aspekt kritik dhe thelbësor i jetës, sidomos në shtetet me ekonomi të zhvilluar. Edukimi mund të konsiderohet si një investim. Zakonisht janë studentët ata të cilët kërkojnë vazhdimisht karriera më të mira dhe të suksesshme si dhe paga të larta sepse për ta arsyeja kryesore për të ndjekur studimet e lara është gjetja e një pune’ (Dollomaja, 2018).

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri paga minimale ka qenë në rritje, por kjo në njëfarë mënyre ka pasur një efekt negativ te pagat e tjera. ‘Edhe pse paga minimale ka qenë e njëjtë, pavarësisht nga mosha e punonjësve apo gjinia, ajo ka patur ndikime shumë të ndryshme në grupe pagash të ndryshme. Politika e pagës minimale shqiptare ka pasur

efekte të thella në disa segmente të pagave të tjera (të mesme dhe të larta) të fuqisë punëtore. Në vitin 2015 paga minimale orare prej \$ 1.10 ishte sa 45 për qind të pagës mesatare ndërkohë, në vitin 2005 paga minimale orare prej \$ 0.62 minimale ishte sa 41 për qind e pagës mesatare (ALTAX, 2019).

Grafik 4: Vlera e parashikuar dhe e standartizuar e regresionit



Grafiku 4 tregon nëse llojet e raporteve midis edukimit dhe pagës kanë apo jo lidhje me njëri – tjetrin, dhe ashtu sic duket dhe nga ky grafik nuk është se kanë ndonjë lidhje të dukshme midis tyre në Kompaninë X.

PËRFUNDIME PËR KOMPANINË X: *Jo ndonjë lidhje domethënëse midis variablave të edukimit, pagës dhe pozicionit. Lidhja më e fortë që ekziston në këtë kompani është ndërmjet edukimit dhe pagës, sidoqoftë në shifra shumë të ulëta.*

7.2. Rezultatet e të dhënave të një banke të nivelit të dytë – koduar si ‘Banka Y’ –

Bankat janë një punë e preferuar për shumëkënd, sidomos ata që mbarojnë ekonomik. Por, prej disa vitesh, është e vështirë të gjesh punë në një bankë, pasi ato nuk po zgjerohen, përkundrazi po reduktojnë degët dhe disa prej tyre janë bashkuar apo dhe mbyllur fare, duke shkurtuar numrin e punonjësve teksa gjatë konsolidimit po optimizohet numri i degëve, duke mbyllur ato që janë afër ose rezultojnë jo eficiente (Revista Monitor, 2019). Sipas të dhënave nga Shoqata e Bankave, në fund të vitit 2018 në banka punonin 6,684 punonjës, apo 210 më pak se një vit më parë [2018]. Procesi i konsolidimit të sistemit bankar por dhe mungesa e oreksit për tu zgjeruar nga ato ekzistueset janë arsyt kryesore të kësaj tendence. Numri i degëve të bankave ishte 463, ose 26 më pak se një vit më parë.

Viti 2018 nisi me 16 banka dhe u mbyll me 14. ABI Bank bleu në shkurt Bankën Kombëtare të Greqisë (NBG) dhe Intesa Sanpaolo finalizoi përthithjen e Veneto Bank. Të dy transaksionet e fundit kanë përfunduar dhe Banka Kombëtare e Greqisë dhe Veneto janë çregjistruar tashmë. Banka, me numrin më të lartë të punonjësve është BKT, që është më e madhja në vend edhe sipas aktiveve, depozitave e kredive. Banka kishte në fund të 1,292 punonjës në fund të 2018-s, e pandryshuar në raport me një vit më parë. Numri i degëve mbeti i pandryshuar në 93. E dyta ishte Raiffeisen me 1,273 punonjës në fund të 2018-s, 4 më pak se një vit më parë. Banka kishte 76 degë, pa asnjë ndryshim në 2018-n. E treta është Credins, me 870 punonjës, 13 më shumë se një vit më parë, ndërsa numri i degëve ka mbetur i pandryshuar në 58. Interesa Sanpaolo, e cila përthithi Bankën Veneto, e ka rritur numrin e punonjësve me 64, duke e çuar në 640. Tirana Bank e ka reduktuar personelin me 9 punonjës, ndërsa ka mbyllur dy degë; Alpha Bank e ka mbajtur të pandryshuar numrin e punonjësve dhe ka mbyllur një degë, OTP (ish Societe Generale) e ka rritur me 7 numrin e punonjësve, por ka mbyllur tre degë, sipas informacionit deri në fund të 2018-s. Aksionerët e rinj kanë pohuar se kanë plane për zgjerimin e mëtejshëm të bankës, si organike, ashtu dhe përmes blerjeve të tjera. Banka që ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të punonjësve (me 170) ishte Banka Amerikane e Investimeve (ABI Bank), për shkak të blerjes së NBG, duke e çuar stafin në total në 418, sipas të dhënave zyrtare nga banka, që i referohen datës 1 maj 2019. Numri i degëve është rritur nga 19 në fund të 2017-s në 26 degë (nga të cilat 10 në Tiranë), plus 1 agjenci, sipas të dhënave të bankës (Revista

Monitor, 2019). Sistemi bankar u rrit me shpejtësi pas vitit 2005 dhe deri në 2008-n ai e kishte dyfishuar personelin. Por pas vitit 2008, kur u godit nga kriza financiare globale, bankat u treguan më të maturuara, si në drejtim të zgjerimit, ashtu dhe të shtimit të personelit. Numri më i lartë i punonjësve u arrit në 2016-n me gati 7000 të punësuar. Ndërsa procesi i konsolidimit të sistemit gjatë dy viteve të fundit po çon në reduktimin e punonjësve në një nga sektorët, që sipas INSTAT ka pagën më të lartë në ekonomi, me mesatarisht 106 mijë lekë në muaj (e dyta pas organizatave ndërkombëtare, me 152 mijë lekë në muaj).

Banka e marrë në shqyrtim në këtë studim shquhet gjithashtu për numrin e madh të punonjësve, sidoqoftë janë marrë në shqyrtim 158 njësi të analizës në variablat e edukimit dhe të pagës. Në fakt, sektori bankar njihet për pagat e tij relativisht të larta. Në fakt ashtu sic tregohet dhe nga analizimi i të dhënave të Bankës Y, mesatarisht për 15.9 vite studimi paga mesatare është 149195 lekë të reja. Sipas të dhënave të INSTAT, të përditësuara për vitin 2017 ‘aktivitetet financiare dhe të sigurimeve’ kishin pagën më të lartë mesatare në ekonomi me gati 104 mijë lekë në muaj, me një rritje 2.3% në krahasim me vitin e mëparshëm. Paga mesatare për bankat dhe sigurimet është dy herë më e lartë se mesatarja për të gjitha aktivitetet ekonomike (INSTAT, 2017). Në fakt të dhënat e bankës Y, të marra për shqyrtim në këtë disertacion, tregojnë një mesatare më të lartë sesa ajo të përshkruar nga INSTAT, por kjo ndodh sepse të dhënat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore, dhe i referohen degës qendrore në Tiranë dhe nuk merr në studim dhe pagat e degëve të tjera nëpër rrethet e Shqipërisë.

Tabela 9: Statistika përshkruese për Bankën Y

Statistika përshkruese			
	Mean	Std. Deviation	N
Paga	149195.3544	150802.26370	158
Edukimi	15.9114	2.02022	158

Tabela 10: Korrelacionet për variablat e edukimit dhe pagës në Bankën Y

Korrelacionet			
		Paga	Edukimi
Pearson Correlation	Paga	1.000	.562
	Edukimi	.562	1.000
Sig. (1-tailed)	Paga	.	.000
	Edukimi	.000	.
N	Paga	158	158
	Edukimi	158	158

Të dhënat e parametrave në Tabelën 10 dhe sidomos Sig.=0.000 tregon rëndësinë e modelit të variablave të ‘edukimit’ dhe të ‘pagës’ në Bankën Y. Gjithashtu vlera F në Tabelën 12 që paraqet dhe parametrat e tabelës ANOVA tregon që ky raport në Bankën Y vlen për 72.1% të njësive të analizës të studiuara. Kjo gjë tregon që arsimimi dhe paga kanë një lidhje më të rëndësishme në Bankën Y sesa në Kompaninë X që merrej me instalimin e internetit.

Tabela 11: Përmbledhja e modelit për Bankën Y

Përmbledhja e Modelit										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.562 ^a	.316	.312	125086.62293	.316	72.188	1	156	.000	2.070
a. Predictors: (Constant), Edukimi										
b. Variabli i varur: Paga										


Tabela 12: Paraqitja e tabelës ANOVA për Bankën Y në variablat e edukimit dhe të pagës

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	1129508204601 .317	1	1129508204601 .317	72.188	.000 ^b
	Residual	2440879464896 .834	156	15646663236.5 18		
	Total	3570387669498 .150	157			
a. Variabli i varur: Paga						
b. Predictors: (Constant), Edukimi						


Tabela 13: Tabela e koeficientëve në Bankën Y për edukimin dhe pagën

Koeficientët										
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.	95.0% Confidence Interval for B		Collinearity Statistics	
		B	Std. Error	Beta			Lower Bound	Upper Bound	Tolerance	VIF
1	(Constant)	- 7925 518849.090	4.209		-6.547	.000	- 675398.93 9	- 362299.24 1		
	Edukimi	41985.291	4941.552	.562	8.496	.000	32224.306	51746.277	1.000	1.000
a. Variabli i varur: Paga										


Grafik 5: Histogrami i Bankës Y për variablat e edukimit dhe të pagës



Grafik 6: Drejtëza e regresionit linear për Bankën Y për variablat e edukimit dhe të pagës



Grafik 7: Diagrama e skaterit e Bankës Y për variablat e edukimit dhe të pagës



Të dhënat nga Anketat për Matjen e Nivelit të Jetesës 2012 në Shqipëri tregojnë se individët me arsim më të ulët dytësor (tetëvjeçar ose nëntëvjeçar) fitojnë mesatarisht 24% më shumë se individët me arsim fillor. Personat me arsim të mesëm fitojnë rreth 22% më shumë se ata me arsim tetëvjeçar apo nëntëvjeçar, dhe arsimi tretësor ka një shpërblim me pagë me rreth 32% më shumë se arsimi i mesëm. Megjithatë, varësia e drejtë midis nivelit arsimor dhe shpërblimit me pagë nuk qëndron për femrat. Megjithëse femrat fillojnë punë duke pasur nivele më të larta arsimi dhe ruajnë përparësinë në të gjithë grupmoshën e tyre, kur flitet për pagat, ky aspekt pozitiv dhe kjo përparësi shpërfillen, siç ilustruhet qartë nga hendeuku gjinor në paga. Femrat e mirëarsimuara vazhdojnë të gjejnë punësim kryesisht në sektorin shtetëror të shërbimeve sociale (si specialiste, punëtore të rregullta dhe nëpunëse në sektorët e arsimit, kujdesit shëndetësor dhe administratës shtetërore), ndërsa në përgjithësi, burrat mbizotërojnë në pozicione si ligjvënës, zyrtarë të lartë dhe në drejtim. Si rrjedhim, ndarja profesionale sjell edhe ndryshime në paga, duke ushtruar presion mbi pagat për profesione ku ka një numër të mirë femrash që kërkojnë punë.

Së dyti, mungesa e mbështetjes dhe oferta e kufizuar e kujdesit shtetëror i kthen femrat në përkujdesëset kryesore për fëmijët, të sëmurët dhe të moshuarit. Si pasojë e faktit se femrat kanë përgjegjësi për lindjen dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve, si dhe të politikave të dobëta në lidhje me ofrimin e kujdesit për fëmijët, forca femërore e punës karakterizohet nga mosvazhdimësi e punësimit, veçanërisht gjatë periudhës së lindjes së fëmijëve, duke çuar kështu, mesatarisht, në pesë vjet më pak përvojë pune gjatë ciklit të jetës aktive, krahasuar me meshkujt. Një gjë e tillë ndikon më tej dhe më negativisht pozicionin e femrës në tregun e punës. Një faktor tjetër, i cili ka ndikim në nivelin e ulët të shpërblimit të femrave, është edhe përfshirja e tyre e ulët në bizneset private si të vetëpunësuarat (Strategjia Kombëtare për punësim dhe aftësi 2014 -2020).

7.2.1. Rezultatet e të dhënave të ‘Bankës Y’ – Pozicioni dhe Paga


Në këtë pjesë do të prezantohen rezultatet e studimit që kanë marrë në studim variablat e ‘pozicionit’ dhe të ‘pagës’, ku ‘pozicioni’ është variabël i pavarur ndërsa ‘paga’ është variabël i varur. Në përgjithësi, INSTAT ka vlerësuar që në Shqipëri ka një lidhje të drejtëpërdrejtë mes punësimit të grave dhe nivelit të pagave që ato marrin në krahasim me burrat. “Në sektorin e aktiviteteve ekonomike të ndërtimit dhe atë të tregtisë, transportit, hotelarisë etj, paga mesatare është më e lartë për gratë se sa për burrat. Ky fakt nuk do të thotë se në ndërmarrjet e këtyre sektorëve nuk ka diskriminim gjinor në paga, por ai është i lidhur me pjesëmarrjen e ulët të grave në forcat e tyre të punës. Një pjesëmarrje e tillë e ulët shpesh do të thotë që në këta lloj sektorësh arrijnë të punësohen vetëm ato gra që kanë arritur nivele të larta arsimi dhe kualifikimi dhe rrjedhimisht, punësohen pothuajse ekskluzivisht në poste të larta pune”, theksohet në raportin “Burrat dhe gratë në Shqipëri 2017”, publikuar nga INSTAT.

Përveç dallimit gjinor, është bërë dhe studimi i pagave sipas sektorëve të punësimit dhe ashtu siç u përmend dhe më lart, sektori bankar rezulton si një nga sektorët më të mirëpaguar në Shqipëri, por sidoqoftë nuk ekziston ndonjë studim që studion lidhjen ndërmjet pozicionit dhe pagës. Për këtë arsye, janë zgjedhur në mënyrë rastësore 158 njësi të analizës në Bankën Y dhe janë studiuar në lidhjen apo rëndësinë që ekziston midis tyre.

Vlerat që ju dhanë variablit të pavarur të ‘pozicionit’, si një variabël i pavarur janë si më poshtë:

- 1) Agjent për marrëveshje tregtare;
- 2) Roje sigurimi;
- 3) Drejtor i degëve në institucione;
- 4) Punonjës i shërbimeve mbështetëse (kamarier, sanitare, hidraulik etj);
- 5) Arkëtar Banke;
- 6) Specialist i operacioneve nëpër institucione;
- 7) Arkitekt ndertesash;
- 8) Punonjës administrate (jurist, sekretare, vëzhgues i kamerave, recepsioniste etj.)
- 9) Agjent/ Specialist i kredive;
- 10) Drejtor ekzekutiv;
- 11) Informatikan;
- 12) Supervizor;
- 13) Kontabilist

Figura 19: Paraqitja e vlerave të variablit të pozicioneve në Bankën Y sipas programit SPSS



Sipas statistikës përshkruese të Tabelës 14, të nxjerrë nga programi kompjuterik SPSS rezultoi që profesionet më të përhapura brenda bankës ishin: arkëtar (e) dhe specialist i operacioneve nëpër institucione. Paga mesatare e këtyre dy profesioneve është 164327 lekë.

Tabela 14: Statistika përshkruese e Bankës Y përsa i përket pozicionit dhe pagës

Statistika Përshkruese			
	Mean	Std. Deviation	N
Paga	164327.5905	170923.30539	105
Pozicioni	5.4762	2.53474	105

Tabela 15: Korrelacionet e variablilit të pozicionit dhe të pagës në Bankën Y

Korrelacionet			
		Paga	Pozicioni
Pearson Correlation	Paga	1.000	.339
	Pozicioni	.339	1.000
Sig. (1-tailed)	Paga	.	.000
	Pozicioni	.000	.
N	Paga	105	105
	Pozicioni	105	105

Duke iu referuar rezultateve në Tabelën 16, Tabelën 17 dhe Tabelën 18 marrëdhënia ndërmjet variablilit të pavarur të ‘pozicionit’ dhe variablilit të varur ‘të punësimit’ është e rëndësishme sepse Sig. = 0.000 por F është e rëndësishme vetëm për 13.4% të njësive të analizës, të cilëve ju referohen edhe pozicioneve të larta të drejtuesve ekzekutivë. Zakonisht në pozicionet e nivelit të mesëm, të cilët përbëjnë dhe numrin më të madh të punonjësve nuk ka diferencime të mëdha në paga në bazë të pozicionit.

Tabela 16: Përmbledhja e modelit për variablat e pozicionit dhe të pagës në Bankën Y

Përmbledhja e Modelit										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.339 ^a	.115	.107	161554.65246	.115	13.412	1	103	.000	1.819
a. Predictors: (Constant), Pozicioni										
b. Variabli i Varur: Paga										


Tabela 17: Parametrat ANOVA për variablat e pozicionit dhe të pagës në Bankën Y

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	350046447553. 022	1	350046447553. 022	13.412	.000 ^b
	Residual	2688290290466 .369	103	26099905732.6 83		
	Total	3038336738019 .391	104			
a. Variabli i Varur: Paga						
b. Predictors: (Constant), Pozicioni						


Tabela 18: Koeficientët e variablave të pozicionit dhe të edukimit për Bankën Y

Koeficientët										
		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients			95.0% Confidence Interval for B		Collinearity Statistics	
		B	Std. Error	Beta			Lower Bound	Upper Bound	Tolerance	VIF
Model					t	Sig.				
1	(Constant)	38987.143	37682.157		1.035	.303	-35746.529	113720.814		
	Pozicioni	22888.256	6249.846	.339	3.662	.000	10493.160	35283.352	1.000	1.000
a. Variabli i Varur: Paga										


Grafik 8: Histogrami i variablave të pozicionit dhe të pagës në Bankën Y



Grafik 9: Drejtëza e regresionit linear dhe rezultatet e variablave të pozicionit dhe pagës në Bankën Y



Grafik 10: Diagrama e skaterit për variablat e pozicionit dhe të pagës në Bankën Y



7.3. Rezultatet e të dhënave të ‘Kompanisë Z’ – Edukimi dhe Paga

Analizimi i të dhënave për kompaninë publike Z janë të rëndësishme sepse përfshin një fushë të eksploruar pak ose shumë pak në Shqipëri. Punësimi në sektorin publik vazhdon që të mbetet shumë i kërkuar në vendin tonë dhe është një nga synimet kryesore të karrierës së shumë individëve. Gjatë vitit 2017, punësimi në shtet shënoi rritje domethënëse në tremujorin e dytë të vitit, me 170,652 të punësuar gjithsej, duke u zgjeruar me 3,7 për qind në raport me tremujorin e parë të vitit. Sipas të dhënave të INSTAT që i referohen listpagesave të tatimeve, punësimi në sektorin shtetëror ka arritur nivelin më të lartë që nga viti 2005, ku sektori publik numëronte mbi 175 mijë të punësuar. Shqipëria hyn në vendet ish komuniste që trashëgoi një ekonomi ku shteti ishte ofruesi i vetëm i punësimit deri në vitin 1990. Pas këtij viti, pesha e sektorit shtetëror në punësim do të vinte në rënie nga viti në vit për shkak të adoptimit të modelit të ekonomisë së tregut. Ulja e madhësisë së shtetit në ekonomi ishte në themel të programit të qeveriave, të cilët pas vitit 2005 ulën me tej peshën e sektorit shtetëror në ekonomi si në pronësinë e ndërmarrjeve ashtu edhe në punësim.

Pas vitit 2008 për shkak të kushteve të reja që solli kriza ekonomike, me përgjysmimin e rritjes ekonomike dhe rënien e të ardhurave buxhetore, reformat mbi administratën publike me qëllim uljen shpenzimeve publike vijuan. Por tre vite vitet e fundit punësimi në sektorin publik është në rritje të shpejtë edhe pse Kryeministri Rama ka ndërmarrë një reformë ristrukturimi me qëllim shkurtime të mëtejshëm në mandatin e dytë të qeverisjes. Në kuadër të kësaj reforme, numri i ministrive në shtator 2017 arriti në 11 nga 16 të tilla që ishin para zgjedhjeve. Reforma u bë më arsyetimin e një qeverisje të vogël dhe eficiente. Por teksa numri i ministrive dhe agjencive në varësi të tyre është në ulje, nga ana tjetër punonjësit në administratën publike janë në rritje të shpejtë.

Sipas të dhënave zyrtare nga statistikatat e sigurimeve për vitin 2017 shihet se numri i punonjësve në sektorin publik është rritur ndjeshëm dy vitet e fundit. Në vitin 2017 ishin punësuar mbi 14 mijë persona më shumë se në vitin 2015, kur qeverisja Rama nisi reformën për një administratë të vogël. Numri i të punësuarve në vitin 2017 është zgjeruar me 9.6 për qind në raport me vitin 2015, teksa shihet se shtesa më e madhe ka ndodhur në vitin 2016 me rreth 9655 persona më shumë se në vitin 2015, teksa në vitin 2017 u shtuan

4300 persona ose 2.8 për qind. Punësimi në shtet sipas analizave që kanë bërë institucionet financiare vitin e kaluar është nxitur nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, ku zakonisht administrata publike pëson fryrje. Pas përfundimit të zgjedhjeve të vitit 2017, Kryeministri bëri një organizim të ri të sistemit të qeverisjes dhe mënyrës së organizimit funksional, por shifrat zyrtare që i takojnë tremujorit të dytë të vitit tregojnë për një rritje të mëtejshme të punësimit në sektorin shtetëror (INSTAT, 2017).

Por, megjithatë ekzistojnë studime të pakëta përsa i përket kriteret përzgjedhëse për punësimin në shtet dhe sesa e ndikon arsimimi këtë përzgjedhje. Presupozohet që punësimi i individëve të kualifikuar në shtet do të nxiste një zhvillim më të madh ekonomik si pasojë e rritjes së cilësisë së shërbimeve nga qytetarëve dhe bizneseve. Cilësia e lartë e shërbimeve nxit dhe investimet e huaja në vend si dhe do të ketë një hov më të madh për inovacion, duke sjellë metodologji dhe teknologji të reja në ekonomi.

Tabela 19: Përmbledhja e modelit për variablat e edukimit dhe të pagës në Kompaninë publike Z

Përmbledhja e Modelit										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.223 ^a	.050	.049	35114.636	.050	39.191	1	747	.000	1.993
a. Predictors: (Constant), Edukimi										
b. Variabli i Varur: Paga										

Sidoqoftë ajo që shikohet nga analizimi i të dhënave në kompaninë Z, është që ka një disnivel të madh midis vlerës R në katror dhe vlerës F. Kjo gjë nuk vërehej te kompanitë private të marra në shqyrtim. R në katror për kompaninë Z është 0.050 ose e shprehur në përqindje 5%. Kjo gjë tregon afërsinë e vlerave të regresionit të edukimit dhe pagës me drejtëzën lineare, gjë e cila do të thotë sa afër drejtëzës janë këto vlera, dhe në fakt kjo gjë tregon që ato janë shumë larg dhe nuk ka një lidhje të tillë ndërmjet shkollimit dhe pagës në kompaninë publike të marrë në shqyrtim. Por ndërkohë vlera F tregon rëndësinë e përgjithshme të kësaj marrëdhënie, e cila është 39.1 përqind, e cila është një vlerë më e rëndësishme sesa në kompaninë X. Kjo do të thotë që marrëdhënia e regresionit ndërmjet

edukimit dhe pagës është një marrëdhënie e rëndësishme statistikore në kompaninë Z, por që vlerat në grafikun e regresionit janë shumë të shpërndara dhe larg drejtëzës së vijës lineare. Sipas INSTAT, në vitin 2016 Shqipëria kishte të punësuar 1,127,772 persona nga të cilët, 164, 333 persona ishin të punësuar në sektorin publik, 501,759 në sektorin privat dhe 461,680 ishin në sektorin bujqësor (INSTAT, 2016). Sipas të dhënave të Eurostat, në BE punësimi në sektorin publik zë mesatarisht 16 për qind në totalin e punësimit, ndërsa në Shqipëri zë 26.5 për qind (pa bujqësinë). Sipas INSTAT, në Shqipëri pesha e bujqësisë në punësim është rreth 40.9 për qind e totalit më 2016, ndërsa në vendet e BE sektori i bujqësisë ka peshë shumë më të ulët në punësim 2-4 për qind (Eurostat, 2016). Për shkak të këtyre treguesve është shumë e rëndësishme që në sektorin publik, arsimimi dhe trajnimi i të punësuarve duhet të ketë një rol vendimtar për të ardhmen ekonomike të vendit.


Tabela 20: Tabela ANOVA për Kompaninë Z

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	48324186830.000	1	48324186830.000	39.191	.000 ^b
	Residual	921079123900.000	747	1233037649.000		
	Total	969403310800.000	748			
a. Variabli i Varur: Paga						
b. Predictors: (Constant), Edukimi						

Sidoqoftë duhet theksuar që të ardhurat nga puna për të punësuarit në sektorin publik ndryshe nga të punësuarit në sektorin privat, shpesh përfshin vetëm pagën, dhe jo të ardhura të tjera shtesë të tilla si bonuset, honorare shtesë, kompensime apo shpërblime të ndryshme në mënyrë që të nxitet dhe kompetitiviteti ndërmjet punonjësve, për ti dhënë dhe një hov më të madh zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike. Duke iu referuar INSTAT ‘Të Punësuarit me Pagë’, janë të gjithë personat që punojnë direkt me ndërmarrjen dhe marrin pagesë nga punëdhënësi. Ndërsa Kostot e punës, i referohen shpenzimeve totale që kryejnë punëdhënësit për stafin e punësuar. Ato përfshijnë kompensimin për të punësuarit, i cili përbëhet kryesisht nga pagat bruto në kesh ose në natyrë dhe kontributet e sigurimeve


shoqërore që paguan punëdhënësi, kostot e trajnimit profesional, shpenzime të tjera si kostot e rekrutimit dhe shpenzimet për veshje pune, taksat e punësimit nga të cilat zbriten subvencionet e marra.

Grafik 11: Histogrami i variablave të edukimit dhe të pagës në Kompaninë Z



“Monitor” ka krahasuar pagat bruto mujore, sipas aktiviteteve ekonomike për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë e Malin e Zi , bazuar në të dhënat zyrtare që kanë publikuar institutet statistikore të secilit vend, ndërsa për Kosovën pagat publikohen të përmbledhura. Sipas këtyre të dhënave ‘nëse punon në Shqipëri, paga që merr në fund të muajit është më e ulëta në të gjithë rajonin, për të gjithë sektorët, si në banka, sigurime, industri, bujqësi, arsim dhe sidomos në teknologji informacioni dhe shëndetësi’ (Monitor, 2019)


Grafik 12: Drejtëza e regresionit linear dhe rezultatet e variablave të edukimit dhe pagës në Kompaninë Z



Siç mund të studiohet dhe nga Grafiku 12, drejtëza paraqet pak a shumë të njëjtën trajektore si në Kompaninë X dhe Bankën Y. Por siç u tha dhe më lart, ka më shumë pika të larguara nga drejtëza kryesore, gjë që do të thotë që ka më shumë disnivel pagash në lidhje me shkallën e edukimit ndërmjet punonjësve, gjë që përbën dhe një karakteristikë të kësaj kompanie, dhe që është e vështirë që të përgjithësojmë për të gjitha institucionet publike. Edhe në shtet, ku evazioni është zero, sërish administrata publike shqiptare, mjekët, mësuesit janë më pak të paguarit. Paga mesatare në shtet (Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale) është 480 euro në Shqipëri, rreth 530 euro në Kosovë, rreth 670 euro në Maqedoni, 760

euro në Serbi dhe më e larta në Mal të Zi me rreth 880 euro. Mali i Zi është vendi që ka të ardhurat më të larta për frymë në rajon, me rreth 475 të mesatares së Bashkimit Europian, nga 30% që e ka Shqipëria, sipas statistikave të tjera të Eurostat, më e ulëta në Europë’ (Monitor, 2019).

Grafik 13: Diagrama e skaterit për variablat e edukimit dhe të pagës në Kompaninë Z



7.4. Përmbledhja e kapitullit

Për rezultatet e paraqitura më sipër mund të arrihet në konkluzionin që lidhja më e rëndësishme që ekziston në tregun e punës në Shqipëri është ndërmjet edukimit (sistemit arsimor) dhe pagës (nivelit të të ardhurave). Ndërsa lidhja që ekziston ndërmjet pozicionit dhe pagës është akoma një lidhje jo shumë e rëndësishme dhe nuk ka ndonjë diferencim të madh ndërmjet pagave sidomos në sektoret që i përkasin nivelit të mesëm të hierarkisë

brenda këtyre institucioneve, firmave, bankave që u morën në studim. Duke qenë se këto sektorë (bankat dhe teknologjia e informacionit) janë dhe sektorët më strategjikë të ekonomisë shqiptare, ky diferencim i vogël i pagave, pesha e vogël e arsimimit, tregon që mbetet akoma shumë punë për tu bërë në fushën e inovacionit teknologjik dhe perfeksionimin e tregut dhe profesioneve të punës.

KAPITULLI VIII: TREGU SHQIPTAR I PUNËS DHE RITJA EKONOMIKE E QËNDRUESHME

Akoma sot, gjysma e popullsisë së globit jeton me më pak se 2\$ në ditë, ndërkohë që shkalla e papunësisë në botë sot është 5.7% dhe të pasurit e një pune nuk iu siguron vendeve mundësinë që të largohen nga varfëria (UN, 2018). Ndërkohë që studiues të OECD –së dhe ILO-s theksojnë që marrëdhënia midis zhvillimit të qëndrueshëm, rritjes ekonomike së gjelbër (apo që mbron mjedisin) dhe performancës së mirë të tregut të punës nuk është një marrëdhënie në të cilën ato ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë te njëra – tjetra, por sëbashku ato mund të ndikojë në përforcimin e secilit komponent. Për të vërtetuar këtë, këto organizata ndërkombëtare japin një numër të madh shembujsh që ilustrojnë sesi progresi në këto fusha mund të jetë përforcues në mënyrë të tërthortë.

Për shembull, incentivat qeveritare për të përmirësuar efikasitetin e energjisë së banesave mund të luajë një rol të rëndësishëm për të krijuar vende të reja pune, edhe gjatë periudhave të krizave ekonomike. Njëkohësisht, iniciativat qeveritare për të promovuar zgjerimin e energjisë së rinovueshme – duke përfshirë edhe masat dhe stimujt e gjelbër fiskalë të lejuara si përgjigje ndaj krizës së fundit financiare dhe ekonomike – kanë zgjeruar mundësitë e punësimit në sektorin energjetik. Megjithatë, është e njohur që politikat mjedisore që kërkohen për të arritur rritjen ekonomike të gjelbër, nuk do të thotë që gjithmonë mund të prodhojnë një punësim më të mirë dhe cilësor (OECD & ILO, 2012).

Në veçanti, tranzicioni drejt një energjie të pastër dhe më efikase do të kërkojë më shumë përmirësime të tregut të punës me fitime dhe me humbje në punësim dhe ndryshime në aftësitë e kërkuara dhe në profilet e punësimit. Për shembull, tranzicioni ka më shumë gjasa që të ndodhë kur ka rënie të punësimit në sektorët e qymyr-gurit. Kjo do të kërkojë në mënyrë potenciale kosto më të mëdha të axhustimit të punëonjësve, firmave dhe rajoneve, të varura nga këto sektorë. Zhvendosja e energjisë të përzier (mikse) drejt një energjie të prodhuar nga burime më të pastra – dhe pastrimi i burimeve ndotëse të energjisë, të tilla si karboni – do të kërkojë gjithashtu që të rriten kostot e energjisë, së paku për një periudhë kohore. Kostot e larta të energjisë mund të kenë ndikime të drejtpërdrejta në ekonomi duke zvogëluar punësimin ose nivelin e pagave në disa sektorë (si për shembull në industrinë e

transportit). Por investimet në efikasitetin energjetik në ndërtesa, transport dhe industri mund të jenë efektive përsa i përket kostove, ku përfitimet akumulohen më kalimin e viteve apo të kohës. Si përmbledhje mund të themi që nuk ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis një energjie më të pastër nga ana mjedisore dhe një performance më të mirë të tregut të punës, por këto qëllime shpeshherë mund të jenë përplotësuese (OECD & ILO, 2012). Kjo gjë vlen kryesisht për ekonomitë e industrializuara dhe vendet shumë të zhvilluara që pas Samitit G20 të vitit 2012 vendosën që të transformonin ekonomitë dhe industritë e tyre drejt energjisë të prodhuara nga burime të pasta apo të gjelbra. Për këtë arsye dhe punët e reja të krijuara morën emërtimin ‘punë të gjelbra’, dhe i gjithë procesi duhet të shoqërohej nga një sërë veprimesh të tilla si trajnime shpesh për punonjësit, vendosja e dialogut social ku punonjësit të përgatiteshin për transformimin e profesionit të tyre. Gjithashtu meqë ky tranzicion do të krijonte si mundësi të reja ashtu dhe risqe për punonjësit dhe familjet e tyre, samiti i G20 vendosi që tregu i punës ti maksimizonte mundësitë e reja për punonjësit, duke iu ofruar atyre mundësi punësimi më të mira, ndërkohë që do të minimizonte kostot e axhustimit dhe do t’ju siguronte atyre që avantazhet dhe kostot të ndaheshin në mënyrë të barabartë. Samiti identifikoi 4 politika të rëndësishme qeveritare të cilat duhet të zbatoheshin:

- Të plotësoheshin kërkesat e aftësive të reja për punë që kërkonte ekonomia e gjelbër;
- Ti ndihmonte punonjësit që të kalonin nga firmat dhe fabrikat që po mbylleshin drejt firmave të reja në rritje ndërkohë që të kishin siguri në të ardhura.
- Të siguronin të drejtat e punonjësve në sektorët në rritje të ekonomisë së gjelbër, ndërkohë që studionin mundësitë për të promovuar përfshirjen sociale;
- Të forcoheshin sistemet e informacionit të tregut të punës dhe dialogu social për të promovuar dijet e përbashkëta për ta bërë tregun e punës sa më të gjelbër (ILO & IECD, 2012).

Në Shqipëri ka pasur pak përpjekje për një zhvillim dhe rritje ekonomike të qëndrueshme apo për një ekonomi të gjelbër. Në përgjithësi është adaptuar dhe përafruar legjislacioni i BE-së për industritë e qëndrueshme megjithëse pak gjen zbatim në realitetin e përditshëm. Shpesh diskutohet për ndotjet në mjedis që sjellin industri të ndryshme të vendosura pranë

zonave të banuara, por rëndësia e këtyre industrive më shumë se për tregun e punës përmenden për taksat që i paguajnë shtetit. Mbyllja e tyre apo shndërrimi në industry të gjelbra do të kërkonte kosto të mëdha ekonomike, që nuk merren përsipër nga investitorët e huaj dhe as nga shteti. Sidoqoftë, edhe qeveria shqiptare ka planet dhe politikat e saj për një rritje ekonomike të qëndrueshme të cilat do ti trajtoj më poshtë të ndara në nëntema.

8.1. Aftësitë për punë dhe punësimi

Tregu shqiptar i punës ka ndryshuar në mënyrë drastike gjatë çerek shekullit të fundit. Shumë lloje aftësish dolën nga përdorimi ose nuk kërkoheshin më që pas rënies së sistemit komunist dhe vendosjes së ekonomisë së tregut, ku me anë të Terapisë së Shock-ut shumë fabrika, ndërmarrje dhe uzina u mbyllën, u privatizuan, dhe forca e tyre punëtore mbeti jo vetëm e papunë por edhe pa një profesion. Vala e parë e papunësisë arriti në 26.5% gjatë vitit 1992 (Shano, 2015). Në të njëjtën kohë kërkesat për aftësi të reja lindën në mnëyrë shumë të shpejtë, duke iu referuar së pari kërkesave të ekonomisë së tregut shqiptare të kohës, dhe më vonë në mënyrë më graduale, si rezultat i zhvillimeve teknologjike dhe inovacionit, aftësive më të specializuara, por kjo do të ndodhte një dekadë më vonë.

Përveç kësaj, në Shqipëri është vërejtur edhe një mospërputhje e theksuar midis aftësive të kërkuara nga biznesi dhe fushës së studimit të të diplomuarve, kryesisht për shkak të politikës arsimore në fuqi, duke çuar në një numër të stërmadh të diplomuarish në mësuesi, administrim biznesi, financë, juridik, gjuhë të huaja etj., gjë që ka sjellë shtrembërime të dukshme në tregun e punës (ILO, 2014). Gjatë vitit 2017 shkalla e papunësisë në Shqipëri u ul me 1.5 përqind dhe arriti në 14.1%, ndërkohë që pjesëmarrja në forcën punëtore u rrit me 58%, që është rritja më e lartë në rajonin e Ballkanint Perëndimor dhe të Turqisë. Gjatë vitit 2015, shkalla e aktivitetit të meshkujve ishte 64.3%, mbi mesataren e vendeve anëtare të BE-së, por pjesëmarrja e grave në tregun e punës ishte 47.3%, që ishte një shifër më e ulët sesa mesatarja e vendeve europiane që është 51.5% (ILO, 2018). Shqipëria ishte e para ekonomi në rajon në të cilën forca e saj punëtore u rrit me mbi 50% (Banka Botërore, 2018).

Pavarësisht forcës së re punëtore, Shqipëria ka gjithashtu dhe shkallën më të ulët të papunësisë ndër të rinjtë në Ballkanin Perëndimor me 25.9% të të rinjve (Banka Botërore,


2018). Pavarësisht kësaj, niveli i papunësisë mbetet i lartë pasi 'lidhet me faktin e mosmarrjes në konsideratë të punëkërkuësve në zonat rurale (ILO, 2014). Bujqësia vazhdon të mbetet sektori që mban "të punësuar" shumicën e popullsisë, me afërsisht 41.3%, ndërsa sektori privat jo-bujqësor ka peshë shumë të ulët, duke qenë kështu i paaftë për të thithur kërkesën gjithnjë në rritje për punësim e cila po gjenerohet nga ndryshimet strukturore demografike, shoqërore dhe ekonomike. Shumica e vendeve të punës i përket punëtorëve të papaguar kontribues në familje (34.0%) dhe vetëpunësimit (24.1%). Pasiviteti në tregun e punës u rrit me 3% në vitin 2012, duke influencuar forcën e punës femërore dy herë më shumë se meshkujt. Shumica e femrave dhe e të rinjve kryejnë punë të papaguar në familje, veçanërisht në zonat rurale. Puna informale është e përhapur gjerësisht në shumë aktivitete ekonomike (Ibid).

‘Për shkak të këtyre zhvillimeve, Qeveria Shqiptare e ka vënë theksin fuqishëm tek punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës. Në vitin 2014, u miratua Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2014-2018 e cila ka si vizion kryesor krijimin e një ekonomie konkurruese dhe të një shoqërie gjithëpërfshirëse deri në vitin 2020, të ndërtuara mbi: "Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt". Kjo strategji njeh faktin që rritja e punësueshmërisë së grave dhe burrave do të thotë përfitim prej tyre të më shumë aftësive dhe njohurive, që do të bëjnë të mundur që të gjejnë punë dhe të dinë si të përballojnë ndryshimet e paparashikuara në tregun e punës gjatë gjithë jetës së tyre aktive. Rëndësi e veçantë i është kushtuar lidhjes midis punësimit dhe sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), duke fokusuar masat qeveritare pikërisht në përballimin e kësaj sfide. Deri më sot në Shqipëri ekzistojnë burime të ndryshme informacioni përsa i përket aftësive dhe zhvillimit të tyre. Anketa e Forcës së Punës (AFP), Anketa për Matjen e Standardit të Jetesës (AMSJ) dhe Regjistrimi i Popullsisë (RP) janë instrumente që përdoren për të kuptuar dinamikën e tregut të punës. Megjithatë, ato kryesisht nxjerrin në pah ndryshimet strukturore më shumë sesa nevojat për aftësi. Kjo mund të arrihet nëpërmjet instrumenteve të tjera siç janë anketimi i punëdhënësve në lidhje me nevojat për aftësi apo studimet e thelluara sektoriale (Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2014-2018).

Kohët e fundit në Shqipëri janë kryer anketat për punëdhënësit dhe Analizat sektoriale të Nevojave për Aftësi. Plani i Veprimit që pasoi Strategjinë për Punësim dhe Aftësi 2014-

2020 parashikon kryerjen e këtyre Analizave nga SHKP në mënyrë periodike. Një analizë e tillë mund të sjellë përfitime të shumëfishta përsa i përket vlerësimit të nivelit të afësive në kompanitë private, duke siguruar informacion në lidhje me aftësitë e kërkuara dhe duke ofruar orientim për njerëzit që të dinë të vendosin se për cilat programe arsimit dhe formimit profesional ja vlen të shpenzojnë kohën, përpjekjet dhe fondet e tyre. Një analizë e tillë mund të ndihmojë edhe qeverinë që të vlerësojë dhe të përshtatë programet e arsimit dhe formimit profesional me nevojat e tregut të punës me qëllim rritjen e punësimit (ILO, 2014).

Grafik 14: Shkalla e papunësisë në Shqipëri sipas grupmoshave (2015-2019)



Sipas një studimi me anketa të zhvilluar gjatë vitit 2014 rezultoi që karakteristikat e punonjësve të tilla si gjinia, personat me aftësi të kufizuar, të punësuarit part time etj., përbënin vetëm një numër të vogël. Të dhënat tregojnë që pothuajse 96% e punonjësve punojnë me kohë të plotë, një shifër mjaft e lartë. Punonjësit me kohë të plotë janë kryesisht individë të cilët janë të interesuar të ndjekin një karrierë, ose që duan të kenë të ardhura dhe përfitime të rregullta për të mbajtur veten ose familjet e tyre, ndërsa punonjësit me kohë të pjesshme janë shumë shpesh pensionistë të cilët kërkojnë të shtojnë të ardhurat nga pensioni, studentë, prindër të cilët dëshirojnë të fitojnë ca pará ndërkohë që kanë kohë edhe për të qëndruar në shtëpi me fëmijët, ose ato persona që janë të gatshëm që të fillojnë punë

me kohë të pjesshme me shpresën që në të ardhmen të fitojnë një pozicion me kohë të plotë. Në fakt, punësimi i punëtorëve me kohë të pjesshme është edhe një zgjidhje më tërheqëse edhe për pronarët e bizneseve të cilët dëshirojnë të mbajnë kostot në minimum. Megjithatë, këto persona mund të mos jenë aq të përkushtuar për punën ose kompaninë krahasuar me personat që punojnë me kohë të plotë. Industritë të cilat ofrojnë pozicione ku kërkohet krah pune i pakualifikuar, si për shembull shitja me pakicë, mbështeten shumë tek forca e punës me kohë të pjesshme. Industritë që kërkojnë aftësi dhe njohuri më të specializuara punësojnë më shumë punonjës me kohë të plotë. Megjithatë, shifrat mund të jenë krejt të ndryshme nëse do të kishim informacion për pjesën e punonjësve me kohë të plotë të punësuar nga bizneset në mënyrë informale (ILO, 2014).

Prodhimi është sektori i cili ka edhe përqindjen më të madhe të punësimit, i ndjekur nga tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërtimi dhe shërbimet administrative dhe ato mbështetëse (INSTAT, 2017). ‘Sipas operatorëve të tregut, investimi fillestar fillon me 60-70 mijë EUR për një kompani me 100 punonjës, ndërsa kthimi në investim është i garantuar në rast se kompania ka nënshkruar një kontratë me një klient të fuqishëm jashtë vendit. Sipas operatorëve, kostoja e krahut të punës është deri në tre herë më e ulët krahasuar me koston e krahut të punës në Itali, përfshirë këtu edhe kostot e infrastrukturave të tjera (kryesisht shërbimi i internetit). Paga mesatare mujore në Shqipëri varion nga 280 EUR deri në 350 EUR në muaj, krahasuar me 900-1000 EUR në Itali (ILO, 2014).

Strategjitë për zhvillimin e aftësive për punë janë shumë të rëndësishme dhe prioritet në listën e çdo vendi që është në zhvillim, për së paku tre arsye kryesore:

- ✚ Kombinimi i aftësive: për të parashikuar më mirë dhe për të siguruar aftësitë që duhen dhe për të rritur cilësinë e tyre në bazë të nevojave të tregut të punës;
- ✚ Përmirësimi i aftësive: për të axhustuar programet dhe institucionet e zhvillimit të aftësive me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në tregjet e punës në mënyrë që punonjësit dhe firmat të mund të lëvizin nga prodhimi i ulët I sektorëve të ekonomisë dhe profesioneve drejt zgjerimit dhe sektorëve me produktivitet dhe punësim të lartë. Adaptimet të tilla kërkojnë një ri-aftësim të përhershëm dhe të rregullt në mënyrë që punonjësit të ruajnë vetitë për tu punësuar dhe të mbeten kompetitivë në tregun e punës;

✚ Aftësitë për shoqërinë: shërbejnë për të ndërtuar kapacitetet dhe sistemet e dijes brenda ekonomisë dhe shoqërisë të cilat nxisin dhe mbajnë një proces të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik dhe social.

Puna e ILO-s mbi zhvillimin e aftësive është përqendruar gjatë viteve të fundit kryesisht në tre fusha kryesore: lidhja që duhet të ekzistojë midis trajnimit dhe nevojave të tanishme të tregut të punës si dhe parashikimi dhe ndërtimi i kapaciteteve për punët e së ardhmes; ndërtimi i sistemeve të cilësisë dhe inkorporimi i aftësive kryesore në trajnim për të rinjtë; dhe zgjerimi i aksesit për trajnim të lidhur me punësimin në komunitetet rurale drejt përmirësimit të jetesës, reduktimit të varfërisë; dhe për ti pajisur gratë dhe burrat për të punuar në ekonomi formale (ILO, 2019).

8.2. Politikat kombëtare të punësimit

Politika më e rëndësishme dhe aktive e qeverisë shqiptare është politika e nxitjes së punësimit. Kjo politikë zbatohet nga institucioni i Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) dhe është e bazuar në një legjislacion të gjerë. Në faqen zyrtare në internet të këtij institucioni theksohet që ‘Nxitja e punësimit është ndër programet aktive i cili nëpërmjet sigurimit të punësimit të përkohshëm apo afatgjatë ndikon në kërkesën për pune duke reflektuar drejtpërsëdrejti në uljen e papunësisë. Përmes këtij programi Zyrtar e Punësimit ndërhyjnë realisht për të nxitur dhe mbështetur krijimin e vendeve të reja të punës duke bashkëpunuar me punëdhënësit dhe nëpërmjet subvencionimit të tyre’ (SHKP, 2019). Qëllimi kryesor i të gjitha këtyre programeve dhe i çdo qeverie shqiptare në përgjithësi është ulja e papunësisë, sidomos ndër të rinjtë.

Tabela 21: Të punësuar sipas burimeve administrative dhe sektori bujqësor, 2016-2019

Përshkrimi	I - 16	II - 16	III - 16	IV - 16	I - 17	II - 17	III - 17	IV - 17	I - 18	II - 18	III - 18	IV - 18	I - 19
Të punësuar në sektorin shtetëror	164,170	164,300	164,970	165,100	163,565	164,750	164,560	164,480	164,333	170,652	171,606	172,870	171,539
Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor	400,486	409,685	417,103	422,619	447,309	469,546	481,880	501,341	501,759	504,615	518,083	508,728	502,502
Të punësuar në sektorin bujqësor *	460,035	464,204	474,741	463,827	456,024	456,424	456,829	456,814	461,680	461,765	462,282	453,384	453,279

(Burimi INSTAT)

Një politikë tjetër e qeverisë shqiptare është edukimi dhe trajnimi i një force pune të kualifikuar, e cila të ketë aftësi konkurruese në tregun e punës. Rolin kryesor në këtë aspekt e luan sistemi arsimor, rritja e numrit të diplomuarve në secilin nivel në mënyrë që këta të diplomuar të kenë aftësi të shtuara për tregun e punës. Sidoqoftë, duke iu referuar tabelave dhe të dhënave zyrtare të INSTAT, numri i të diplomuarve në sistemin arsimor shqiptar ka qenë në rënie gjatë dy viteve të fundit (Tabela 19).

Tabela 22: Numri i të diplomuarve sipas viteve (INSTAT, 2019)

Vite shkollorë/akademik	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
Të Diplomuar në arsimin:					
9 vjeçar	44,139	44,001	43,084	36,546	37,795
e mesëm:	35,254	39,629	37,721	36,436	35,278
vetëm Profesional	3,136	4,702	4,507	5,215	4,189
Arsimin e lartë gjithsej*:	29,301	33,654	31,865	35,388	34,331
vetëm Bachelor	17,469	19,152	18,652	20,423	20,108

Në vitin 2018, në arsimin 9 - vjeçar u diplomuan 37.795 nxënës, ose 95,4 % e nxënësve të klasës së nëntë të vitit shkollor 2017 - 2018, duke shënuar një rënie prej 1 pikë përqindje, krahasuar me vitin paraardhës. Në këtë nivel arsimor u diplomuan 51,1 % djem dhe 48,9 % vajza. Në vitin 2018, në arsimin e mesëm u diplomuan 35.278 nxënës, me një rënie prej 3,2 %, krahasuar me 2017. Në këtë nivel arsimor u diplomuan 48,6 % djem dhe 51,4 % vajza. Raporti bruto i diplomimit (numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel ose program të caktuar, të shprehur si përqindje e popullsisë në moshën e diplomimit teorik, për atë nivel apo program) për arsimin e mesëm është 78,3 % (INSTAT, 2019).

Sidoqoftë duhet theksuar që shifrat e arsimimit në arsimin e lartë janë më optimiste dhe kanë treguar një rritje më të madhe dhe një konsistencë në rritje gjatë viteve të fundit. Kështu, në vitin 2018 janë diplomuar në arsimin e lartë 34.331 studentë, ose 3,0 % më pak se në vitin 2017. Ndër të diplomuarit e këtij viti, 63,3 % janë gra dhe 36,7 % janë burra. Të diplomuarit në programet Bachelor përbëjnë 58,6 % të studentëve të diplomuar gjithsej. Ndërkohë që duhet theksuar që fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentët në të gjitha programet është “Biznes, administrim dhe ligj” prej 28,4 % (INSTAT, 2019), gjë e

cila nuk premtan për një dyndje apo revolucion në fushën e teknologjisë së informacionit apo inovacionit teknologjik në përgjithësi. Këto programe diplomimi dhe fusha studimi kryesisht mbështesin industrinë e shërbimeve, e cila mbizotëron tregun e punës sot në Shqipëri si dhe sektorin shtetëror dhe më pak atë privat që është në ekspansion.

Tabela 23: Të punësuar në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve, 2014-2018

Grupet e Profesioneve	2014	2015	2016	2017	2018
Të punësuar ne sektorin shtetëror	163,885	164,020	164,635	164,339	169,865
Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	11,965	11,318	11,992	12,110	13,020
Specialistë	66,852	69,126	72,011	72,185	74,364
Teknikë dhe ndihmës specialistë	39,638	39,488	37,306	36,474	35,955
Nëpunës të thjeshtë	12,130	11,902	12,243	12,320	13,612
Punëtorë	33,300	32,186	31,083	31,250	32,914

(Burimi INSTAT)

Një politikë tjetër qeveritare ka të bëjë me përmirësimin e kushteve të punës si dhe me mbrojtjen e kostos së punës, duke vendosur kufirin e pagës minimale. Kjo ndërhyrje jo gjithmonë është e lidhur me rritjen e punësimeve apo hapjen e vendeve të reja të punës, por kjo politikë ndihmon në rritjen e cilësisë së punës dhe të përmirësimit të jetesës së punonjësve, që të jenë akoma më shumë produktivë në të ardhmen. Duke iu referuar sërish INSTAT-it dhe rezultateve kryesore të Anketës së Kostos së Punës, gjatë vitit financiar 2016, në Shqipëri, kostoja mesatare orare për një njësi pune me kohë të plotë, është 351 lekë, duke u rritur me 11,8 % krahasuar me vitin 2012. Anketa është kryer në terren në periudhën Prill-Maj 2017 dhe ndjek një periodicitet 4 vjeçar. Anketa e Kostos së Punës kryhet pranë ndërmarrjeve dhe përbën një nga burimet kryesore për matjen e niveleve dhe përbërjes së kostove të punës. Kostot e punës përfshijnë pagesat për punonjësit, pagat në kesh dhe në natyrë, kontributet për sigurimet shoqërore – pjesa e punëdhënësit, kostot e trajnimit profesional, shpenzime të tjera të kryera nga ndërmarrja si për rekrutimin e punonjësve, për veshje, strehim, si dhe shpenzime të tjera. Të dhënat për AKP 2016, në

këtë publikim, i referohen ndërmarrjeve dhe institucioneve me të paktën 10 punonjës dhe mbulojnë të gjitha aktivitetet ekonomike, përveç aktiviteteve të Bujqësisë, Pyjeve, Peshkimit, Administrimit publik dhe mbrojtjes, dhe Sigurimit social të detyrueshëm. Kostoja mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë, në ndërmarrjet me 10-49 të punësuar është 303 lekë, dhe për ndërmarrjet me mbi 1 mijë të punësuar është 438 lekë. (INSTAT, 2016).

Aktivitetet ekonomike me koston mesatare orare për njësi pune, me kohë të plotë më të lartë janë: sektori Bankar dhe ai i Sigurimeve me 700 lekë; sektori i Informacionit dhe Komunikacionit me 521 lekë; dhe sektori i Energjisë elektrike, furnizimit me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 493 lekë. Aktivitetet ekonomike me koston më të ulët mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë janë: Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit me 241 lekë; Industria përpunuese me 250 lekë dhe Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve me 254 lekë. Krahasuar me vitin 2012, gjatë vitit financiar 2016, rritja e koston mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë sipas aktiviteteve ekonomike ishte më e lartë për: Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse, me 46,7 %; Informacioni dhe komunikacioni me 42,0 %; Shërbime të tjera (aktivitetet e shoqatave e organizatave, riparimi i kompjuterave dhe artikujve personale dhe familjarë, etj.) me 35,2 % dhe Industria nxjerrëse me 24,6 %. Krahasuar me vitin 2012, gjatë vitit financiar 2016, rritja e koston mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë sipas aktiviteteve ekonomike ishte më e ulët për: aktivitetet e pasurive të paluajtëshme me 1,2 %; aktivitetet e tregtisë me shumicë dhe pakicë, me 8,9 %; aktivitetet e artit, argëtimit dhe zbavitjes, me 10 %; dhe akomodimit dhe aktivitetit të shërbimeve të ushqimit me 12,1 % (INSTAT, 2016).

8.3. Punësimi i të rinjve

Punësimi i të rinjve është një sfidë, e cila është e lidhur ngushtë me situatën e përgjithsme të punësimit, si nga ana sasiore dhe cilësore në një vend të caktuar. Pavarësisht se kërkesat për krahë pune janë shtuar, jo gjithmonë është e mundur që të zbatohen programe të suksesshme për të integruar grupet e disavantazuara të të rinjve në tregun e punës. Nga ana tjetër, tregu i punës i të rinjve ka vecantitë e tij. Së pari janë vështirësitë të cilat janë të

lidhura me moshën ku individëve iu duhet që të përballen me tranzicionin nga shkolla në punë të tilla si mungesa e eksperiencës, rregullat strikte të tregut të punës, mospërputhje midis aftësive dhe aspiratave të të rinjve dhe kërkesave dhe realitetit që ofron tregu i punës; kufizimet për tu vetëpunësuar si dhe të kenë një vision në sipërmarrje; mungesa e organizimit dhe pasjes së një zëri për të kundërshtuar padrejtësitë, gjë e cila do të thotë që të rinjtë kanë më pak kanale nëpërmjet të cilave ata mund të adresojnë shqetësimet e tyre.

Për këtë arsyes është e rëndësishme që qeveria të adaptojë politika që të rrisë punësimin e të rinjve dhe produktivitetin e tyre si dhe tju sigurojë një punësim dinjitoz. Në Shqipëri reforma më revolucionare që është ndërmarrë dhe që pritet të ndikojë dhe në vitet e ardhshme punësimin e të rinjve ka të bëjë me reformën në sistemin arsimor dhe sidomos në zhvillimin e shkollave të mesme profesionale. Duke ju referuar të dhënave të INSTAT ‘Arsimi profesional ka patur një prirje në rënie deri në vitin shkollor 2011-2012. Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin profesional pësoi rënie gjatë periudhës 2006-2010 me rreth 30 për qind, për të rifituar më pas ngritje graduale. Kështu, gjatë vitit shkollor 2012-2013 u vu re edhe numri më i lartë i regjistrimeve (8996 nxënës). Rënia vit pas viti e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin parësor dhe dytësor. Pavarësisht nga faktorët demografikë (numri i nxënësve që ndjekin arsimin bazë dhe atë të mesëm u ul me afërsisht 10 për qind në periudhën 2001-2010), sistemi i arsimit profesional ka patur një rritje të aftësisë tërheqëse të këtij drejtimi arsimor në radhët e nxënësve dhe të familjeve të tyre. Kështu, të diplomuarit nga arsimi profesional gjatë vitit shkollor 2012-2013 ishin 4 322 krahasuar me 2 844, në vitin e mëparshëm, ku femrat e diplomuara kanë një numër në rritje. Megjithatë, të diplomuarit nga shkollat profesionale janë ende kryesisht meshkuj. Arsytet pas këtij fenomeni gjinor janë të ndryshme. Përsa i përket ofertës, faktorët që nuk i nxisin vajzat (dhe prindërit e tyre) për të zgjedhur arsimin profesional kanë të bëjnë me stereotipin thellësisht gjinor të profileve dhe kurseve, vendndodhjen e shkollave profesionale, mungesën e transportit, konviktet e pasigurta dhe klimën e përgjithshme sociale në shkollat e profesionale. Përsa i përket kërkesës, formimi profesional u mundëson djemve arritjen e pritshmërive të tyre të përgjithshme për të fituar disa të ardhura dhe për të hyrë në tregun e punës në një moshë relativisht më të re (Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014- 2020).

8.4. Mbrojtja dhe përfshirja sociale

